

Të pranojmë të qenit ndryshe: Udhëzime se si të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës mësimdashës".
Broshurë e specializuar

Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

Një udhëzues për mësues
dhe trajnerë



Mjedise
gjithëpërfshirëse
e mësimdashëse



Save the Children



Të pranojmë të genit ndryshe: Udhëzime se si
Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse 1
të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës mësimdashës".
Broshurë e specializuar

Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

Një udhëzues për mësues
dhe trajnerë



Mjedisë
gjithëpërfshirëse
e mësimdashëse



Save the Children



Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësime të përbashkëta: Një udhëzues për mësues dhe trajnerë

Bangkok, UNESCO Bangkok, 2006

Vi + 110 pp.

(“Të pranohet të qenit ndryshe: Udhëzime se si të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës mësime të përbashkëta”).
Broshurë e veçantë 1)

1. Shkollim gjithëpërfshirës. 2. Klasat. 3. Udhëzues për mësuesin. 4. Ndëshkimi fizik. 5. Disiplina pozitive.

Titulli original: Positive Discipline in the Inclusive Learning – Friendly Classroom. A guide for teachers and teacher education.

(Embracing diversity: Toolkit for creating inclusive, learning-friendly environments Specialized Booklet 1)

1. Inclusive education. 2. Classrooms. 3. Teacher’s guide. 4. Corporal punishment. 5. Positive discipline.

ISBN 92-9223-086-7

© UNESCO 2006

Botimi i parë nga:

UNESCO, Zyra Rajonale për Azinë dhe Paqësorin për Arsimin,
920 Sukhumvit Rd., Prakanong, Bangkok 10110, Tajlandë

Shtypur në Tajlandë

Grafika e përdorur dhe përgatitja e materialit gjatë procesit të botimit nuk shprehin kurrfarë opinionin nga ana e UNESCO-s lidhur me statusin ligjor të kujtdo vendi, territori, qyteti apo zone, apo autoriteteve të tij, apo kufijve të tij.

APL/06/OS/21-500

Butuar bashkërisht UNESCO Zyra Rajonale për Azinë dhe Paqësorin për Arsimin, 920 Sukhumvit Rd., Prakanong, Bangkok 10110, Tajlandë, dhe Save the Children, Programi për Shqipërinë (varianti shqip) Rr. Komuna Parisit, Vila “Lami”, Tiranë, Shqipëri.

© UNESCO 2006

© UNESCO dhe Save the Children, Programi për Shqipërinë (2007) (varianti në shqip)

Autorët e librit janë përgjegjës për faktet dhe mendimet e shprehura në këtë botim. Asnjë prej këtyre fakteve dhe opinionëve nuk shprehin opinionin, as pjesërisht dhe as në tërësi të UNESCO-s ose Save the Children.

Ky libër i përkthyer në gjuhën shqipe është përgatitur nën përgjegjësinë e Save the Children, Programi për Shqipërinë, Rr. Komuna Parisit, Vila “Lami”, Tiranë, Shqipëri.

Asnjë pjesë e këtij botimi në shqip nuk mund të riprodhohet, në asnjë formë, pa lejen me shkrim nga UNESCO dhe Save the Children, Programi për Shqipërinë.

Përkthyer nga:

Luljeta Buza

Redaktimi letrar:

Arjana Mero

“

Kjo broshurë i përkushtohet Studimit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve (Rezoluta APKB 57/190), e cila i ka rrënjët tek e drejta humane e fëmijëve për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës. Broshura synon të nxisë aksionin për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve në shkolla dhe në mjedise arsimore.

”

Përmbajtja

Vështrim i përgjithshëm	1
Sfida jonë	1
Çfarë është "klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse"?	2
Përse është i nevojshëm ky dokument?	4
Çfarë do të mësoni prej tij?	5
Ndëshkimi në raport me disiplinën, kuptimi	7
Kuptimi i ndëshkimit	10
Kuptimi i disiplinës	20
Disiplina pozitive në klasë	25
Shmangia e dilemës së disiplinës	31
Ndërtimi i raporteve pozitive mësues - nxënës	33
Baza e marrëdhënieve mësues - nxënës	33
Përse fëmijët sillen ashtu siç dinë	34
Përse fëmijët sillen jo mirë	37
Si të informoheni rreth nxënësve tuaj	42
Të kuptojmë kontekstin e jetës që bëjnë nxënësit tuaj	45
Si të mësoni rreth familjeve të nxënësve tuaj	54
Komunikimi prind - mësues	57
Strategji inkurajimi	61
Krijimi i një mjedisi pozitiv që nxit të mësuarit	63
Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm mësimor	64
Zhvillimi i rutinave në klasë	68
Përpilimi i rregullave të klasës me nxënësit dhe prindërit	69
Standarde për sjelljen dhe drejtimin e mirë	74
Dhënia e kurajës pozitive	79
Impenjimi me nxënësit problematikë	83
Përmirësimi i efektivitetit të teknikave të disiplinës pozitive	83
Sugjerime për një disiplinë pozitive	84
Sugjerime për mësimdhënien pozitive në klasë	88
Marrja e masave të duhura, pozitive dhe negative	90
Përdorni me kujdes "Veçimin"	92
Zgjidhja e konfliktit	94
Mësimdhënia në përshtatje me moshën dhe disiplina pozitive	97
Ndihma ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta	101
Lexime të rekomanduara	107



Parathënie

Për fëmijët, në shumë vende, ndëshkimi fizik është pjesë e zakonshme e përvojës shkollore; ai është dhe një formë e abuzimit mbi fëmijën. Ndëshkimi fizik është një dhunë me dashje, që ushtrohet ndaj fëmijës; përhapja e tij është në një shkallë të madhe. Në shumë vende të botës ende ekziston mbrojtje ligjore për ata mësues që godasin apo rrahin fëmijët. Megjithatë, siç e tregon edhe përvoja, ndëshkimi fizik nuk ka patur efekt, sidomos efekt afatgjatë. Ai mund t'i shkaktojë fëmijës ndjenjën e turpfit, të fajit, të ankthit, agresivitetit, mungesën e pavarësisë dhe të kujdesit për të tjerët, duke u bërë kështu një problem i madh për mësuesit, kujdestarët dhe fëmijët e tjerë.

Një nga arsyet kryesore përse vazhdon të zbatohet ndëshkimi fizik është se mësuesit nuk e kuptojnë se ajo ndryshon kryekëput nga "disiplina". Ndërkohë që ndëshkimi fizik përpiqet të ndalojë fëmijën të silllet në një mënyrë të caktuar, teknikat e disiplinës pozitive mund të shfrytëzohen për të mësuar një fëmijë të mësojë sjellje të reja, korrekte, pa patur frikë se do të ndëshkohet. Një arsye tjetër e rëndësishme është se shpesh mësuesve nuk u është mësuar përse fëmijët sillen keq dhe si mund të disiplinohen ata pozitivisht, duke u nisur po nga ato sjellje. Shumë herë, kur fëmija ndjen se nuk po i plotësohen nevojat, siç është nevoja për t'i kushtuar vëmendje, ai ose ajo fillon të silllet keq. Bezdia që shkakton një sjellje të tillë, si dhe paaftësia për t'u marrë me fëmijën, bën që disa mësues ta humbin durimin dhe të përdorin ndëshkimin fizik ose forma poshtërimit të ndëshkimit emocional.

Ky udhëzues për mësues dhe trajnerë është një pasurim që i bëhet botimit të UNSECO-s "Të pranojmë të qenit ndryshe: Udhëzime se si të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës e mësimdashës" (Manuali MGJPPM). Kjo është një broshurë e specializuar, që synon të ndihmojë mësuesit, administratën e shkollave, si dhe specialistët e arsimit që të udhëheqin me efektivitet nxënësit në procesin mësimor, duke u ofruar metoda jo të dhunshme për zgjidhjen pozitivisht dhe në mënyrë proaktive të sfidave që paraqet sjellja e fëmijëve. Ajo ofron instrumentet e një discipline pozitive, si një alternativë konkrete ndaj praktikave ndëshkimore, si rrahja me shkop, pëllëmba në prapnicë, pickimi, kërcënimi, lutja, marrja me të mirë, gërthitja, urdhërimi, sharja, puna e detyruar dhe shumë e shumë veprime të tjera poshtëruese.

Ky udhëzues është frut i vërtetë i një pune kolektive. Në fillim u hartua dhe u rishikua nga Xhorxh Attig i Institutit të Ushqimit në Universitetin e Mahidol-it, i cili ka shërbyer, gjithashtu, si konsulent i UNESCO-s mbi Arsimin Gjithëpërfshirës, si dhe si konsulent në Zyrën Rajonale të UNICEF-it për Azinë Lindore dhe Paqësorin (EAPRO), dhe Save the Children për zhvillimin e shkollave mikpritëse për fëmijët. Në hartimin e kësaj guide kanë kontribuar, gjithashtu, me komente dhe sugjerime edukatorë nga të gjitha anët e botës. UNESCO Bankok dëshiron t'i falënderojë ata të gjithë për ndihmën e tyre.

Çdo hap i hedhur është marrë në konsideratë dhe ka kontribuar në pasurimin e kësaj guide, si dhe të Manualit MGJPPM. Ky proces u koordinua nga Ochirkhuyag Gankhuyag, në cilësinë e asistentit të Programit në Byronë Rajonale të Arsimit të UNESCO-s për Azinë dhe Paqësorin.



Sheldon Shefer
Drejtor, Byroja Rajonale e Arsimit të UNESCO-s për Azinë
dhe Paqësorin.



Vështrim i përgjithshëm

SFIDA JONË

Fëmijët vijnë në jetë të pafuqishëm dhe të paaftë; ata s'mund të zhvillohen vetë, pa ndihmën tonë. Si mësues, puna jonë është t'i edukojmë e t'i mësojmë se si të çajnë në jetë. Kjo nuk është një detyrë e lehtë. Disa herë, klasat tona janë vende që ngacmojnë kërkshërinë, ato na ofrojnë ne dhe nxënësve gaz dhe hare. Herë të tjera, ne mund të ndihemi të tendosur dhe dyshojmë në aftësitë tona për të kryer detyrën tonë. Ka raste kur puna jonë nuk na duket aspak interesante, por puna e mësuesit është dhe një punë me rëndësi, që s'i rastis kujtdo ta ushtrojë.

Ne e dimë se sa e lodhshme është të japësh mësim. Ne e dimë, gjithashtu, se sa shumë kujdes tregoni ju për nxënësit tuaj. Por fëmijët nuk lindin të mësuar. Ndryshe nga një prind, mësuesi është përgjegjës për shumë fëmijë njëherazi, ku secili është unik. Gjithashtu, ata nuk sillen gjithnjë siç do të donit ju. Juve ju duket sikur sapo e keni gjetur zgjidhjen se si të funksionojë njëra klasë, kur ata largohen dhe zëvendësohen nga fytyra të reja, me një varg emocionesh dhe sfidash të reja.

Të gjithë mësuesit do t'iu uronin nxënësve të tyre më të mirën dhe do të bënin çmos që t'u ngjallnin besimin në vetvete dhe krijimin e një mendimi të mirë për vetveten. Por kur ata nuk ju dëgjojnë, nuk pranojnë të bëjnë ashtu si u thoni, ju sfidojnë apo injorojnë, atëherë ju mund të mërziteni shpejt dhe të demoralizoheni. Në qoftë se ju ndodh diçka e tillë ose, më mirë, para se t'ju ndodhë një gjë e tillë, drejtojuni këtij teksti për ndihmë. Ai do t'ju tregojë rrugët se si ta trajtoni pozitivisht këtë sfidë dhe në mënyrë proaktive, duke e parandaluar një sjellje jo të mirë para se ajo të shfaqet, duke vepruar me efektshmëri ndaj sfidave të papritura dhe duke i inkurajuar nxënësit tuaj të dëgjojnë dhe të bashkëpunojnë në një klasë gjithëpërfshirëse, mësimdashëse. Instrumentet pozitive të disciplines, të cilat po jua shpalosim këtu, janë alternativa konkrete ndaj praktikave të tilla ndëshkuese, si rrahja me shkop, pëllëmba në prapnicë, pickimi, kërcënimi, lutja, marrja me të mirë, gërthitja, urdhërimi, nxjerrja e emrit, puna e detyruar dhe shumë e shumë veprime të tjera poshtëruese.

ÇFARË ËSHTË "KLASA GJITHËPËRFSHIRËSE, MËSIMDASHËSE"?

Sapo hyjmë në klasë, ne shohim fytyrat e nxënësve që mësojmë. Por s'duhet të harrojmë se këta fëmijë s'janë të vetmit ata që duhej të ishin në atë klasë. Ka të tjerë që nuk janë përfshirë, sepse s'e kanë mundësinë ta ndjekin shkollën. Ka dhe të tjerë, që fizikisht janë aty, por mund të mendojnë se ai vend nuk është për ta, mund të mos "marrin pjesë" realisht në klasë apo mund të mos sillen mirë.

Një klasë gjithëpërfshirëse, mësimdashëse (KGJM) i mirëpret, edukon dhe arsimon të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjinia, karakteristikat e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, linguistike a ndonjë tjetër. Ata mund të jenë nxënës të talentuar ose fëmijë me paaftësi fizike apo në të mësuar. Ata mund të jenë fëmijë që rrijnë rrugëve apo që punojnë, fëmijë të etnive të largëta apo nomade, fëmijë që u përkasin minoriteteve gjuhësore, etnike apo kulturore, fëmijë të prekur nga AIDS-i ose fëmijë që vijnë nga zona apo grupe të marginalizuara.¹ Një KGJM është, pra, një klasë ku mësuesi kupton vlerën e të qenit ndryshe dhe ndërmer hapa të tilla që të gjitha vajzat dhe djemtë të vijnë në shkollë.²

Por thithja e nxënësve në klasat tona është vetëm gjysma e punës. Gjysma tjetër është se si të plotësohen të gjitha nevojat e tyre mësimore dhe kulturore, në mënyrë që ata të qëndrojnë në klasë. Të gjitha klasat janë të ndryshme nga njëra - tjetra për nga nxënësit që mësojmë dhe mënyra se si ata mësojnë. Ne duhet të marrim në konsideratë të gjitha nevojat që kanë fëmijët për të mësuar, si të arrijnë rezultatet më të mira dhe se si ne, si mësues, mund të ndërtojmë raporte pozitive me secilin fëmijë, në mënyrë që ata të duan të mësojnë nga ne sa më aktivisht. Po kaq e rëndësishme është se si të gjejmë rrugën që të gjithë fëmijët të duan të mësojnë së bashku.

Fëmijët sillen dhe mësojnë në mënyra të ndryshme për shkak të faktorëve të trashëgimisë, mjedisit ku rrojnë ose nevojave të tyre personale apo psikologjike.³ Shpesh, kur një fëmijë nuk i plotësohen nevojat e tij, siç është

¹ UNESCO. "Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e mjedisive gjithëpërfshirëse e mësimdashëse". Bangkok, 2004.

² UNESCO. Broshura 3: Thithja e të gjithë nxënësve në shkollë dhe mësim: "Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e mjedisive gjithëpërfshirëse e mësimdashëse". Bangkok, 2004.

³ UNESCO. Broshura 4: "Të krijojmë mjedisë gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Të pranojmë diversitetin": Manual për krijimin e mjedisive gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Bangkok, 2004.

nevoja për t'i kushtuar vëmendje, ai mund të mos sillet mirë. Prandaj, ne duhet të kuptojmë shkaqet e sjelljes së një fëmijë, në mënyrë që të mundemi të parandalojmë rastet e sjelljeve jo të mira dhe të shfrytëzojmë një mori mjetesh të ndryshme për ta drejtuar sjelljen e tij në rrugë të drejtë. Vetëm atëherë klasat mund të shndërrohen në vende gjithëpërfshirëse, mikpritëse e të gëzueshme, ku fëmijët të mund të mësojnë, ku sjelljet jo të mira të ndeshen rrallë. Kështu ne do të kemi më shumë kohë të merremi me mësimdhënien dhe të mësuarit e nxënësve tanë.

Në fillim, kjo ide mund të duket e frikshme. Shumë prej jush mund të punojnë në klasa me shumë nxënës apo me nxënës të moshave të ndryshme dhe mund të habiten: "Si mund të jap lëndë të ndryshme e të zbatoj metoda disiplinuese që t'i përshtaten çdo fëmije, kur në klasë kam 80 veta?". Në fakt, shqetësimi që na shkakton kjo situatë dhe paaftësia jonë për ta zgjidhur atë, mund të na shtyjë ta humbim durimin me nxënësit dhe të përdorim forma të ndryshme të ndëshkimit për të ndaluar sjelljen e keqe, si, p.sh., ndëshkimin fizik ose format e poshtërimit të ndëshkimit emocional. Në zemërim e sipër, ne shpesh harrojmë se fëmijët e kanë një arsye përse sillen keq. Disa prej këtyre arsyeve mund të jenë personale, të tjerat mund të vijnë nga edukata që kanë marrë, si, p.sh., kur ata mërzhiten nga mësimi apo nga leksionet e gjata. Arsye të tjera mund të vijnë nga faktorë të jashtëm, që kanë lidhje me familjen dhe komunitetin, të cilat e mendojnë dhe e dëshpërojnë fëmijën. Për më tepër, në disa raste, e sidomos ndër mësuesit e rinj, një incident mund të interpretohet si një problem discipline, kur ai nuk është i tillë, p. sh., kur pyetja e një fëmije është si një sfidë që i bëhet autoritetit dhe njohurive tona, por që mund të ketë lidhje me vështirësinë e nxënësit për të formuluar siç duhet pyetjen dhe me takt. Ky keqidentifikim apo keqkuptim shpesh krijon zemërim te nxënësit, duke hapur një telash të vërtetë discipline.⁴

Sidoqoftë, ekziston një prinje e përgjithshme për t'i rënë "shkurt", duke marrë masa ndëshkimi të rrepta, por të panevojshme, për të ndaluar sjelljen jo të mirë të fëmijës. Por fatmirësisht, sjellja jo e mirë dhe ndëshkimi mund të shmangen, kur ju krijoni një mjedis mësimdhënieje të organizuar mire, ku nxënësit tregojnë interes dhe marrin pjesë aktive në mësim.

Objektivi i një klase gjithëpërfshirëse e mësimdashëse është aktivizimi i nxënësve. Ata nxënës që marrin pjesë aktivisht dhe me dëshirë në procesin

⁴ "Kur të kërkojmë disiplinë!" Telekonferenca. http://www.educationworld.com/a_issues/chat/chat020.shtml [mbajtur në internet më 10/4/2005].

4 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

mësimor, shfaqin më pak probleme disiplinore.⁵

Atyre u pëlqen të vijjnë në klasë dhe janë gati të bëjnë gjithçka për të ndjekur mësimin.

PËRSE ËSHTË I NEVOJSHËM KY DOKUMENT?

Qëllimi i këtij dokumenti është t'ju ndihmojë të arrini objektivin tuaj. Ju mund të jeni një mësues me përvojë, i cili kërkon të zbatojë praktika të një disipline pozitive, por që ka nevojë për drejtim. Ju mund të jeni një student i caktuar të bëni praktikë mësimore në një institucion për të mësuar se si të edukohet drejt sjellja e nxënësve. Ju mund të jeni një trajnues për mësuesit, i cili jep udhëzime mbi disiplinën pozitive në kuadrin e programeve trajnuese për mësues para fillimit dhe gjatë karrierës së tyre. Ky dokument u vlen sidomos atyre që punojnë në shkollë e që kanë nisur të krijojnë mjedise mësimdashëse e të fokusuar te fëmija. Në shumë vende, shkolla të tilla i quajnë "Shkolla mikpritëse për fëmijët", që udhëhiqen nga parimet bazë të gjithëpërfshirjes së fëmijëve dhe parandalimit të dhunës ndaj tyre. Por për t'ia arritur këtij objektivi lipset të përmirësohen disa teknika.

Disa prej jush mund të punojnë në klasa të mëdha me shumë nxënës. Një klasë është e "madhe" atëherë kur ju duket juve e tillë. Zakonisht një klasë e madhe konsiderohet ajo me mbi 50 nxënës. Mësuesve që japin mësim në një klasë me 25 ose më pak nxënës, një klasë me 36 nxënës mund t'u duket e madhe dhe rraskapitëse. **Mjetet dhe burimet e cituara në këtë dokument do t'ju ndihmojnë të punoni me efektivitet me nxënësit, pavarësisht nga numri i tyre në klasë, dhe me sa më pak telashe të jetë e mundur.**

Mbi të gjitha, instrumentet e përmendura në këtë dokument do të jenë të vlefshme për të gjithë ata të cilët punojnë me reforma të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe, veçanërisht, në ato vende ku këto reforma janë drejtuar apo po drejtohen kundër përdorimit të ndëshkimit fizik. Në mbështetje të këtyre politikave, kanë dalë mjaft botime që nxisin ndalimin e ndëshkimit fizik dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për një shkollim bazë cilësor në një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës, siç theksohet dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF). Fatkeqësisht, mjaft mësues kanë mundësi shumë të kufizuara

⁵ "Mes dy zjarreve: Një perspektivë e disiplinës në shkollën e mesme". <http://people.uncw.edu/fischettij/david.htm> [nga interneti më 10/6/2005].

për të shfrytëzuar burime të tilla, ku mësohet se si të disiplinohen pozitivisht fëmijët, se si të eliminohet dhuna ndaj tyre në shkolla dhe në klasa. Për ata që janë të përfshirë në këtë proces, mësues të rinj dhe instruktorët e tyre apo për ata që thjesht duan të heqin dorë nga ndëshkimi fizik, ky dokument është një mjet i dobishëm, që i ndihmon të mësojnë e të zbatojnë në klasë disiplinën pozitive.

ÇFARË DO TË MËSONI?

Përvoja ka treguar se një ndër shqetësimet e mësuesve është paaftësia e tyre për të edukuar sjelljen e nxënësve.⁶ Këtu s'ka gjë për t'u habitur. Ndonëse janë bërë mjaft sugjerime, nuk ekziston ndonjë formulë magjike që t'u pajisë automatikisht me shprehitë që ju nevojiten për të plotësuar këtë detyrë të rëndësishme. Kërkohet kohë që këto shprehi të mësohen dhe të përmirësohen. Por, çdo mësues e di se shprehitë dhe strategjitë e mira janë përcaktuese në dallimin e një klase të qetë nga një klasë në kaos. Mësuesit në KGJM të organizuara mirë, ku të gjithë fëmijët mësojnë aktivisht dhe ndjekin me përpikmëri rregullat dhe rutinat e vendosura, shpenzojnë më pak kohë për mbajtjen e disiplinës dhe më shumë kohë për mësimdhënie.

Ky dokument ka pesë seksione. Çdo seksion përmban instrumente, që ju mund t'i shfrytëzoni për të krijuar një mjedis mësimor aktiv e pozitiv për nxënësit tuaj, ku në vend që të reagoni negativisht ndaj sjelljeve të tyre, ju i edukoni ata me efektivitet. Këto instrumente mësuesit dhe specialistët i kanë zhvilluar, duke u mbështetur në përvojën e tyre; ato janë përdorur me sukses në kontekste aktuale mësimdhënieje si me nxënës të rinj, ashtu dhe me më të rritur. Për më shumë informacion ju mund të shikoni dhe referimet që janë cituar në këtë dokument. Ato janë burime të shkëlqyera idesh, prandaj ne e kemi çmuar t'i përfshijmë këtu.

Në këtë seksion, ju keni mësuar mbi sfidat që dalin në procesin e mësimdhënies, se ç'është një "klasë gjithëpërfshirëse e mësimdashëse" dhe cili është objektivi i saj. Në seksionet në vijim, ju do të eksploroni procesin e disiplinimit pozitiv. Ky proces përbëhet nga katër elemente thelbësore, ku secili është një temë e një seksioni të veçantë të këtij dokumenti.

⁶ «Drejtimi në klasë, edukimi i sjelljes te nxënësi, udhëzime mbi lavdërimin efektiv dhe disa gjëra që duhen ditur rreth anglistes për folësa në gjuhë të huaja dhe çështje të tjera». <http://www.adprima.com/managing.htm> [updated April 3, 2005] [accessed online on 10/5/2005].

6 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

- (a) Të kuptuarit e dallimit mes ndëshkimit dhe disiplinës. Në këtë seksion ju do të mësoni mbi kuptimet e vërteta të "ndëshkimit" dhe "disiplinës", natyrën dhe pasojat e ndëshkimit fizik, si dhe fuqinë e disiplinës pozitive.
- (b) Një marrëdhënie pozitive dhe mbështetëse mes mësuesit dhe nxënësit, që bazohet te të kuptuarit dhe të mirëkuptuarit. Në këtë seksion ju do të mësoni pse nxënësit sillen siç dinë dhe pse ata mund të sillen dhe keq. Ju do të mësoni për nxënësit, duke u nisur nga këndvështrimi i tyre, se si mund të ndikojë konteksti nga ku vijnë mbi sjelljen e tyre dhe përshtypjen që ju keni për ta, si dhe mbi rëndësinë që ka përfshirja e çdo familjeje në edukimin e sjelljes së fëmijës së vet. Ju do të mësoni, gjithashtu, disa strategji të rëndësishme inkurajimi.
- (c) Krijimi i një mjedisi mësimor pozitiv dhe mbështetës për nxënësit dhe vetë ju. Sjelljet korrekte mund të zhvillohen vetëm në mjedise mësimore të organizuara dhe drejtuara mirë. Në këtë seksion ju do të mësoni për menaxhimin e mjedisit fizik të klasës tuaj, që ai të jetë sa më komod për mësimin dhe të nxisë sjellje të mira, edhe sikur klasa juaj të ketë shumë nxënës. Ju do të mësoni për rëndësinë e vendosjes së rutinave dhe standardeve të sjelljes dhe se si të përfshihen prindërit në edukimin e sjelljes së fëmijëve të tyre. Duke qenë një shembull i rëndësishëm për studentët, ju do të mësoni se ç'është stili i drejtimit dhe si ta përmirësoni atë, si dhe rrugët për një stimulim pozitiv të nxënësve.
- (d) Njohja e rrugëve konstruktive për të ndaluar sjelljet e këqia, si dhe për t'i parandaluar ato. Të gjithë fëmijët sillen ndonjëherë jo mirë. Testimi i hapave që hedhin për ta është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të vetëkontrollit. Në seksionin e fundit të dokumentit, ju do të mësoni një larmi rrugësh se si t'i trajtoni sjelljet sfiduese, rrugët e parandalimit të tyre dhe mënyrat e zgjidhjes së konflikteve. Ju do të mësoni, gjithashtu, disa teknika të disiplinës pozitive në përshtatje me moshën të caktuar, si dhe ato për fëmijë që kanë nevojë të veçanta.



Ndëshkimi në raport me disiplinën, kuptimi

Çfarë do të mësoni:

- E kaluara dhe e tashmja e fëmijëve
- Ç'është "ndëshkimi"
- Rreziqet e ndëshkimit fizik
- Ç'është "disiplina"
- Disiplina pozitive: Ç'është ajo dhe si funksionon

E KALUARA DHE E TASHMJA E FËMIJËVE

E kaluara

"Fëmijëve sot u pëlqen luksi, sillen keq, përçmojnë autoritetin, nuk tregojnë respekt për të moshuarit dhe u pëlqen të merren me llafe në vend që të mësojnë. Fëmijët janë shndërruar në tiranë, jo shërbëtorë të familjes së tyre. Ata nuk ngrihen më kur hyn në dhomë më i madhi. Ata kundërshtojnë prindërit, ulen mbi bangë dhe hanë ëmbëlsira, rrinë me këmbët mbledhur dhe tiranizojnë mësuesit."

Kjo deklaratë është bërë nga Sokrati, një filozof athinas, i cili jetoi nga 469 - 399 p.e.s.⁷ A mendoni se ka ndryshuar ndonjë gjë?

⁷ "Drejtimi i orës së mësimit". http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/cm-intro.html [nga interneti më 10/20/2005].

E tashmja: Rasti i Ramonit⁸

"Unë nuk dua të shkoj në atë klasë! Nuk dua të bëj siç thua ti!"

"Unë, madje, s'duhet të shkoj në atë klasë, sepse mamaja më thotë se duhet të ndjek një shkollë të veçantë. Thonë se unë jam me aftësi të kufizuara, se kam ADHD." (ADHD është Mungesë përqëndrimi.)

Ai lëshohet me vrap poshtë korridorit, duke u përplasur me fëmijët e tjerë dhe mësuesit, vjen në mëngjes në mes të klasës, duke deklaruar se çfarë s'ka ndërmend të bëjë dhe çirret e hidhet nëpër klasë sa herë që i hipën në kokë. Shokët e klasës i quan "klubi i budallenjve" dhe betohet se disa nxënës të klasës së gjashtë bëjnë veprime që veshët e mia m'i kanë dëgjuar vetëm në klasën e tretë të shkollës së mesme.

Ky është Ramoni, nxënës në klasën time. Sjellja e tij më ngre nervat. S'kam si të mos e urrej por, mbi të gjitha, ai më lodh shumë, pafuqia ime dhe sistemi ... Për shkak të atij fëmije atë ditë unë ika nga shkolla me lot në sy, me humor të prishur.

Si do të kishit vepruar ju?

Rasti i Ramonit, ndonëse një rast ekstrem, nuk është i vetëm. Thuajse të gjithë ne kemi patur nxënës të cilët, në një mënyrë apo në një tjetër, kanë sfiduar autoritetin tonë ose na kanë prishur orën e mësimit dhe kanë shqetësuar nxënësit e tjerë. Ramoni ka nevojë urgjente për t'u disiplinuar, por cilat janë mundësitë?



Reflektim: Si e keni disiplinuar ju veten?

Pa mendojeni veten kur keni qenë në shkollën fillore. Kur ju apo ndonjë shoku i klasës sillej si Ramoni, çfarë metodash disiplinore përdornin mësuesit tuaj? Shkruajini këto metoda në tabelën e mëposhtme. Pastaj përshkruani se cili ishte mendimi juaj për këto metoda dhe sa gjatë mendonit se do të zgjaste

⁸ Ky rast studimor është përshtatur nga ditari i Ellen Berg-ut, një mësues i arteve të gjuhës në shkollën e mesme Turner, Shën Luis, Misuri, SHBA. <http://www.middleweb.com/msdiaries01/MSDiaryEllenB6.html> [marrë nga interneti më 10/6/2005].

efekti i tyre. Si mendoni ju, si e ndjente veten fëmija? A keni parë apo dalluar ndonjë ndryshim të qëndrueshëm në sjelljen e tij?

Më tej, pyeteni veten: "Po të kisha një nxënës si Ramoni, çfarë do të bëja dhe përse? A mendoni se puna juaj do të kishte efekt afatgjatë në sjelljen e tij? Shkruani se çfarë mendoni për këto. A janë metodat tuaja të ngjashme me ato të mësuesve të tjerë?"

	Metodë disiplinore	Përse u përdor kjo metodë?	A ishte metoda gjithnjë efektive, sidomos afatgjatë? Si ndjehej fëmija?
Veprimet e mësuesit tuaj			
Veprimet tuaja			

Në shumë vende dhe shkolla Ramoni do të ishte ndëshkuar fizikisht për sjelljet e tija jo të mira, do të ishte rrahur me shkop ose me ndonjë objekt tjetër. Çfarë metode do të kishin përdorur mësuesit tuaj? Çfarë metode do të kishit përdorur ju?

Gjatë plotësimit të tabelës së mësipërme, s'do të habiteshim po qe se te kolona "Përse u përdor kjo metodë" ju do të ishit përgjigjur: "Të ndëshkohet fëmija për sjellje jo të mirë" ose "t'i jepet fund sjelljes së tij jo të mirë".

Edhe te kolona e fundit "A ishte metoda efektive, sidomos afatgjatë?", shumë prej jush, po ta kishit menduar gjerë e gjatë, ndoshta do të ishit përgjigjur: "Jo". Herët a vonë, i njëjti fëmijë do të sillet përsëri jo mirë, shpesh në të njëjtën mënyrë. Përse? Përgjigjen e jep dallimi që duhet bërë mes ndëshkimit dhe disiplinës.

KUPTIMI I NDËSHKIMIT

Ndëshkimi është një veprim (dënim) që merret ndaj një personi, i cili ka shkelur një rregull apo shfaq një sjellje jo të mirë. Ndëshkimi synon të kontrollojë sjelljen përmes mjeteve negative. Dy janë llojet e ndëshkimeve që përdoren kundër fëmijëve:

1. Ndëshkim që bëhet përmes qortimeve dhe mosaprovimeve verbale negative; ky tip ndëshkimi njihet si disiplina negative.
2. Ndëshkim që bëhet duke shkaktuar dhembje emocionale apo fizike, si në rastin e ndëshkimit fizik.

Fatkeqësisht, të dyja këto forma ndëshkimi përqendrohen te sjellja jo e mirë dhe efekti i tyre mund të jetë i vogël ose nul, duke mos e ndihmuar fëmijën që të sillet më mirë në të ardhmen. Përveç kësaj, fëmija mëson se i rrituri është superior, se ushtrimi i forcës - qoftë ai verbal, fizik apo emocional - është i pranueshëm, veçanërisht mbi më të vegjëlit dhe personat më të dobët. Ky mësim mund të çojë në incidente zënkash dhe dhune në shkollë, ku më të rriturit sundojnë mbi të vegjëlit dhe i detyrojnë ata t'u japin para, ushqime, detyrat ose gjëra të tjera me vlerë.

Përveç kësaj, në vend që ta pajisë fëmijën me aftësinë e vetëkontrollit, një ndëshkim i tillë e bën atë inatçi, e fyen dhe e frikëson. Ai i shkakton, gjithashtu, ndjenjën e turpërimit, fajit, ankthit, agresivitet të lartë, mungesë pavarësie dhe mungesë kujdesi ndaj të tjerëve, duke u hapur kështu telashe mësuesve, kujdestarëve dhe fëmijëve të tjerë.⁹

⁹ "Drejtimit dhe disiplinës pozitive". http://www.ces.ncsu.edu/depts/fcs/smp9/parent_education/guidance_discipline.htm [marrë nga interneti më 10/10/2005].

Ndëshkimi verbal dhe trajtimi i inatit

Disiplina negative është një formë ndëshkimi, që mendohet se kontrollon sjelljen e nxënësit, por shpesh ajo konsiston vetëm në urdhëra ose deklarata të shkurtra verbale dhe nuk jep një dënim të plotë e të ashpër, siç janë rrahja apo poshtërimi i rëndë. Mësuesit që nuk përdorin ndëshkimin fizik, në vend të tij mund të aplikojnë metodën e disiplinës negative. Por edhe kjo, njëllon si ndëshkimi fizik, mund të shkaktojë zemërimin dhe agresivitetin apo ndjenjën e inferioritetit të fëmija. Strategjitë negative përmbajnë:

Urdhëra - "Ulu dhe rri urtë!", "Shkruaj 100 herë: "Unë s'do të humbas kohën me ty.".

Deklarata ndaluese - "Mos e bëj më këtë!".

Deklarata shpërthyesë zemërimi - "I ke hapur një telash vetes që ti s'e kupton.".

Deklaratë kritikuese - "Vetëm kështu di të veprosh ti!".

Deklaratë kërcënuese - "Po s'pushove, do të çoj te Drejtori!".

Deklaratë tallëse - "A do mësosh ndonjëherë të shkruash mirë?".

Shpesh, ne i përdorim këto strategji negative, si dhe ndëshkimin fizik, kur zemërohemi apo zhgënjehemi. Por ekzistojnë një larmi mënyrash pozitive për të shmangur zemërimin dhe zhgënjimin. Disa prej mësuesve u thonë nxënësve të tyre se "Kam nevojë për pak qetësi, tani jam ca i nervozuar.". Të tjerë qetësohen duke numëruar deri në dhjetë ose duke u larguar për disa minuta nga klasa. Disa mësues ua shprehin ndjenjat e tyre nxënësve, që ata ta kuptojnë se çfarë i mërzit. Kështu fëmijët mësojnë se çfarë nuk duhet të bëjnë dhe përse. Ata do të donin ta përsërisnin gabimin, por ata janë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe e dinë se do t'u duhet të durojnë pasojat. Cila metodë do të ishte më e mira për ju?



Veprimtari: "Mos" – Sa negativ jam unë?

Shumë prej nesh u japim natyrshëm nxënësve urdhëra "mos", si formë e disiplinës negative: "Mos fol gjatë orës së mësimi. Mos lëviz nga banga.". Ne mbase s'e kuptojmë se sa shpesh i japim këto komanda; ato dalin natyrshëm, por nxënësit e dinë. Nëse doni të zbuloni se sa shpesh jepni urdhëra "mos", zgjidhni një nxënës të klasës (ose kërkoni ndihmë kujdestarit të klasës) dhe jepini atij një kuti me gurë apo guacka të vogla, dhe një qese prej cohe apo plastike. Kërkoni nxënësit t'ju dëgjojë për një javë rresht. Sa herë që nxënësi t'ju dëgjojë të jepni urdhërin "mos", kërkoni të marrë një gur apo guackë nga kutia e ta fusë në qese. Në fund të javës, numëroni sa gurë a guacka ndodhen në qese. A do të habiteshit?

Në vend që të jepni vazhdimisht urdhëra "mos" (megjithëse ndonjëherë ato janë të nevojshme), mësoni t'i riformuloni ato në mënyrë pozitive, duke kërkuar qartë se si duhet të sillen. Për shembull, në vend që t'u thoni: "Mos vraponi në klasë.", provoni të thoni: "Ecni pa vrapuar në klasë.". Kështu ju deklaroni se si duhet të veprojnë nxënësit tuaj. Në ndonjë rast do të donit të bënit shpjegimet tuaja për një rregull të caktuar, sidomos kur e deklaroni për herë të parë. Shpjegimi i një rregulli mund të bëhet kështu: "Ecni me hap në klasë. Po vrapuat, mund të vriteni në bangë e, mbase, do të keni nevojë të shkoni te mjeku.".

Ndëshkimi fizik

Kur merren me nxënës si Ramoni, shumë mësues, ndoshta, përdorin forma të ashpra ndëshkimi. Dy janë format e ndëshkimit të ashpër, ai i ndëshkimit fizik dhe ai i ndëshkimit emocional, të cilët përdoren veç e veç ose të dyja së bashku. Që të dyja janë forma dhune kundër fëmijëve, ato shkelin të drejtat e tyre si qenie njerëzore, të drejtën e tyre për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës.

Ndëshkimi fizik apo emocional dhe kanosja përmes tij ndodh kur një mësues, prind apo kujdestar kërkon t'i shkaktojë një fëmije një dhembje fizike ose shpirtërore, zakonisht për të ndaluar sjelljen e tij jo të mirë, për ta penalizuar sa herë që ai bën një veprim të tillë dhe për të parandaluar

përsëritjen e tij.¹⁰ Çdo ditë e më tepër ndëshkimi ilegal po ndalohet ligjërisht në shumë vende të botës, pasi ai nuk ka treguar se ndihmon "të mësuarit". Ndëshkimi fizik ndryshon nga njëri vend në tjetrin, kjo varet nga kultura e vendit, dhe përfshin p.sh.:

- rrahjen me shpulla ose me ndonjë objekt (si shufër, rrip, kamzhik, këpucë, libër, vizore, etj.);
- goditjen me shqelm, shkundjen apo hedhjen përtokë;
- pickimin apo shkuljen e flokëve;
- shtrëngimin e fëmijës që të qëndrojë në pozicione të sikletshme;
- detyrimin e fëmijës që të bëjë ushtrime të rënda fizike apo punë të detyruar;
- djegien apo nxirjen e lëkurës;
- detyrimin për të ngrënë substanca të pështira (si sapun).

Në një kohë që ndëshkimi fizik synon të shkaktojë dhimbje fizike, ndëshkimi emocional synon poshtërimin e fëmijës, shkaktimin atij të një dhembjeje psikologjike. Njëlloj si ndëshkimi verbal negativ, por edhe më i rëndë, ai mund të përmbajë talljen publike, sarkazmën, kërcënimin, sharjen, çirrjen dhe urdhërimin ose veprime të tjera poshtëruese, si heqja e një veshjeje fëmijës, ndalimi i ushqimit apo detyrimi të qëndrojë në një pozicion poshtërues, që të tjerët ta shohin e ta komentojnë.

Ndërsa ndëshkimi fizik është më i dukshëm, ndëshkimi emocional është më i vështirë të identifikohet. Megjithatë, ndëshkimi i një fëmije duke e nxjerrë jashtë që të qëndrojë për orë të tëra në diell, duke e vrarë në sedër përmes talljes publike apo mohimi i ushqimit, apo veshjes është po aq i dëmshëm sa dhe format e ndryshme të ndëshkimit fizik.

Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë vijë e qartë ndarëse mes ndëshkimit fizik dhe ndëshkimit emocional. Shumë shpesh, fëmijët e perceptojnë ndëshkimin fizik si një veprim poshtërues dhe degradues.¹¹ Megjithatë, në këtë dokument ne me termin "ndëshkim fizik" përfshijmë si ndëshkimin fizik dhe atë emocional.

¹⁰ Durrant, Xhoan E. "Mbizotërimi i ndëshkimit fizik, simptomat dhe implikimet në zhvillimin e fëmijës," te: Hart, Stuart N (ed.), « Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt disiplinës konstruktive për fëmijët ». Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

¹¹ "Dhënia fund ndëshkimit fizik në Zambia". *Save the Children* Suedi, Zyra Rajonale për Afrikën e Jugut, Arkadia, 2005



Strategji veprimi: A është ky një ndëshkim fizik?

Lexoni studimin e rastit që vijon më poshtë. Reflektoni - dhe ndoshta e diskutoni dhe me kolegët tuaj - nëse ky është një shembull ndëshkimi fizik dhe nëse dënimi i ka dhënë fëmijës ndonjë mësim.

Ora e mësimin të Shirinit

Shirini shkon çdo ditë në shkollë dhe në pjesën më të madhe të kohës ajo kënaqet aty, me përjashtim të orëve të drejtshkrimit. Ditët që ajo ka më shumë frikë janë ditët kur bëhet kontrolli i drejtshkrimit. Për çdo fjalë që ajo apo shokët e saj shkruajnë gabim, mësuesi i detyron t'i ngjiten kodrës prapa shkollës dhe të sjellin poshtë pesë tulla. Tullat përdoren për të ndërtuar murin rrethues të shkollës. Shirini nuk arrin ta kuptojë se si mbajtja e tullave mund ta ndihmojë atë të mësojë drejtshkrimin, por asaj s'i mbetet gjë tjetër veçse të bëjë punën. Ndonjëherë, kur ajo mbaron punën, rrobat i ndoten dhe, më pas, ha të shara edhe në shtëpi.

Sa shpesh përdoret ndëshkimi fizik dhe pse?

Kujtoni vitet tuaja të shkollës. A jeni ndëshkuar ndonjëherë ju apo ndonjë shoku juaj fizikisht apo emocionalisht? Ka shumë mundësi që ju të përgjigjeni "po", sepse ndëshkimi fizik është një praktikë e zakonshme në mbarë botën. Vetëm në 15 nga 190 e më shumë vende në botë është i ndaluar ndëshkimi fizik i fëmijëve. Në vende të tjera prindërit dhe kujdestarë të tjerë, ku përfshihen dhe mësuesit, e quajnë "të drejtë" t'i rrahin dhe t'i poshtërojnë fëmijët.¹²

Ndërsa shumë nga ne do ta dënonin dhunën në përgjithësi, edhe dhunën ndaj të rriturve, shumë pak njerëz në botë i kanë kushtuar vëmendje serioze dhunës ndaj fëmijëve. Përse? Sepse ka ende tradita të vjetra dhe besime kulturore, të cilat e mbajnë gjallë përdorimin e ndëshkimit në shumë shoqëri.

¹² Nevell, Peter. "Imperativi mbi të Drejtat Njerëzore për ndalimin e të gjitha ndëshkimeve fizike ndaj fëmijëve," në: Hart, Stuart N (ed.), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rrugë drejt disiplinës konstruktive për fëmijët". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

"Kush kursen drurin, llaston fëmijën", thotë një proverb popullor. Të tjerë thonë se ndëshkimi fizik është (1) efektiv, (2) ai parandalon që fëmija të marrë rrugë të keqe, (3) u mëson të dallojnë të mirën nga e keqja, (4) i mëson të respektojnë, dhe (5) ndryshon nga abuzimi fizik. Megjithatë, studimet kanë treguar se ndëshkimi fizik nuk realizon asnjë nga këto dhe është, në fakt, një formë e abuzimit të dhunshëm kundër fëmijëve.¹³

Më poshtë do të shohim besime dhe fakte të tjera të lidhura me ndëshkimin fizik.¹⁴ A keni dëgjuar ndonjërin të ketë përdorur një nga këto për të justifikuar përdorimin nga ana e tij të ndëshkimit fizik? A keni vepruar ju ndonjëherë në këtë mënyrë apo, të paktën, t'ju ketë vajtur mendja për to? Tregohuni të sqartë.

Besimi nr. 1: "Më ka bërë mua vaki dhe s'më ka gjetur gjë."

Fakti: Ndonëse ata mund të kenë ndjerë frikë, të jenë zemëruar dhe të kenë humbur besimin, kur janë rrahur nga prindërit ose mësuesit, njerëzit që përdorin këtë argument e bëjnë shpesh për të zbutur ndjenjën e fajit që ndiejnë për ndëshkimin fizik që ushtrojnë sot ndaj fëmijëve të tyre. Me mendje ata mbrojnë veprimet e dhunshme ndaj fëmijëve të tyre. Sidoqoftë, veprimet e tyre tregojnë se ndëshkimi fizik atyre, në fakt, u ka bërë dëm; ai e ka mbajtur gjallë ciklin e dhunës, të cilën tani ata e ushtrojnë mbi fëmijët e tyre dhe, po kështu, këta fëmijë ka të ngjarë të vazhdojnë dhunën mbi brezin tjetër.¹⁵ Përveç kësaj, shumë gjëra, që brezat e mëparshëm kanë arritur të transmetojnë, tashmë nuk praktikohen më. Për shembull, fakti që disa veta mund të mos jenë vaksinuar kur kanë qenë fëmijë, s'do të thotë se ata do ta preferonin këtë gjë edhe për fëmijët e tyre TANI.

Besimi nr. 2. "S'ka mbetur gjë tjetër!" ose "Vetë e kërkujnë!"

Fakti: Ndërkohë që disiplina kërkon të zhvillohet besimi, marrëdhënia e respektit reciprok mes fëmijës dhe mësuesit të tij, shkaktimi i dhimbjes

¹³ Durrant, Xhoan E. "Mbizotërimi i ndëshkimit fizik, simptomat dhe implikimet në zhvillimin e fëmijës," te: Hart, Stuart N (bot..), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt disiplinës konstruktive për fëmijët". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

¹⁴ Përshtatur nga "Ndëshkimi fizik drejt alternativave të disiplinës pozitive në Kenia". Një dokument avokatie (drafti 2) nga Kapitulli ANPPCAN Kenya, Janar 2005. [http://kenya.ms.dk/articles/advocacy %20document%20 ANPPCAN.htm?udskriv+on%5D](http://kenya.ms.dk/articles/advocacy%20document%20ANPPCAN.htm?udskriv+on%5D) [marrë nga interneti mw 9/29/2005].

¹⁵ Durrant, Xhoan E. "Mbizotërimi i ndëshkimit fizik, simptomat dhe implikimet në zhvillimin e fëmijës," te: Hart, Stuart N (bot..), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt disiplinës konstruktive për fëmijët". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

është rruga më e lehtë. Me këtë ne pranojmë se kemi dështuar në përpjekjet tona për të ndihmuar fëmijën të mësojë dhe të sillet mirë. Në rast se ne përdorim rregullisht ndëshkimin fizik, do të duhet shumë kohë e mund që metodat e reja të funksionojnë. Po qe se ne ua nxijmë jetën duke u çirur, duke i kërcënuar apo ndëshkuar fizikisht, nxënësve tanë për një kohë të gjatë, do të jetë e vështirë për të ndërtuar me ta marrëdhënie efektive e mirëbesimi menjëherë. Kjo mund të na krijojë idenë sikur asgjë nuk funksionon më ose që fëmijët po "e kërkojnë vetë " drurin, por problemi ka të bëjë me metodën e disiplinës dhe jo me sjelljen jo të mirë të fëmijëve. Të justifikohesh se fëmija e kërkon vetë dhunën, do të thotë që dhunuesi ta ndjejë veten më pak fajtor, duke ia vënë fajin viktimës. Por a do ta godisnit ju bosin, punonjës, gruan apo mikun tuaj të ngushtë, kur t'ju dukej se "asgjë tjetër nuk funksionon"? Ma merr mendje se jo!

Besimi nr. 3: "Ndëshkimi fizik funksionon më mirë. Metodat e tjera jo."

Fakti: T'i detyrosh nxënësit të sillen mirë nga frika e ndëshkimit, kjo nuk është e njëjtë me disiplinën. Ndëshkimi fizik duket se funksionon vetëm në rast se ju e shikoni problemin në mënyrë sipërfaqësore dhe jo në perspektivë. Ndëshkimi fizik u mëson nxënësve të bëjnë atë që thoni ju, por vetëm kur ju ndodheni aty. Në fakt, ai u mëson atyre dinakërinë, si të shtiren për të shmangur rrahjen apo ndëshkime të tjera poshtëruese. Duke krijuar një klimë mosbesimi dhe pasigurie te fëmija, ai shkatërron raportin mësues - fëmijë. Fëmijët inatosen me atë që në vend që t'i kërcënojnë, rrahë apo fyejë, duhet t'i mësonte e të kujdesej për ta. Në rast se një akt i vetëm ndëshkimi mund të duket i efektshëm, ai vetëm sa e frikëson fëmijën të bindet.

Besimi nr. 4: "Ndëshkimi fizik i mëson si të binden."

Fakti: Në të kaluarën, mund të ketë qenë praktikë e zakonshme t'u mësoje fëmijëve t'i bindeshin autoritetit, por kohët kanë ndryshuar. Shumë mësues po përshtasin teknika të mësuarit që fokusohen te nxënësi, të cilat i inkurajojnë fëmijët të eksplorojnë, të mendojnë për veten, të bëjnë pyetje dhe të mësojnë të ndiejnë gëzimin e gjetjes së zgjidhjeve, si rruga më e mirë e të mësuarit. Ndëshkimi fizik e pengon fëmijën të bëjë pyetje, të mendojë në mënyrë kritike dhe të përpiqet të arrijë objektiva vetjake. Por këto cilësi u nevojiten si të rriturve ashtu edhe fëmijëve për të shkëlqyer në një shoqëri dinamike, konkurruese dhe inovative. Imponimi i një bindjeje të verbër përmes kërcënimit të ndëshkimit fizik, e mbylq iniciativën dhe shpirtin krijues të fëmijëve (dhe të rriturve).

Besimi nr. 5: "Unë e përdor vetëm si mjet të fundit. S'kam patur zgjidhje tjetër."

Fakti: Ky justifikim ne na mbron dhe i mëson nxënësit se përdorimi i dhunës justifikohet si mjet i fundit. Ky argument nuk është i pranueshëm. Për shembull, a mund të justifikohet një bashkëshort që rreh të shoqen, me pretendimin se e paska përdorur si mjet të fundit? Kjo s'duhet pranuar dhe kur bëhet fjalë për nxënësit tanë. Por për prindërit dhe mësuesit është më se e zakonshme të përdorin ndëshkimin fizik që në fillim - dhe jo si mjet i fundit - dhe për gabime shumë të vogla.

Besimi nr. 6: "Është e vetmja mënyrë se si t'i mbaj nën kontroll fëmijët e klasës time. Unë kam shumë nxënës!"

Fakti: Ky justifikim është i zakonshëm mes mësuesve, të cilët kanë klasa të mëdha, ndonjëherë deri në 100 fëmijë në një klasë. Kjo vjen ngaqë në klasa nuk vendosen rregulla dhe rutina, fëmijët nuk dinë se si duhet të sillen dhe cilat janë masat në raste shkeljesh, dhe mësuesi nuk merr mundimin të ndërtojë raporte pozitive me ta, që dhe ata të përpiqen të sillen mirë. Kjo mund të vijë prej stilit të tij autoritar të drejtimit të orës së mësimt, si dikush që thotë: "Unë jam mësuesi dhe gjërat do të bëhen si them unë!". Në përpjekje për t'i mbajtur nën kontroll, mësuesi mund të përdorë ndëshkimin fizik jo thjesht për të ndaluar sjelljet jo të mira të një fëmije, por dhe për t'u futur frikën fëmijëve të tjerë, me shpresën se ata nuk do të guxojnë të sillen ashtu (por ata prapë guxojnë). Si te miti nr. 4, pak më lart, imponimi i bindjes së verbër përmes kërcënimeve të dhunës fizike nuk i inkurajon fëmijët të mësojnë prej mësuesit, por vetëm ta kenë frikë atë. Për rrjedhim, ata nuk duan të mësojnë, gjë që e bën punën tonë më të vështirë; ata nuk mësojnë mirë, gjë e cila reflekton punën e dobët të mësuesit.

Besimi nr. 7: "Ndëshkimi fizik është pjesë e kulturës tonë."

Fakti: Ndëshkimi fizik mbrohet, ndonjëherë, si pjesë e kulturës që fitohet në shoqëri dhe ideja e nxitjes së alternativave ndaj ndëshkimit fizik është një "imponim" perëndimor, që nuk i merr në konsideratë vlerat aziatike. Shoqëritë aziatike mbështeten në hierarki të ndërtuara mbi bazën e moshës dhe të idesë se më i vogli duhet të respektojë, t'u shërbejë më të vjetërve, duke përfshirë këtu dhe mësuesit. Ndonëse ndëshkimi fizik është mjaft i përhapur në Azi, nuk ekziston ndonjë lidhje shkakësore mes besimeve tradicionale dhe dhunës ndaj fëmijëve përmes ndëshkimit fizik. Përkundrazi, dy prej vlerave thelbësore të shoqërive aziatike janë ruajtja e harmonisë sociale dhe të mësuarit e disiplinimit mendor të trupit, veçanërisht për sa i përket ruajtjes së vetëkontrollit në mes të kaosit. Dhuna përmes ndëshkimit

fizik drejtohet kundër vlerave tradicionale aziatike. Ai shkatërron harmoninë sociale në klasë, raportet nxënës - mësues dhe nxënës me nxënës, dhe kërcënon çdo marrëdhënie që fëmija do të ketë në të ardhmen. Ai ul besimin dhe vetëvlerësimin e fëmijëve, dhe legjitimon mungesën e vetëkontrollit si një mënyrë e pranueshme për të sunduar mbi të tjerët. Metodatat tradicionale janë alternativa shumë më të mira disipline, sepse ato nuk e përmbajnë dhunën¹⁶, p.sh., kur respektohet sjellja e mirë dhe jo e dhunshme model e të moshuarve, e cila imitohet nga fëmijët e tyre.¹⁷ Përveç kësaj, besime individuale dhe kulturore, të cilat e mbajnë gjallë ndëshkimin fizik, mund të zëvendësohen brenda një kohe shumë të shkurtër.¹⁸

A funksionon ndëshkimi fizik? Çfarë pasojash ka?

Ndëshkimi fizik është mjaft i përhapur, sepse mësuesit besojnë se ai funksionon, se është efektiv. Por a është e vërtetë kjo? Studimet, të shtrira në harkun kohor të dy dekadave, kanë treguar se i vetmi rezultat pozitiv i ndëshkimit fizik është zgjidhja afatshkurtër, ndërsa efektet negative janë shumë më të mëdha se sa ky rezultat.¹⁹ Përdorimi i ndëshkimit fizik rrallëherë ka prodhuar efektet e dëshëruara, që do të thotë ndryshime afatgjata pozitive në sjelljen e nxënësit. Përkundrazi, ai mund të ketë pasoja shumë negative si për fëmijën ashtu dhe për ju.

- Kur ne përdorim ndëshkimin fizik, rezultatet janë të paparashikueshme. Ato çojnë në dëshpërim, uljen e vlerësimit për veten, zemërim, tërbim, agresivitet, dëshirë për hakmarrje, makthe dhe lagie natën, mungesë respekti ndaj autoritetit, gjendje të lartë depresive,

¹⁶ *Save the Children*. "Si të studjohet ndëshkimi fizik dhe emocional i fëmijëve." Bangkok: Rajoni i Azisë Juglindore, Lindore dhe Paqësorit, 2004.

¹⁷ Informacion i siguruar nga Elizabeth Protacio-de Castro, Kryetare e Programit mbi Traumata Psikosociale dhe të Drejtat e Njeriut, Qendra për Studimet mbi Zhvillimin Integruar, Universiteti i Filipineve dhe e dokumentuar te Pauer, Klark F. dhe Hart, Stjuart N. "Rruga drejt një disipline konstruktive për fëmijën" te: Hart, Stuart N (bot.), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt një disipline konstruktive për fëmijën". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

¹⁸ Durrant, Xhoan E. "Mbizotërimi i ndëshkimit fizik, simptomat dhe implikimet në zhvillimin e fëmijës," te: Hart, Stuart N (bot.), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt disiplinës konstruktive për fëmijën". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

¹⁹ Po aty.

ankth, përdorimin e drogës, abuzimin e fëmijës, dhunë në familje, kriminalitetin e fëmijëve dhe, sigurisht, më shumë ndëshkime fizike.²⁰

- Fëmijët, të cilët janë ndëshkuar fizikisht, kanë treguar se zhvillojnë sjellje antishoqërore, se janë të prirur ta përdorin dhunën pa e peshuar punën, duke krijuar vazhdimësi të abuzimit fizik nga një brez në tjetrin.²¹ Duke ushtruar dhunën, ne mësojmë dhunën.
- Si mësues, ne jemi përgjegjës për përmirësimin e edukimit dhe zhvillimin e nxënësve. Ndëshkimi fizik mund të dëmtojë rëndë zhvillimin e fëmijës dhe t'i shkaktojë probleme ambjentimi në shkollë, si dhe probleme sociale, ndërpersonale dhe psikologjike. P.sh., studimet kanë treguar se disa prej viktimave të ndëshkimit fizik kanë qenë të detyruar të lënë shkollën, sepse kanë patur frikë nga rrahja ose poshtërimi. Sapo e braktisin shkollën, ka shumë gjasa që ata të dalin në rrugë e të përdorin apo të shesin drogë, ose të merren me aktivitete të tjera shoqërisht të papranueshme.^{22, 23}
- Edhe kur ne, për një cast, arrijmë të ndalojmë sjellje jo të mira, përdorimi i ndëshkimit fizik nuk e përmirëson sjelljen e fëmijës. Përse? Sepse fëmija nuk e kupton, nuk mëson se ç'duhet të bëjë, çfarë sjellje i kërkohet të mbajë, ai mëson vetëm se duhet të ndalojë atë që po bën. Është njësoj sikur juve t'ju thonë të mos përdorni ndëshkimin fizik, por pa ju treguar se çfarë metodash disiplinore alternative mund të përdorni.
- Përdorimi nga ana jonë e ndëshkimit fizik mund të bëjë efektin e kundërt, d.m.th. padashur ai e përforcon sjelljen e keqe. P.sh., tërheqja e vëmendjes së prindërve dhe shokëve mund të jetë ajo që synon një fëmijë ngatërrestar si Ramoni.

²⁰ Po aty.

²¹ Nga ndëshkimi fizik tek alternativat e disiplinës pozitive: Alternativa ndaj ndëshkimit fizik / trupor në Kenia. Një dokument avokatie (Drafti i dytë) nga Kapitulli i ANPPCAN Kenya, Janar 2005. <http://kenya.ms.dk/articles/advocacy%20document%20ANPPCAN.htm?udskriv+on%5D> [marrë nga interneti më 9/29/2005].

²² Po aty.

²³ Kotton, Katherine. Disiplina në shkollë dhe në klasë. Një varg studimesh mbi përmirësimet në shkollë. Vështrim nga afër #9. <http://www.nwrel.org/scpd/sirs/5/cu9.html> [marrë nga interneti më 10/6/2005].

- Ndëshkimi fizik shpesh shkakton zemërim dhe armiqësi, duke e bërë më të vështirë krijimin në të ardhmen të raporteve të mira dhe të mirëbesimit mes mësuesit dhe nxënësit, si dhe midis vetë nxënësve. Kjo e vështirëson më shumë punën tonë, e bën më pak shpërblyese dhe tejet të lodhshme. Ne fillon të na zërë frika të shkojmë të japim mësim në klasë. Nxënësit tanë mund ta nuhasin pakënaqësinë tonë dhe mund të mos duan as ata të vijmë në klasë.
- Fëmijët që janë viktimë të ndëshkimit fizik, mund të përfundojnë me plagë që kanë nevojë për mjekim, mund të mbeten me dëmtime të përhershme apo mund t'u shkaktohet vdekje. Qoftë dhe kërcënimi për përdorim të dhunës fizike mund të shkaktojë dëm. Për shembull, kur një mësues kërcënon duke ngritur lart një shkop, ai mund të shpojë pa dashje syrin e studentit. (Fatkeqësisht një incident i tillë ka ndodhur vërtet).

KUPTIMI I DISIPLINËS

Disiplina është një fjalë shpesh e keqpërdorur, sidomos kur asaj i jepet gabimisht i njëjti kuptim me ndëshkimin. Për shumë mësues, disiplina do të thotë ndëshkim. "Ky djalë ka nevojë të disiplinohet" përkthehet në: "Ky djalë ka nevojë për pëllëmbë në prapnicë apo rrahje me shkop." . Kjo është **GABIM!**

Disiplina është procesi i të mësuarit ose trajnimit të një personi që t'u bindet rregullave ose një kodi sjelljeje në një kuadër afatshkurtër dhe atë afatgjatë.^{24, 25}

Ndërkohë që ndëshkimi nënkupton **mbajtje nën kontroll** të sjelljes së fëmijës, disiplina nënkupton **zhvillimin** e sjelljes së fëmijës. Disiplina i mëson fëmijës vetëkontrollin dhe besimin, duke e fokusuar atë tek ato gjëra që ne duam t'ia mësojmë atij dhe në ato gjëra që ai ka aftësi t'i mësojë. Kjo është baza për t'i mësuar fëmijët se si të jenë në harmoni me veten e tyre dhe të

²⁴ Kersi, Katharine C. "Mos na i mbytni fëmijët tanë: Një udhëzues për prindër dhe mësues drejt disiplinës pozitive". <http://www.cei.net/~rcox/dontake.html> [marrë në internet më 10/10/2005].

²⁵ Uelker, J. Eileene. "Shtrydhini limonat e bëjini limonadë: Shfrytëzoni anët pozitive për të disiplinuar fëmijët". <http://ohioline.osu.edu/hyg-fact/5000/5153.html> [marrë në internet më 10/10/2005].

shkojnë mirë me të tjerët. Qëllimi më i lartë i disiplinës është që fëmijët të kuptojnë sjelljen e tyre, të marrin iniciativë, të tregohen të përgjegjshëm për zgjedhjet që bëjnë dhe të respektojnë veten e tyre dhe të tjerët. Me fjalë të tjera, ata përvetësojnë një proces pozitiv të menduarit dhe të sjellurit, që mund t'u shërbejë gjatë gjithë jetës. Për shembull, kur ju shkon mendja te një "person i disiplinuar", çfarë ju kujtohet? Një gjimnazist olimpik, dikush që ka lënë një huq të keq, si p.sh., pirjen e duhanit, dikush që ruan qetësinë në mes të kaosit. Të gjitha këto kërkojnë vetëkontroll, ky është dhe qëllimi i disiplinës.

Disiplina formon sjelljen e një fëmije dhe e ndihmon atë të mësojë se ç'është vetëkontrolli, kur i jep kurajo dhe jo kur i lë pasoja të dhimbshme e të pakuptimta. Në rast se ju jeni prind apo miku juaj ka fëmijë, pa kujtoni vitin e parë apo të dytë të jetës së një fëmije! Si mësohet ai të përplasë duart, të ecë apo të flasë? Ju ose miku juaj ndoshta keni përdorur teknika mësimi përmes dhënies së shembujve (të njohur, gjithashtu, si "modelim"), duke bërë lëvdata dhe duke u dhënë mundësinë të ushtrohen, jo duke u çirrur, as duke ua futur me pëllëmbë, duke i fyer apo duke i kërcënuar. Ky inkurajim është një lloj shpërblimi që e stimulon fëmijën të punojë, të mësojë dhe të ketë rezultate të mira. Kështu arrihet që fëmija të çmojë veten, ai mëson se shpërblimi apo lëvdata fitohet me meritë. Fëmijët mund të zgjedhin: t'i fitojnë ose t'i humbasin ato. Kjo u jep atyre aftësinë e vetëkontrollit në jetë, që është një element kyç për një vlerësim të shëndetshëm të vetes. Edhe kur nuk i inkurajojmë për sjellje jo të mira - si moskushtimi i vëmendjes kur kanë shpërthime ndjenjash apo vijnë vonë në klasë - me kalimin e kohës, kur fëmijët nuk arrijnë të tërheqin vëmendjen përmes sjelljes jo të mirë, ata mësohen të kontrollojnë veten. Ata e kuptojnë se mund të tërheqin vëmendjen e tjetrit vetëm kur sillen mirë, kur arrijnë në kohë, domethënë, kur ju e shihni se ata veprojnë mirë.

Le të kthehemi edhe njëherë te Ramoni dhe se si mësuesi i tij e disiplinoi atë dhe mësoi prej tij.

Studim rasti: Ndryshimi i Ramonit²⁶

Java e re nisi njëlloj si ajo që sapo kaloi. Ramoni me sjelljen e tij vazhdonte të prishte rregullin dhe qetësinë në klasë dhe të gjithë po çmendeshin. Por gjatë fundjavës që kaloi, unë e vrava mendjen gjatë për Ramonin. Nisa të mendoj se çfarë përshtypje më kishte lënë ai dhe përshtypja kryesore që se ai më kishte zemëruar dhe më kishte irrituar shumë. Sipas librit "Disiplina bashkëpunuese", mënyra se si ndjehemi kur një nxënës sillet jo mirë, na tregon se çfarë objektivi i ka vënë vetes nxënësi që sillet keq. Sapo mësojmë përse nxënësi bën ato që bën, është më e lehtë të gjemë rrugën se si të merremi me të.²⁷

Zemërimi na tregon se nxënësi po tenton të marrë pushtet, ndërsa irritimi na tregon se nxënësi kërkon të na tërheqë vëmendjen. Duke menduar për këto, unë e kuptova se Ramoni sjelljen e tij irrituese e shfaqte në sy të shokëve të klasës dhe më të rriturve me zë të lartë dhe egërsi të madhe, që të tërhiqte sa më shumë vëmendjen e të gjithëve. Kur ai arrinte të na e tërhiqte vëmendjen, kërkonte të fitonte pushtet, duke kundërshtuar hapur që t'i bindej kërkesës sonë për të ndaluar, duke na i ngritur të gjithëve nervat. Atëherë unë thashë me vete se duhej t'i jepja Ramonit kontrollin mbi mua dhe mbi klasën. Mbi të gjitha, s'i vë faj, unë jam përgjegjëse për veprimet e mia. Fillova të kuptoj se edhe duke mos patur kontroll mbi të, unë mund të kontrolloja ato që thosha dhe ato që bëja. Kështu, u krijua një plan i ri dhe mora një qëndrim të ri.

Të mërkurën në mëngjes mora vendim që çfarëdo gjëje të bënte Ramoni, unë s'do t'i kushtoja vëmendjen që kërkonte sjellja e tij, duke e injoruar. Kur ai erdhi në klasë dhjetë minuta më vonë, unë bëra sikur s'e vura re. I dhashë kujdestarit të klasës një fije letër dhe i kërkoja të shënonte gjithçka që do të bënte Ramoni, dhe nuk ndërhyra fare në sjelljen e tij.

Ramoni s'la gjë pa bërë gjatë asaj kohe, vetëm për t'u zhveshur lakuriq, nuk u zhvesh. Lëvizte mes bangave, luante me flokët e të tjerëve, i mori syzet kujdestarit dhe i vuri vetë, bënte sikur donte të hapte derën për të dalë jashtë, madje i hipi kujdestarit mbi bangë. Ne s'folëm asnjë fjalë. E

²⁶ Ky rast studimor është përshtatur nga ditari i Ellen Berg, një mësues i arteve të gjuhës në shkollën e mesme, Shën Louis, Misuri, SHBA., <http://www.middleweb.com/msdiaries01/MSDiaryEllenB7.html> [marrë nga interneti më 10/6/2005].

²⁷ Albert, Linda dhe Desisto, Pete. Disiplina bashkëpunuese. Shërbimi i Drejtimit Amerikan, 1996.

gjitha klasa më shihte sikur të kisha lojtur nga mendtë. Unë u shpjegova se për ne ishte më me rëndësi të prishej ora e mësimit prej atyre që nuk e donin atë, kështu që e vazhduam mësimin si zakonisht. Isha gati t'i puthja ata nxënës, të cilëve megjithëse herë pas here u vinte të qeshnin me vete, i injoruan tërësisht gomarllëqet e tij, edhe kur ai përpiqej t'i shqetësonte.

Sjellja e Ramonit u përkeqësua. Gjatë gjithë kohës ai vazhdonte të më kërkonte të shkonte në banjo, të shkonte te zyra e nëndrejtorit dhe te roja e shkollës. Unë vazhdoja ta injoroja.

Më pas, ndodhi diçka e çuditshme. Në vend që të ikte nga klasa, ai u ul në bangë. Aty nga fundi i mësimit, kur unë po i lija të lirë nxënësit, duke i përmendur secilit emrin, ai erdhi tek unë dhe më tha: "A mund të iki dhe unë, z. Berg?". Ai priti e priti deri sa unë u ndava me të gjithë, më kërkoi të ikte, por s'u largua pa i dhënë unë leje.

Unë pyesja veten se çfarë do të ndodhte të nesërmen. A do të kishim ndonjë ndryshim apo do të më duhej të duroja përsëri sjelljen padurueshme të Ramonit?

Të enjten, Ramoni erdhi në orar, i pajisur me fletore, laps dhe libër. U ul qetësisht në vendin e tij dhe ngriti dorën për të bërë pyetje. Gjatë gjithë kohës ai s'lëvizi nga vendi dhe as foli pa leje. Mezi e mbante vendi, por e kuptoja se sa të vështirë e kishte të rrinte urtë. Ai nuk bëri asnjë nga detyrat që i dhashë, por mendoja se për Ramonin ishte punë e madhe që po kontrollonte veten.

Çfarë mësimi nxora unë? S'është e thënë që ne të bazohemi "gjithnjë tek ato që kemi bërë". Po të kisha vazhduar të njëjtën strategji të vjetër, e cila më kishte dhënë rezultate në të kaluarën, jam e sigurtë që s'do të kishim patur asnjë përmirësim në sjelljen e Ramonit. Unë e di se disa mësues kujtojnë se nxënësit duhet të sillen siç duhet, sepse jemi ne që ua kërkojmë, kur në realitet shumë prej tyre s'veprojnë ashtu. Ne jemi të rritur dhe kemi përgjegjësinë të ndryshojmë punën tonë për të plotësuar kërkesat e të gjithë nxënësve, jo vetëm të atyre që rrinë urtë, që sillen mirë apo që e kuptojnë një koncept sapo ua shpjegojmë atë.

Ramoni më mësoi se unë s'mund të ndryshoj asnjë fëmijë, por për të ndikuar mbi vendimet e tyre, unë mund të ndryshoj kushtet në klasë. Bibliotekari i shkollës më tregoi se mësimi i vërtetë fillon kur një nxënës ka probleme.

24 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

Ne s'mund të kontrollojmë gjithçka dhe sigurisht që s'mund të kontrollojmë asnjë njeri, por kemi njëfarë pushteti në klasë. Ky është pushteti që ne, si profesionistë dhe qenie njerëzore, vendosim ta shfrytëzojmë për t'iu përgjigjur situatave të vështira.

Të kuptuarit e këtij momenti bëri që të ndryshojë e tërë bota e Ramonit.

Tabela e mëposhtme përmbledh disa nga tiparet pozitive të disiplinës në raport me mjedisin ku zbatohet ndëshkimi.²⁸ Cilat janë karakteristikat e metodës që përdori mësuesja për të disiplinuar Ramonin? Cilat janë tipike për klasën tuaj?

Disiplina është:	Ndëshkimi është:
T'i ofrosh fëmijës alternativa pozitive.	I thuhet vetëm se çfarë NUK duhet të bëjë.
Të përgëzosh apo shpërblesh përpjekjet dhe sjelljen e mirë .	Të reagosh ashpër ndaj sjelljes jo të mirë.
Kur fëmijët respektojnë rregullat, pasi ato janë diskutuar dhe pranuar.	Kur nxënësit respektojnë rregullat, sepse i kanë kërcënuar ose marrja me të mirë.
Udhëheqje konstante, e vendosur.	Kontroll, sharje, tallje.
Pozitive, respekton fëmijën.	Negativ dhe shpërfillës ndaj fëmijës.
Jo i dhunshme fizikisht dhe verbalisht.	I dhunshëm dhe agresiv fizikisht dhe verbalisht.
Ka pasoja logjike që lidhen drejt-përsëdrejti me sjelljen jo të mire.	Ka pasoja që nuk kanë lidhje logjike me sjelljen jo të mire.

²⁸ Përshtatur nga "Ndëshkimi fizik drejt alternativave të disiplinës pozitive në Kenia ». Një dokument avokatie (Drafti 2) nga Kapitulli ANPPCAN Kenya, Janar 2005. <http://kenya.ms.dk/articles/advocacy%20document%20ANPPCAN.htm?udskriv+on%5D> [marrë nga interneti mw 9/29/2005].

Disiplina është:	Ndëshkimi është:
Kur fëmijët detyrohen të korrigojnë gabimin që sjellja e tyre i ka shkaktuar një tjetri.	Kur fëmijët ndëshkohen për lëndimin e të tjerëve, në vend që ata të japin prova se si mund t'i korrigojnë gabimet e tyre.
Të kuptojnë aftësitë e tyre individuale, nevojat, pasojat dhe fazat e zhvillimit.	E papërshtatshme për fazën e zhvillimit të fëmijës; rrethanat individuale, aftësitë dhe që s'merr parasysh nevojat e tij.
E mëson fëmijën të vetëdisiplinohet.	I mëson fëmijës të sillet mirë vetëm kur ka rrezik ta kapin në gabim.
Dëgjim dhe mësim përmes shembujve.	Qortim i vazhdueshëm i fëmijëve edhe për shkeljet më të vogla, duke bërë që ata të na injorojnë (të mos ua vënë më veshin fjalëve tona).
Të përdoren gabimet si mundësi për të mësuar.	Detyrohen nxënësit të zbatojnë rregulla jo logjike "vetëm e vetëm sepse juve u keni thënë ashtu".
Drejtohet te sjellja e fëmijës, kurrë te fëmija - sjellja juaj s'ishte e mirë.	Kritikon fëmijën dhe jo sjelljen e tij - ti je budalla, ke bërë gabim.

DISIPLINA POZITIVE NË KLASË

Fëmijët kanë nevojë të mësojnë që të kuptojnë dhe të respektojnë rregullat e shoqërisë. Por s'është e nevojshme dhe mund të jetë mjaft e dëmshme, t'i rrahësh apo të abuzosh me ta. Ekzistojnë prova se vajzat dhe djemtë reagojnë më mirë ndaj metodave pozitive, ndaj diskutimeve dhe sistemeve të shpërblimit sesa ndaj ndëshkimit përmes abuzimit verbal, fizik ose emocional.²⁹

²⁹ *Save the Children*. "Si të studjohet ndëshkimi fizik dhe emocional i fëmijëve". Bangkok: Rajoni i Azisë Juglindore, Lindore dhe i Paqësorit, 2004.

Lexoni skenat në vijim dhe provoni të identifikoni se me ç'mënyra pozitive dhe negative mësuesi e trajton sjelljen jo të mirë të një nxënësi.³⁰

Skena 1

Leku hyn në klasën e saj të vitit të katërt për të filluar lëndën e matematikës. Ndërsa ajo fillon të shpjegojë, nxënësit e saj vazhdojnë bisedat mes tyre dhe s'po e dëgjojnë. Ajo ngre zërin: "Lërimi fjalët, ju lutem! Tani po fillojmë mësimin." Të gjithë pushojnë, përveç Çajit. Çaji vazhdon të flasë me shokun e tij rreth lojës së futbollit, që kishte parë mbrëmë në televizor. Leku i bërtet: "Çaj, përse nuk pushon? Pa dil te qoshja e klasës dhe qëndro me fytyrë nga muri. Ke për ta parë se ç'të pret. Prit sa të mbarojë mësimi!". Duke kaluar nga kjo klasë, mësuesi kujdestar pyet: "Do që t'ia tregoj unë se kush është bosi këtu?". Çaji shkon duke qarë dhe ndalon te qoshja e klasës, i frikësuar për fatin e vet dhe duke mallkuar veten për atë që kishte bërë. Ndoshta ditën e nesërme ai nuk do të duket në shkollë.

Skena 2

Leku hyn në klasën e saj të vitit të katërt gati për të filluar lëndën e matematikës. Kur hyn brenda, ajo thotë: "Ju lutem, pushoni fjalët! Tani po fillojmë lëndën tonë të matematikës dhe të gjithë të dëgjojnë me vëmendje.". Pasi klasa qetësohet, Leku dëgjon Çajin që po flet ende me shokun e tij. Leku pyet: "Kush po flet akoma? Më duket se dikush i ka harruar rregullat e vendosura.". Mësuesi kujdestar i klasës, që kalon andej, dëgjon fjalët e Lekut dhe pyet me zemërim nëse ka ndonjë problem, pasi ai di ta zgjidhë shpejt. Leku e falënderon dhe i thotë se mund ta zgjidhë vetë situatën. Leku vështron në drejtim të Çajit dhe pyet: "S'e kuptova përse mësuesi kujdestar foli ashtu? A keni ndonjë ide?". I zënë si në faj, Çaji përgjigjet: "Po ja, unë vazhdova të flisja, pasi ju i kërkuat klasës të mbajë qetësi.". Leku pyet: "Kur e kemi ne mundësinë të bisedojmë pa i shqetësuar të tjerët gjatë mësimit?" Çaji thotë: "Kur ora e mësimit të ketë mbaruar.". Leku miraton me kokë dhe e pyet Çajin t'i tregojë se sa bëjnë 100 pjesëtim për 2. Ai i përgjigjet 50. Leku

³⁰ Ky seksion është përshtatje e një studimi të kryer në fillim në ndihmë të prindërve të Doescher, S. dhe Burt, L. "Ju, fëmija juaj dhe disiplina pozitive". Universiteti shtetëror i Oregonit, Shërbimi i Zgjeruar, Mars 1995. <http://eesc.orst.edu/agcomwebfile/edmat/ec1452-e.pdf> [marrë në internet më 10/12/2005].

vë buzën në gaz dhe i thotë: "Shumë mirë.". Çaji tregoi kështu më shumë vëmendje dhe nuk foli me shokun derisa mbaroi ora e mësimit.

Skena 3

Leku hyn në klasën e vitit të katërt gati për të filluar mësimin e matematikës. Kur hyn brenda, ajo thotë: "Të gjithë mbani qetësi, ju lutem! Ne po fillojmë orën tonë të matematikës dhe të gjithë duhet të dëgjojnë me vëmendje.". Pasi klasa qetësohet, Leku dëgjon Çajin tek vazhdon të bisedojë me shokun e tij. Leku merr një fletë gabimesh dhe shkruan: "Nuk zbaton rregullat e klasës" dhe më pas i kërkon Çajit të plotësojë në krye të fletës emrin e tij, vitin, mësuesin, orën dhe datën. Leku thotë: "Çaj, unë po e vendos te cepi i bangës tënde këtë shënim për gabimin që ke bërë. Po që aty deri në fund të mësimit, t'i mund ta grisësh. Në rast se ti do të vazhdosh të flasësh pa leje, unë do ta marr e do t'ia çoj mësuesit kujdestar." Në fund të orës, Çaji e hodhi atë letër në kosh.

Kur teknikat disiplinore janë negative, ato mund t'i dekurajojnë dhe mundojnë fëmijët. Kur ato janë pozitive, ato i ndihmojnë nxënësit të sillen mirë.

Në skenat 1 dhe 2 më sipër, mund të dallojmë situata negative mes Lekut dhe Çajit. A mundeni t'i identifikoni?

Përgjigje: Në skenën 1 si Leku dhe mësuesi kujdestar shfaqin zemërim shpërthyes. Ata e kërcënojnë Çajin: "Prit sa të mbarojë mësimi!" dhe "Do që t'ia tregoj unë se kush është bos i këtu?". Leku, gjithashtu, përdor një ndëshkim të palogjikshëm, të pakuptimtë, duke e urdhëruar Çajin të qëndrojë në qoshe me fytyrën e kthyer nga muri. Në skenën 2 Leku e poshtëron Çajin me sarkazëm: "Më duket se dikush i ka harruar rregullat e vendosura.". Ç'mendoni ju, si ndjehet Çaji pas reagimeve të ashpra të Lekës dhe të mësuesit kujdestar?

Skenat 2 dhe 3 përmbajnë edhe shembuj të situatave pozitive mes Lekës dhe Çajit. Në skenën 2, Leku hyn në klasë dhe kërkon që të respektohet një qëndrim i caktuar (të mbahet qetësi), si dhe shpjegon arsyen përse (meqë fillon ora e matematikës dhe të gjithë duhet të dëgjojnë me vëmendje). Ndaj reagimit të mësuesit kujdestar, ajo thotë: "S'e kuptova përse mësuesi kujdestar foli ashtu?". Kjo pyetje e bën Çajin të reflektojë për reagimet e

mësuesit kujdestar dhe përse sjellja e tij e kishte mërzhitur atë, Lekun dhe nxënësit e tjerë. Gjithashtu, Leku miraton me kokë për t'i dhënë të kuptojë Çajit se ka të drejtë lidhur me kohën se kur duhet të flasë me shokët e tij. Ajo, gjithashtu, i jep kurajë atij duke i dhënë një mundësi që t'i përgjigjet drejt një pyetjeje të thjeshtë matematikore, duke e përgëzuar e duke vënë buzën në gaz. Kjo i tregon Çajit se Leku ende ka mendim të mirë për të. Ishte sjellja e tij që kishte shkaktuar shqetësimin, jo ai vetë.

Në skenën 3 Leku tregohet e mirësjellshme, por dhe e vendosur në qëndrimin që mban ndaj sjelljes jo të mirë të Çajit. Kjo i jep Çajit mundësinë që të tregohet i përgjegjshëm për qëndrimin e tij dhe për atë që ndodh më pas.

Shtatë parimet e disiplinës pozitive për fëmijë

1. Respektoni dinjitetin e fëmijës.
2. Zhvilloni qëndrime prosociale, vetëdisiplinimin dhe karakterin.
3. Gjallëroni sa më shumë pjesëmarrjen e fëmijës.
4. Respektoni kërkesat e zhvillimit të fëmijës dhe cilësinë e jetës.
5. Respektoni motivimin e fëmijës dhe botëkuptimin e tij.
6. Garantoni paanësi (barazi dhe mosdiskriminim) dhe drejtësi.
7. Nxitni ndjenjën e solidaritetit.

Burimi: Pauer, Klark F. dhe Hart, Stjuart N. "Rruga drejt një disipline konstruktive për fëmijën" te: Hart, Stuart N (bot.), "Zhdukja e ndëshkimit fizik: Rruga drejt një disipline konstruktive për fëmijën". Paris: Botim i UNESCO-s, 2005.

Hapat e disiplinës pozitive

Ndërsa ndëshkimi është një akt i vetëm, disiplina pozitive është një proces me katër faza, që miraton dhe shpërblen sjelljen e mirë në këtë mënyrë.³¹

1. **Sjellja e mirë përshkruhet me fjalët:** "Të gjithë të mbajnë qetësi tani, ju lutem!".

³¹ Përshtatur nga: "Disiplina pozitive, Metoda dhe përkufizimi" <http://www.brainsarefun.com/Posdis.html> [marrë nga interneti mw 12/2/2005].

2. **Për këtë jepen arsye të qarta:** "Ne po fillojmë orën e lëndës së matematikës dhe të gjithë duhet të dëgjojnë me vëmendje." Kjo do të thotë se mbajtja e qetësisë tregon respekt për të tjerët. Kjo është një mënyrë e mire, sepse të tjerët duhen trajtuar ashtu siç do të donit t'ju trajtojnë edhe ata ju.
2. **Kërkohet miratimi:** "A e kuptoni përse mbajtja e qetësisë është shumë e rëndësishme?". Ose si në rastin e Çajit: "Kur mund të bisedojmë pa i shqetësuar të tjerët gjatë mësimit?"
3. **Inkurajohet sjellja e mirë:** kontakt me sy, një miratim me kokë, një buzëqeshje, një pesë minutësh lojë në fund të ditës, pikë vlerësimi shtesë, përmendja e një suksesi para klasës ose shkollës (vlerësimi para të tjerëve është shpërblimi më i madh). Kur përdoren shpërblimet, ato duhet të jenë gjithnjë të menjëhershme dhe të vogla, gjithsesi, mirënjohëse.

Ky proces bën efekt mbi fëmijë të veçantë. Sidomos në klasa të mëdha, ai mund të bëjë efekt edhe mbi grupe fëmijësh. "Truku" konsiston në nxitjen e fëmijëve për t'u ndjerë pjesë e një "skuadre fituese" (klasës në tërësi), duke lavdëruar përpjekjet e secilit fëmijë si pjesëtar i vlefshëm i skuadrës.

Kujtoni se: Spikatini nxënësit kur bëjnë vepra të mira dhe lavdërojnë menjëherë. Ky është thelbi i disiplinës pozitive.

Shënim: Disiplina pozitive mund të dështojë po qe se:

1. Studenti ose e tërë klasa nuk shpërblehet shpejt.
2. Theksi vihet më shumë te detyrat sesa te sjellja. Për shembull: "Sa mirë që e mbyllët gojën dhe i ndaluat bisedat." nuk është njëllë si: "Sa mirë që menduat dhe për të tjerët dhe e pushuat shpejt zhurmën."
3. Theksi vijon të vihet më shumë mbi atë që bën nxënësi në mënyrë jo korrekte sesa atë korrekte.

Kur përdorim disiplinën pozitive, përpiquni të mbani parasysh një raport 4:1. Vini në dukje për çdo nxënës apo klasë katër veprime korrekte dhe një veprim jo korrekt. Jini këmbëngulës. Duke përdorur raportin katër me një, ju u tregoni nxënësve tuaj se jeni vërtet serioz, duke vërejtur ato çfarë ata

bëjnë mirë, duke i shpërblyer menjëherë.³² Për të mësuar nëse e keni arritur këtë raport, mbani ditar dhe në fund të çdo ore mësimi ose dite, reflektoni se sa herë u keni vënë në dukje nxënësve veprimet e tyre të mira në krahasim me veprimet jo të mira. Ju mund t'i kërkonti një nxënësi apo kujdestarit të klasës t'ju monitorojë derisa vlerësimet tuaja të bëhen rutinë dhe kritikizmi të shfaqet rrallë.

Mësuesit që përdorin disiplinën pozitive besojnë tek aftësitë e nxënësve të tyre dhe u përcjellin atyre dashuri dhe respekt. Kur mësuesit duan të ndjekin ecurinë e nxënësve dhe të reagojnë në atë mënyrë që t'u inkurajojnë sjellje pozitive, ata i ndihmojnë nxënësit të bëhen të përgjegjshëm për sjelljet e tyre dhe nxënësit pakësojnë rastet e sjelljeve jo të mira.



Strategji reflektimi: Të mësuarit dhe zbatimi i leksioneve pozitive

Mësuesve dhe nxënësve u krijohen çdo ditë shumë raste për t'u lidhur pozitivisht me njëri - tjetrin. Pa kujtoni një situatë nga ato të fundit, kur ju dhe nxënësit tuaj keni shkuar mirë; mbase gjatë dhënies së udhëzimeve individuale. Përshkruani përvojën tuaj në vendet bosh më poshtë. Si mund ta përdorni këtë informacion për të punuar më mirë me nxënësit e tjerë dhe të shmangni përdorimin e disiplinës negative?

Çfarë bënë nxënësit e tu?

Çfarë thatë apo si vepruat?

Si u përgjigj fëmija?

³² Po aty.

Si e ndjetë veten?

Si do ta përdornit ju këtë përvojë me fëmijët e tjerë?

SHMANGIA E DILEMËS SË DISIPLINËS

Ky seksion do të flasë për dilemën e disiplinës, që do të thotë mbi vendimmarrjen, nëse duhet kontrolluar sjellja e një nxënësi sepse ashtu doni ju apo duhet përmirësuar sjellja e nxënësit për të mirën e tij. Kjo dilemë bazohet në idenë e gabuar se disiplina dhe ndëshkimi duan të thonë të njëjtën gjë, se veprimet e ndërmarra për secilin nxënësi janë po ato dhe se rezultati do të jetë po ai. Për të shmangur këtë dilemë dhe për të larguar çdo paqartësi, ne kemi mësuar për dallimin mes ndëshkimit dhe disiplinës, natyrën dhe pasojat e ndëshkimit, në dallim nga disiplina pozitive, si dhe për metodën e disiplinës pozitive. Me siguri që ju keni zbuluar shumë gjëra, keni zhvilluar ide të dobishme dhe keni mësuar se si veprimet tona disiplinore ndikojnë në sjelljen e fëmijëve dhe inkurajojnë (ose dëmtojnë) zhvillimin e tyre për mjaft kohë. Më poshtë do të gjeni dhe një ushtrim të fundit për të testuar njohuritë tuaja mbi dallimin mes disiplinës pozitive dhe asaj negative.



Strategji veprimi: Disiplinë pozitive apo negative

Cilat nga veprimet disiplinore në tabelën e mëposhtme janë pozitive dhe cilat negative? Vendosni një shenjë pohimi (") në kolonën përkatëse. Më tej, vendosni një shenjë pohimi në kolonën e fundit për çdo veprim që keni ndërmarre ose mund të përdorni për të korrigjuar sjelljen e fëmijës. Tregohuni të sigurt!

32 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

Veprimi	Pozitiv (✓)	Negativ (✓)	A keni përdorur ndonjëherë këtë veprim? Po / Jo
1. Tërheqja e vëmendjes nxënësve para fillimit të orës së mësimi.			
2. Përdorimi i udhëzimeve të drejt-përdrejta (u thoni atyre saktësisht se ç'do t'u ndodhë).			
3. Bëni hipoteza.			
4. Bëni akuza pa bazë.			
5. Ngrihuni dhe lëvizni nëpër klasë.			
6. Përdorni forcën fizike.			
7. Komandoni.			
8. Veproni në atë mënyrë siç kërkoni dhe nga nxënësit të veprojnë (modelim).			
9. Përgjithësoni sjelljen e një nxënësi.			
10. Krahasoni publikisht një fëmijë me një tjetër.			
11. Pasuroni mjedisin e klasës tuaj.			
12. U paraprini problemeve.			
13. Këmbëngulni se ju jeni më i madh në moshë dhe më superior.			
14. Vendosni rregulla disipline të qarta dhe të qëndrueshme.			

Përgjigje: Veprimet e përmendura të 1, 2, 5, 8, 11, 12 dhe 14 janë pozitive.³³ Veprimet e përmendura të 3, 4, 6, 7, 9, 10 dhe 13 janë negative.³⁴ Sa pikë keni marrë? Sa metoda negative dhe pozitive keni përdorur?

³³ McDaniel, Thomas R. "Një manual elementar mbi disiplinën në klasë: Parime, të vjetra dhe të reja." Phi Delta Kappan, shtator 1986. Ekstrakt që gjendet te <http://www.honorlevel.com/techniques.xml> [marrë në internet më 10/6/2005].

³⁴ Albert, Linda. "Udhëzues për mësuesin mbi Disiplinën Bashkëpunuese". Sërkëll Pajns, Minnesota:AGS, 1989.



Ndërtimi i raporteve pozitive Mësues - nxënës

Çfarë do të mësoni ju:

- Bazat e marrëdhënieve mësues - nxënës.
- Përse fëmijët sillen ashtu siç dine.
- Përse fëmijët sillen jo mire.
- Të mësojmë rreth nxënësve duke u nisur nga vetja e tyre.
- Të kuptojmë jetën e nxënësve.
- Të mësojmë rreth familjeve të nxënësve.
- Komunikimi prindër - mësues.
- Strategjitë e inkurajimit.

BAZAT E MARRËDHËNIEVE MËSUES - NXËNËS

Mësuesit që përdorin disiplinën pozitive i respektojnë, edukojnë dhe i mbështesin nxënësit e tyre. Ata kuptojnë përse një fëmijë sillet mirë ose keq - siç di, dhe se çfarë mendon fëmija për veten, çka mund të jetë dhe burimi i sjelljes së keqe. Ata, gjithashtu, e vënë theksin tek aftësitë e fëmijës dhe te situata e tij familjare. Kërkesat që një mësues ka për fëmijën janë realiste, e marrin fëmijën në konsideratë ashtu siç është, jo ashtu siç duhet të ishte. Mësuesi e kupton se sjellja jo e mirë përbën një ngjarje, nga ku nxirren mësim konstruktive si për fëmijën, ashtu dhe për mësuesin e tij dhe se ajo është pjesë e natyrshme, e rëndësishme e zhvillimit të tij dhe jo një kërcënim ndaj autoritetit të mësuesit.

Duke ndërtuar një marrëdhënie të tillë pozitive mbi bazën e të kuptuarit dhe mirëkuptimit, nxënësit fillojnë të kenë besim te mësuesit dhe të vlerësojnë qëndrimet e tyre. Kur nxënësi reagon ndaj natyrës pozitive të marrëdhënieve dhe disiplinës konstante, rastet e sjelljeve jo të mira pakësohen dhe përmirësohet më tej cilësia e marrëdhënieve. Për arritjen e një objektivi të tillë, modele të një roli të mirë janë mësuesit më të mirë, të cilët nxënësit përpiqen t'i imitojnë dhe të shkojnë mirë me ta.

PËRSE FËMIJËT SILLEN ASHTU SIÇ DINË

Zgjedhja

Zonjusha Samina, një mësuese e shkencave e vitit të katërt, kishte gjithmonë telashe me Harin. Ata shkonin gjithmonë keq me njëri - tjetrin. Çfarëdo që t'i kërkonte Samina Harit - si ardhjen në kohë në mësim, bërjen e detyrave - ai do të bënte të kundërtën. Ajo që Samina s'kuptonte, por që më në fund e kuptoi një mësuese tjetër, ishte se Samina ia kërkonte çdo gjë Harit në formën e një pyetjeje, p. sh.: "Hari, a ka mundësi, të lutem, të vish në klasë në orar?". Dhe ai i thoshte gjithmonë "Jo!".

Askush dhe asnjë rrethanë s'mund ta detyrojë fëmijën të sillet në një mënyrë të caktuar. Sipas zonjushës Samina, ajo e ftonte Harin të sillej mirë, por ai e refuzonte gjithnjë këtë ftesë. Përse? Sjellja bazohet në zgjedhje dhe nxënësit tuaj e zgjedhin vetë qëndrimin që duan të mbajnë. Ju nuk mund t'i detyroni ata. Ja pse ndëshkimi nuk ka efekt afatgjatë. Megjithatë, siç e kuptoi dhe mësuesi i Ramonit në seksionin e mëparshëm, ju keni fuqi të ndikoni mbi vendimet që merr nxënësi për sjelljen e tij, por ndryshimi duhet të fillojë nga ju, mësuesi. Në rastin e mësueses së Ramonit, asaj iu desh të mësonte të ndërvepronte me Ramonin - dhe nxënësit e saj të tjerë - në mënyrë që ai të zgjidhte një sjellje tjetër, që t'u përshtatej rregullave në klasë. Edhe ju keni përpara të njëjtën sfidë. Roli juaj është të identifikoni arsyen e këtyre zgjedhjeve jo të mira, të zhvilloni strategji se si ta ndihmoni nxënësin që të bëjë zgjedhje më të mira për sjelljen e tij.

Siç mësuam në seksionin e parë të këtij dokumenti, fëmijët mësojnë - dhe sillen - të ndikuar nga faktorët e trashëgimisë, mjedisi ku jetojnë dhe nevojat e tyre personale dhe psikologjike. Ne s'mund t'ua ndryshojmë trashëgiminë dhe mund të kemi kontroll të kufizuar mbi mjedisin e tyre, sidomos po qe se nuk dimë të punojmë mirë ose nuk punojmë aspak me prindërit dhe udhëheqësit e komunitetit. Por edhe duke e ditur se secili nga nxënësit tuaj i merr vetë vendimet për sjelljen e vet, ju jeni të pajisur me avantazhin strategjik të ndikimit mbi ta. Mos harroni se: Sjellja është e kuptueshme dhe e qëllimshme. Nxënësit bëjnë ato që bëjnë për një qëllim, sadopak të vetëdijshëm qofshin ata për këtë. Kur ju të filloni të shihni botën - ose thjesht klasën tuaj - përmes syve të tyre, ju mund t'u përgjigjeni atyre me arsye, konfidencë dhe efektivitet.



Strategji veprimi: I njëjti nxënës, tjetër sjellje

Përzgjidhni një nxënës në klasën tuaj, sjellja e të cilit ju shqetëson ose ju zhgënjën. Vëzhgojeni atë rregullisht për një javë, veçanërisht jashtë klasës. A sillet ai njëllëj edhe në orët e tjera apo dhe me nxënës të tjerë, ashtu siç bën në orën tuaj? Në qoftë se ai sillet në shkollë krejt ndryshe në situata të ndryshme, përse mendoni se ka vendosur të sillet ashtu siç sillet në orën tuaj? Këshillohuni me mësues që nuk kanë probleme me sjelljen e tij. Ç'bëjnë ata ndryshe nga ju? Mos i parashtroni gjë kërkesat tuaja në formë pyetjesh (si zonjusha Samina më sipër)? Mos e keni ndëshkuar, prandaj dhe nuk do të vijë në mësim? Mos mësuesit e tjerë i ofrojnë alternativa të tjera dhe e lënë të merret vetë me pasojat? Si mund të punoni që ta ndihmoni në mënyrë pozitive të bëhet më i përgjegjshëm për sjelljen e tij?

Në qoftë se ne besojmë se çdo nxënës vendos vetë për qëndrimet e tija, edhe ne duhet të aplikojmë po këtë metodë për reagimet tona në klasë dhe për të gjitha veprimet që kryejmë me nxënësit. Ne duhet t'i bëjmë pyetje vetes për zgjedhjet që bëjmë për veprimet tona, përse bëjmë zgjedhje të tilla, dhe të tregojmë më pas më shumë kujdes se si shprehemi si me zë, ashtu dhe me gjeste.

Nevoja e përkatësisë

Objektivi kryesor i sjelljes së nxënësit është të plotësojë nevojën e përkatësisë.³⁵ Kjo dëshirë përkatësie është një nevojë themelore, të cilën e kanë si fëmijët edhe të rriturit. Secili prej nesh përpiqet pafund të gjejë dhe të ruajë një pozicion të rëndësishëm, një vend të cilit t'i përkasë. Gjatë kërkimit tonë, ne zgjedhim besime, ndjenja dhe qëndrime, nëpërmjet të cilave mendojmë se fitojmë rëndësi. Shumica e nxënësve kalojnë orë të tëra gjatë ditës në shkollë, kështu që aftësia e tyre për të gjetur vendin e vet në grupin e klasës dhe atë të shkollës, ka rëndësi të madhe. Përveç kësaj, çfarëdo metode që të zgjedhë nxënësi për të arritur objektivin e përkatësisë - qoftë me sjellje të mirë apo të keqe - kjo metodë përzgjidhet që herët në jetë dhe bëhet mënyrë jetese, karakteristike për atë person. Ja

³⁵ Metodatat demokratike në drejtimin e orës së mësimin. <http://www.educ.sfu.ca/courses/educ326/chapter3.htm> [marrë në internet më 10/6/2005].

36 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

pse ju jeni një aktor i rëndësishëm për ta ndihmuar çdo fëmijë të zgjedhë një metodë që të jetë shoqërisht e pranueshme. Ajo do t'i shërbejë gjatë gjithë jetës!

Nxënësit kanë nevojë të plotësojnë këto kërkesa, në mënyrë që të provojnë ndjenjën e përkatësisë.³⁶

- Ata kanë nevojë ta ndjejnë veten të Aftë për të përmbushur detyra në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e klasës dhe të shkollës.
- Ata kanë nevojë të ndjejnë se mund të Komunikojnë me sukses me mësuesit dhe shokët e klasës.
- Ata kanë nevojë të kuptojnë se Kontributi i tyre në grup është i rëndësishëm.

Këta tre faktorë që ndikojnë në aftësitë e nxënësve për të plotësuar këto kërkesa e që kanë nevojë për veprimin tuaj janë:

1. cilësia e marrëdhënieve mësues - nxënës, të bazuara në mirëbesim, respektin reciprok dhe arsyen (jo frikën);
2. klima që nxit frymën e suksesit në klasë (p.sh., të gjithë fëmijët e shohin se janë të përfshirë dhe se kontributi i tyre vlerësohet, se mund të punojnë në grup me efektivitet);³⁷
3. një strukturë e përshtatshme në klasë (mënyrën se si është ndërtuar ajo do ta gjeni në seksionin që vijon të këtij dokumenti).

Duke gjetur rrugët për t'i plotësuar këto tri kërkesa së bashku me këta tre faktorë, ju mund të plotësoni nevojën e nxënësve për të gjetur pozicionin e tyre në grup dhe për të shmangur, kështu, sjelljen jo të mirë që mund të shkaktohet gjatë përpjekjeve të tyre për të plotësuar një nevojë të tillë.

³⁶ Albert, Linda dhe Desisto, Pete. "Disiplina bashkëpunuese". Shërbimi Amerikan mbi Drejtimin, 1996.

³⁷ Shumë teknika për përmirësimin e klimës në klasën tuaj janë të përfshira te "Të pranojmë diversitetin», një manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës e mësimdashës, Bangkok: UNESCO, 2004. http://www2.unescobkk.org/ips/ebooks/documents/Embracing_Diversity/index.htm.

PËRSE FËMIJËT SILLEN JO MIRË

Mos u mërzitni. Nuk është se nxënësit tuaj sillen keq me qëllim. Në fakt, kur sillen keq, fëmijët e kanë një arsye. Disa nga arsyet më të zakonshme, që besojmë se kontribuojnë në sjelljen jo të mirë, janë:

- Ngarkesa për nxënësin mund të jetë shumë e lehtë ose shumë e rëndë.
- Mësimi nuk është interesant dhe nxënësi mërzitet.
- Metodatat e mësimdhënies mund të mos i përshtaten stilit të të mësuarit të nxënësit.
- Nxënësi mund të mos jetë i përgatitur.
- Kërkesat janë të paqarta ose të palogjikshme.
- Nxënësi ka aftësi të varfëra sociale, s'komunikon kollaj me ju apo me të tjerët, ose ka një vlerësim të ulët për veten.

Të gjitha këto arsye mund të bëjnë që nxënësi të dekurajohet; nxënësit që sillen keq, janë nxënës të dekurajuar. Ata nuk besojnë se mund të jenë, në një mënyrë apo në një tjetër, të vlefshëm. Prandaj, ata kërkojnë të gjejnë vendin e tyre nëpërmjet sjelljes së keqe.

Përveç arsyeve të sipërpërmendura, besohet se fëmijët sillen jo mirë edhe për të arritur katër qëllime, dhe konkretisht:

1. Vëmendje.
2. Pushtet.
3. Hakmarrje.
4. Shmangie të dështimit ose papërshtatmërisë.³⁸

Mendoni për një nxënës tjetër, sjellja e të cilit ju shqetëson ose ju zhgënjën. Për të gjetur arsyen e kësaj sjelljeje, pyesni veten se si ndjeheni kur ai nxënës sillet jo mirë. Për shembull, në qoftë se ndjeni bezdi kur nxënësi nuk ju bindet, ai mbase kërkon të tërheqë vëmendjen (si Ramoni). A zemëroheni? Pushteti është synimi më i lartë për një fëmijë. A ndjeheni i lënduar nga sjellja e nxënësit? Atëherë objektivi i nxënësit ka qenë hakmarrja. I zhgënjyer deri në atë pikë sa që kërkon të hiqni dorë nga puna

³⁸ Dreikurs, Rudolf. "Fëmijët: Sfida". Nju Jork, NY: Duell, Sloan, dhe Pearce, 1964. Dreikurs, Rudolf dhe Soltz, Viki. Fëmijët: Sfida. Toronto: Makleland & Stjuart, 1987. Albert, Linda dhe Desisto, Pete. "Disiplina bashkëpunuese". Shërbimi Amerikan i Drejtimit, 1996.

e mësuesit? Atëherë nxënësi beson se ju jeni i papërshtatshëm dhe sillet keq për të konfirmuar idenë e tij. Le të shohim më nga afër secilin nga këto synime dhe se çfarë mund të bëhet për to.³⁹

Në kërkim të vëmendjes

Çdo fëmijë i shëndetshëm kërkon vëmendje dhe shpesh sjellja e tij jo e mirë vjen ngaqë ai ka nevojë për vëmendje. Një objektiv i rëndësishëm i mësuesit është të tregojë vëmendje, për të cilën nxënësit kanë nevojë që të zhvillojnë vetëvlerësimin e shëndetshëm. Megjithatë, disa nxënës zgjedhin të sillen jo mirë, pasi kërkojnë që të tjerët t'u përkushtohen më shumë. Ata duan të jenë në qendër të vëmendjes, duke ju larguar ju dhe nxënësit e tjerë nga mësimi, për t'ju tërhequr të gjithëve vëmendjen. Ata kanë nevojë të konfirmojnë në njëfarë mënyre ekzistencën dhe rëndësinë e tyre. "Hej! Pa më shikoni mua! Unë jam këtu, unë jam më i rëndësishmi!" Në qoftë se fëmijët nuk arrijnë të tërheqin vëmendjen përmes arritjeve dhe bashkëpunimit, ata do të përpiqen ta fitojnë atë si të munden. Ata mund të ndërpresin orën e mësimit, por e dinë se do të tërheqin vëmendjen, për të cilën ëndërrojnë aq shumë.

Moskushtimi i vëmendjes në situata të tilla, siç qe rasti i Ramonit, zakonisht e pushon sjelljen jo të mirë. Megjithatë, kur mësuesi përpiqet vazhdimisht të edukojë një fëmijë që kërkon vëmendje, injorimi mund të mos mjaftojë. Në fakt, injorimi mund të jetë shkaku kryesor i problemit.

Për nxënësit që kërkojnë vëmendje të tepërt, ju mund të shtyheni t'i qortoni, t'i merrni me të mirë apo të përdorni teknika të tjera të disiplinës negative. Por në rast se ju nuk harroni se qëllimi i nxënësit është t'ju tërheqë vëmendjen, s'është e vështirë të kuptoni se qortimi apo marrja me të mirë vetëm sa e nxit sjelljen jo të mirë. Sipas mendjes së një fëmije, vëmendja nga një mësues i inatosur është më e mirë se fare pa gjë. Mjafton që t'ju bjerë në sy sjellja jo e mirë e një nxënësi dhe ai do të sillet keq, që të jetë në qendër të vëmendjes.

³⁹ Katër seksionet e mëposhtme mbi vëmendjen, pushtetin, hakmarrjen, dhe dështimin janë përshtatur nga: Trajtimi i sjelljes. <http://www.kidsgrowth.com/resources/articledetail.cfm?id=119> [marrë nga interneti më 10/12/2005]

Më poshtë jepet një listë veprimesh të disiplinës pozitive, që ju mund t'i shfrytëzoni për të udhëhequr nxënësit, sjellja e të cilëve kërkon vëmendje më të madhe.

- Tregoni interes kur ata sillen mirë, lëvdoini kur nuk e kërkojnë dhe nuk sillen keq.
- Injorojeni sjelljen jo të mirë sa më shumë të jetë e mundur, duke treguar kujdes gjatë çasteve të këndshme.
- Mësojini ta kërkojnë vëmendjen (për shembull, bëni letra "më shikoni mua, ju lutem", që ata t'i ngrenë sytë sa herë që kanë ndonjë pyetje).
- Jepuni një shikim indiferent, por mos u flisni.
- Qëndrojeni më shumë afër sesa larg (ata nuk kanë nevojë të sillen keq kur ju ndodheni pranë tyre).
- Drejtojuni me emër nxënësit që duhet të ndalojë apo të bëjë një veprim, identifikoni se çfarë s'duhet bërë, thuajini nxënësit se çfarë duhet të bëjë në atë çast, lëreni të marrë vetë vendim për hapin që do të hedhë dhe pasojat që do të rrjedhin prej tij; si shembull lexoni për këtë skenën e tretë të kapitullit të mëparshëm, mes Lekut dhe Çajit.
- Bëni gjëra të befasishme, si fikni dritën, luani një pjesë muzikore, ulni zërin, ndryshoni zërin, flisni nga muri.
- Tërhiqjani vëmendjen nxënësit, duke i bërë një pyetje të drejtpërdrejtë, duke i kërkuar një favor, duke i ofruar alternativa, duke ndryshuar aktivitetin.

Parimi i përgjithshëm për të reaguar ndaj nxënësve që kërkojnë vëmendje është:

Kurrë mos u kushtoni vëmendje kur e kërkojnë, edhe në raste sjelljeje të mirë. Ndhijmohuni nxënësit të motivohen vetë. Kushtojuni vëmendje kur ata nuk e presin. Kapini në çstat kur tregohen "të mirë".

Pushteti

Nxënësit kërkojnë vazhdimisht të mësojnë se sa pushtet kanë; Ramoni është një shembull i mirë. Disave u duket se janë pjesë e rëndësishme e klasës vetëm kur bëjnë numra. Nxënësve që kërkojnë pushtet u duket se janë të rëndësishëm vetëm kur ata sfidojnë autoritetin, kur kundërshtojnë rregullat dhe nuk u binden udhëzimeve. Ata besojnë gabimisht se i përkasin klasës vetëm kur dikush i kontrollon. Të gjithë ju sfidojnë, për të parë se deri ku mund të arrijnë ose do të bëjnë çmos t'ju zbusin, ngaqë e shohin se ju s'doni të vazhdoni më të ndesheni me ta.

Reagimi ynë i natyrshëm gjatë ndeshjeve për pushtet është të ndjerët të provokuar dhe të inatosur. Prirja është që t'i ndalojmë këto përplasje, duke përdorur ndëshkimin fizik, por kjo s'është gjë tjetër veçse një armëpushim i shkurtër. Gjatë ndeshjeve për pushtet ju duhet të mbani një qëndrim të ngrohtë, por të vendosur. Bisedat s'ofrojnë ndonjë gjë të mirë, ato vetëm e ushqejnë luftën për pushtet. Ju duhet të vendosni se ç'duhet të bëni vetë dhe jo se sa punë do t'ju duhet. Rregulli i përgjithshëm për t'u marrë me nxënësit që kërkojnë të fitojnë pushtet është të tërhiqeni nga konflikti. Mos harroni, për çdo sherr kërkohen dy vetë! Tregohuni i qetë, ofroni alternativa dhe prisni të shikoni se ç'pasoja do të rrjedhin nga sjellja e nxënësit. Ju mund edhe të siguron bashkëpunimin e tyre, duke u kërkuar ndihmë. Për shembull: "Në rregull, ju s'doni të vini në mësim në orar. Ju kuptoj. Por a mundeni, ju lutem, të më ndihmoni të marrim mungesat kur nxënësit vijnë në klasë?". Në vend që ai të kërkojë pushtet mbi ju, ju i jepni nxënësit një pozicion përgjegjësie dhe një pushtet të legjitimuar.

Hakmarrja

Të merresh me një synim të gabuar siç është hakmarrja, kjo kërkon durim. Një nxënës që lëndon të tjerët dhe juve, e ndjen se të tjerët janë lënduar (realisht ose mendon se është kështu) dhe se ata kanë për të marrë hak. Të tjerët ndjehen të keqtrajtuar, të mundur dhe të dëshpëruar, kështu që me dashje ose pa dashje kërkojnë të marrin hak. Hakmarrja mund të merret fizikisht ose në mënyrë pasive nëpërmjet mosveprimit. Ajo mund të jetë krejt e heshtur, siç janë vështrimet dhe gjestet plot urrejtje. Nxënësi mund të marrë hak ndaj jush jo drejtpërsëdrejti, por duke pickuar nxënësit e tjerë ose duke shkruar në tabelë.

Kur një nxënësi i jepet mundësia të marrë hak, nëpërmjet lëndimit dhe të lënduarit mes njerëzve lind një cikël. Mos harroni se nxënësi që kërkon të hakmerret është i dëshpëruar dhe tejet i dekurajuar. Për ta shkatërruar këtë model hakmarrjeje, ju duhet të mos e lëndoni dhe s'duhet të merrni kurrë hak. Mos kërkonit të hakmerreni vetë. Përkundrazi, përpiquni të ndërtoni një raport të ngrohtë mirëbesimi me nxënësin, duke nxitur ndjenjën e vetëvlerësimit. Kjo mund të arrihet lehtë, duke e vendosur nxënësin në situata ku ai të mos ndihet keq. Kur një nxënës ka mendim të mirë për veten, ai rrallëherë përpiqet të marrë hak. Gjithashtu, mësojeni nxënësin - dhe të gjithë nxënësit tuaj - se si t'i shprehin sa më mirë ndjenjat e tyre. Në vend që të marrin hak duke lënduar njëri - tjetrin fizikisht dhe emocionalisht, mësojini ata ta "shprehin atë që ndjejnë", t'i thonë njëri - tjetrit se sa të lënduar janë dhe të përpiqen të gjejnë shkakun dhe mënyrën se si ta shmangin atë në të ardhmen.

Evitimi i dështimit apo paaftësia

Disa nxënës kanë frikë nga dështimi ose e ndjejnë se janë të paaftë dhe se nuk do të plotësojnë shpresat e tyre, të prindërve dhe të mësuesve. Kjo ndjenjë paaftësie është një strehë për fëmijën e dekurajuar. Me fjalë të tjera, ngaqë ata ndjehen keq, veprojnë keq. Ata s'do të përpiqen të veprojnë mirë në klasë, në rast se kujtojnë se janë budallenj. Është shumë më e lehtë të dorëzohesh sesa të përpiqesh dhe të dështosh përsëri. Për t'i kompensuar ndjenjat e tyre për paaftësinë, ata mund të zgjedhin qëndrime të tërhequra, të cilat japin përshtypjen e paaftësisë së tyre. "Unë s'di t'i bëj këto detyra të matematikës.", "Nuk e marr vesh shkencën.", "Ky libër është shumë i vështirë për mua.". Taktikat e disiplinës negative, si vënia në tallje dhe sarkazma ("Nuk je i zoti ta bësh më mirë!"), i bëjnë këta fëmijë ta ndjejnë veten edhe më të padobishëm. Nga ana tjetër, nxënësit, të cilëve u duket se nuk janë të aftë, se s'gëzojnë respekt apo janë mizorë, mund të mburren, krekosen apo të zihen. Ata mund të shndërrohen në të fortë, që përpiqen t'u fusin nxënësve të tjerë ndjenjën e frikës dhe të paaftësisë.

Kur nxënësit tuaj e ndjejnë veten të paaftë, juve ju del përpara një detyrë e vështirë. Nisuni nga gjendja ku ndodhen (jo nga pozita ku duhej të ishin), zhvillonit kërkesa realiste, ndaloni çdo kritikë ndaj punës së tyre, inkurajoni edhe përpjekjen më të vogël dhe, mbi të gjitha, mos shprehni mëshirë për ta. Ju duhet t'u rivendosni atyre besimin në vetvete dhe t'i inkurajoni, duke u lëvdur qoftë edhe suksesin më të vogël që arrijnë. Krijoni

me qëllim situata ku ata të arrijnë suksese, përmes detyrave të lehta dhe shfrytëzoni rastet për t'i përgëzuar për sjelljen e mirë dhe përpjekjet pozitive. Mos harroni, fëmijët nuk janë të rritur në miniaturë me gjykime të këqia, ata gabojnë sepse janë gjithmonë duke mësuar.

SI TË INFORMOHENI RRETH NXËNËSVE TUAJ

Ndërtimi i një raporti të ngrohtë e mirëbesimi mes jush dhe nxënësve tuaj, i tillë që të nxisë sjelljen e mirë dhe të parandalojë veprimet e këqija, është një sfidë, por ai mund të ketë dhe shpërblimet e veta, duke e bërë të këndshme orën e mësimit dhe duke përmirësuar rezultatet e nxënësve tuaj. Arritjet e tyre reflektojnë punën tuaj dhe se sa ata ju ndjekin si "model".

Qoftë kur keni një numër të madh nxënësish, qoftë kur numri i tyre është i kontrollueshëm në klasë, sfida juaj mbetet t'i jepni çdo nxënësi sa më shumë dije. Për ju që punoni me klasa të mëdha, përpjekjet duhet t'i përqëndroni në atë grup nxënësish që kërkojnë kujdes të veçantë, që sillen jo mirë për momentin ose sepse ju dyshoni se situata e tyre personale ose familjare i shtyn të sillen keq. Përqëndroni përpjekjet tuaja për të kuptuar se ç'mendim kanë ata për veten dhe se cilët janë faktorët e jashtëm - mbase në familje - që ndikojnë për keq në sjelljen e tyre.

Mos harroni: Çdo nxënës është individ më vete. Çdo nxënës mban me vete një histori të ndryshme, një mënyrë të ndryshme reagimi dhe të mësuarit të botës, secili ka një ëndërr të vetën për të ardhmen. Duke gjetur kohë për të mësuar rreth nxënësve si individë dhe duke i njohur familjet e tyre, ju dëshmoni se tregoni kujdes për ta dhe se respektoni veçantinë e secilit.

Në një mjedis të respektueshëm, të gjithë nxënësit e ndjejnë veten të sigurtë dhe të vlerësuar. Mësuesi mban një raport miqësor dhe të hapur me nxënësit, por mësuesi mbetet gjithmonë një person i rritur. Kushtimi i vëmendjes serioze ndaj punës së secilit nxënës flet për kujdesin dhe respektin që tregoni. Në vend që t'u thoni vetëm "punë e bukur", përpiquini t'ju shpjegoni përse është e tillë.

Çdo mësues ka nevojë të mësojë interesat dhe ëndërrat e çdo nxënësi, si dhe të marrë vesh se çfarë dinë dhe janë në gjendje të bëjnë ata. Është më rëndësi që ju të organizoni aktivitete për t'i njohur nxënësit tuaj. Këtu po

japim tre aktivitete që mësuesit i kanë përdorur me sukses.⁴⁰ Mos dini ju ndonjë tjetër?



Strategji veprimi: Kush jam unë?

Në fillim të vitit shkollor, jepuni nxënësve të plotësojnë një kartelë të ngjashme me atë që jepet më poshtë? Shfrytëzoheni këtë informacion për të biseduar me nxënësit, për të hartuar planet tuaja mësimore dhe për të programuar aktivitetet mësimore. Në fund të simestrit të parë, kërkojuni nxënësve ta mbushin përsëri atë kartelë dhe shikoni për ndonjë ndryshim, sidomos lidhur me atë se në çfarë beson çdo nxënës se është i zoti të bëjë ose jo, si dhe kur e ndjejnë veten të lumtur apo të mërzhitur në klasë. Duke e shfrytëzuar këtë informacion, në çfarë aktiviteteve të reja mësimore mund të marrin pjesë nxënësit tuaj për të fituar besimin dhe për ta shndërruar klasën në një vend të këndshëm për të mësuar?

Në qoftë se ju jeni mësues që i ndiqni fëmijët për disa vite, mbajini kartelat në një dosje dhe rishikojini për ndryshime. Rishikoni rregullisht planet tuaja mësimore dhe ato të aktiviteteve. Nëse punoni në një shkollë me mësues që japin lëndë të ndryshme, shkëmbejeni informacionin tuaj me ta dhe inkurajojini t'i përdorin ato gjatë përgatitjes së mësimëve.

Emri nxënësit _____

Dua të më telefononi në _____

Gjëja që ju duhet të dini për mua është _____

Unë do të doja të punoja me _____

Unë jam shumë i aftë në _____

Unë nuk jam i aftë në _____

Unë jam i lumtur në klasë kur _____

Unë ndjehem keq në klasë kur _____

⁴⁰ Drejtimi i orës së mësimit. Raporti me nxënësit dhe njohja e tyre. http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/cm-know.html [marrë në internet më 10/20/2005].



Strategji veprimi: Ndarja e kohës

Caktoni çdo ditë një 10 apo 15 minutësh, ose të paktën një herë në javë, që nxënësit tuaj t'i tregojnë njëri - tjetrit, në grupe të vogla, ndjenjat e tyre, gjërat pozitive dhe ato negative që u kanë ndodhur në jetë. Një grup mund të zgjedhë të ndajë me mësuesin dhe klasën atë informacion që e mendon të rëndësishëm.

Aktivitete të tilla të ngjashme mund të përmbajnë leximin në klasë të pjesëve të caktuara të ditareve sekrete të nxënësve. Kur u mësoni se si të shkruajnë ese, kërkojuni të shkruajnë mbi diçka që u ka ndodhur në jetë, e mirë apo e ligë qoftë.

Për nxënës që përjetojnë rrethana mjaft të vështira, përpiquni të shfrytëzoni disa nga strategjitë inkurajuese për të cilat flitet në fund të këtij kapitulli. Lëvdojini ata sa herë që ju jepet mundësia dhe me vend. Pyetini nëse kanë diçka të veçantë që duan të bëjnë apo të mësojnë.



Strategji veprimi: Plotësoni vendet bosh

Përpiloni një formular apo një fletë - pune me vija si:

"Pas shkollës unë kryesisht _____

Ushqimi im i preferuar është _____

Aktiviteti im më i preferuar është _____

Lënda ime më e preferuar në shkollë është _____

Unë dua të jem si _____

Unë dua të bëhem _____ kur të mbaroj shkollën."

Në klasa ka shumë nxënës; ju mund ta shfrytëzoni këtë aktivitet në fillim të vitit shkollor si një mundësi për fëmijët që ata të njihen me njëri - tjetrin, sidomos në ato klasa ku fëmijët kanë të kaluar dhe aftësi të ndryshme. Në

fletën e letrës me këtë informacion, shtoni një kolonë në anën e djathtë, por lereni bosh. Pasi fëmijët t'i kenë plotësuar vendet bosh, kërkoni të gjejnë nxënës me të njëjtat përgjigje për secilin deklaram dhe të shënojnë emrin e studentit në kolonë.

SI TË KUPTONI KONTEKSTIN E JETËS QË BËJNË NXËNËSIT TUAJ

Kur ju, përmes katër synimeve të përmendura më sipër, ta kuptoni përse nxënësit tuaj sillen keq, mund të përzgjidhni më lehtë mjetin e disiplinës pozitive, për të pakësuar shanset që ata të sillen keq ose për t'i parandaluar krejtësisht ato. Por katër synimet e diskutuara më sipër përqëndrohen vetëm në atë fëmijë i cili përpiqet të plotësojë nevojat e tij emocionale e psikologjike. Ajo që mungon ende është të kuptuarit e kontekstit nga i cili vjen çdo fëmijë.

Ne nuk jemi të vetmit që ndikojmë në sjelljen e fëmijës. Çdo fëmijë është produkt i mjedisit total nga i cili ai mëson. Ky mjedis nuk përfshin vetëm klasën dhe shkollën, në të përfshihen edhe vetë fëmija, familja e tij, si dhe komuniteti ku ai jeton. Për shembull, sa herë keni dëgjuar të thonë: "Ai vepron si i ati." ose "Ai vepron si vëllai i tij i madh."? Të kuptuarit e këtij mjedisi më të gjerë, ndoshta, do të jetë një sfidë e re për shumë prej jush, veçanërisht për ata që punojnë zakonisht vetëm brenda mureve të klasës dhe të shkollës.

Mënyra se si sillet në klasën tuaj një nxënës, mund të reflektojë zhgënjimin e tij ndaj familjes apo jetës së vet, ose ndaj rrethanave të vështira të tjera me të cilat ai përballë si brenda dhe jashtë shkollës. Ajo që ne mund të na duket si sjellje jo e mirë, mbase nuk është aspak një problem discipline. Për shembull, një fëmijë mund të jetë duke kërkuar më shumë kujdes nga ju, sepse ai nuk e ka atë në shtëpi. Ky mund të jetë një reagim i fëmijës ose zhgënjim ndaj problemeve në familje, ose gjatë, të cilat ai i mbart në klasë.

Kështu që problemi nuk qëndron te sjellja e fëmijës, problem është situata në të cilën fëmija ka ngecur. Ky zhgënjim, i rënduar nga shkaqet e tij, mund të na ndihmojë të shpjegojmë ndryshimet e papritura në sjelljen e nxënësve, të cilët zakonisht sillen mirë. Sido që të jetë puna, në rast se ne e disiplinujmë fëmijën për sjelljen e tij jo të mirë, bëjmë një "gabim". Ne mund të jemi duke i rënë kot në qafë atij fëmije për diçka që s'është faji i tij,

duke e çoroditur më keq atë. Në një rast të tillë, ndëshkimi s'ka për të funksionuar dhe ai mund ta dëmtojë rëndë zhvillimin e sjelljes te fëmija.

Për ta edukuar sjelljen e fëmijës në mënyrë pozitive, neve na duhet të kuptojmë mjedisin e tij të plotë nga i cili ai mëson, si dhe faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen e tij në nivel personal, familjar dhe komunitar. Kur një fëmijë nuk sillet mirë, ne na duhet t'i mbajmë parasysh këta faktorë të lidhur ngushtë me katër synimet e përmendura më sipër. Ne duhet të pyesim veten nëse ai ka vështirësi në klasë apo është diçka jashtë klasës dhe shkollës që e shkakton problemin. Së fundi, zgjidhja e problemeve të tilla nuk varet vetëm nga ne. Neve na duhet të organizojmë lidhje të ngushta me prindërit, udhëheqësit komunitarë dhe organizatat vendore për të identifikuar dhe zgjidhur çdo situatë të vështirë me të cilën fëmija përballet e që reflektohet në sjelljen e tij.

Më poshtë do të gjeni një listë me faktorë që mund të ndikojnë ose jo mbi dëshirën e nxënësit tuaj për të ndjekur mësimet e për të patur rezultate të mira, dhe nëse ai mund të sillet mirë ose keq. Po aty do të gjeni disa veprime që mund të ndërmerren për të provuar dhe kapërcyer këta faktorë, veçanërisht veprime që kërkojnë pjesëmarrjen e familjeve dhe komuniteteve.⁴¹ Kjo listë nuk është shteruese. Flisni me kolegët tuaj edhe për faktorë të tjerë në lokalitetin tuaj që mund të ndikojnë në sjelljen e nxënësve tuaj dhe mbi masat që duhen marrë për t'i zgjidhur ato sa herë që lindin.

Fëmija

Nevoja për punë. Fëmijët që mendojnë se duhet të rrinë pranë familjes ose gjetkë, për ta ndihmuar të sigurojë mjetet e jetesës, mund të mos duan të vijnë në klasë dhe sillen keq, si mënyrë për t'u larguar. Interesi i tyre është t'u ofrojnë familjeve të tyre mbështetje të shpejtë dhe jo të bëjnë kujdes për shkollimin e vet, si një mënyrë afatgjatë e zgjidhjes së të ardhmes ekonomike të familjeve të tyre. Atyre iu duhet treguar se si qëndrimi i tyre i mirë ndaj mësimi mund të përminësojë perspektivën e tyre të punës. Atyre mund t'u jepet mundësia të fitojnë para dhe të mësojnë, p.sh., përmes programeve trajnuese në shkollë të aftësive për të mbijetuar, ku produktet

⁴¹ UNESCO. "Broshura 3: Thithja e gjithë nxënësve në shkollë dhe mësim", « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, mësimdashës ». Bangkok, 2004.

që ata mund të krijojnë të mund të shiten dhe fitimet t'i shkojnë fëmijës. Një strategji tjetër e mirë është të ftohen prindërit ose anëtarë të respektuar të komunitetit me njohuri ose shprehi të veçanta, të cilët mund të japin ndihmesën e tyre në klasë. Ata mund t'iu mësojnë nxënësve zanatin e tyre, se si ai lidhet me ato që ata mësojnë në klasë dhe vlerën e shkollës për të ardhmen e tyre.

Përveç kësaj, disa fëmijë - dhe sidomos vajza - mund të jenë të ngarkuara me shumë punë në shtëpi, para se të fillojë shkolla, si kujdesi për vëllezërit e vegjël, pastrimi i shtëpisë, mbledhja e druve të zjarrit, përgatitja e ushqimit dhe kujdesi për bagëtinë.

Kështu, atyre mund t'u mbetet shumë pak kohë për të bërë detyrat e shkollës, mund t'u vijë gjumë në klasë. Këto nuk janë probleme disipline, por reague ndaj situatës në familje. Për rrjedhim, disiplina mbase nuk mund ta zgjidhë sjelljen e fëmijës. Përkundrazi, për t'i ndihmuar fëmijët në punët e shtëpisë dhe në mësim, kërkohen strategji të tjera, siç është kushtimi i vëmendjes ndaj tyre në klasë, duke mos u dhënë shumë detyra dhe kur u jepen, të gjendet kohë që t'i plotësojnë në shkollë, duke i nxitur nxënësit të ndihmojnë njëri - tjetrin në plotësimin e detyrave (mësimi shok me shok) dhe duke u dhënë kohë shtesë për ushtrime ndihmëse, mundësisht me vete për në shtëpi.

Sëmundja dhe uria. Fëmijët nuk mësojnë mirë kur janë të sëmurë, të uritur ose të ushqyer keq. Zakonisht këta fëmijë vijnë nga familje në skamje, të cilat luftojnë çdo ditë për të mbijetuar. Sëmundja dhe uria ulin nivelin e përqëndrimit të nxënësit dhe ndikojnë në mënyrë drastike mbi rezultatet e mësimin. Niveli i ulët i rezultateve mund të shkaktojë ndjenjat e paaftësisë dhe dështimit, të cilat e shtyjnë fëmijën të sillet keq. Veprimet që duhen ndërmarë për t'i ndihmuar këta fëmijë, e kapërcejnë kornizën e klasës tuaj, ato dalin jashtë shkollës dhe përfshijnë të gjithë komunitetin. Aksioni i parë është angazhimi i shkollës për programe mësimore që ofrojnë dreka ose ushqime të gatshme të rregullta e të ushqyeshme. Nga këto mund të përfitojnë sidomos vajzat. Grupet e grave të komunitetit ose organizata vendore mund t'i përgatitin këto dreka ose ushqime të gatshme. Përveç kësaj, ne duhet të punojmë me institucionet shëndetësore lokale për të organizuar programe të rregullta për kujdesin shëndetësor, atë të dhëmbëve dhe kontrollin ushqimor.⁴²

⁴². Për ide shtesë, shih UNESCO. "Broshura 6: Krijimi i një MGJPPM-je të shëndetshme dhe mbrojtëse". « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, mësimdashës ». Bangkok, 2004.

Frika nga dhuna. Frika nga dhuna gjatë rrugës për në shkollë dhe në kthim, si dhe në shkollë apo në klasë (në formën e ndëshkimit fizik apo të zënkave), mund t'i bëjë disa nxënës të tërhequr dhe të mos marrin pjesë gjallërisht në klasë. Ajo, gjithashtu, i jep një goditje të fortë vlerësimit që ata kanë për veten, duke nxitur ndjenjën e paaftësisë. Çfarë veprimesh mund të ndërmerreni ju për ta kuptuar më mirë situatën në shkollë? Ndhimojini fëmijët dhe anëtarët e komunitetit të shohin se në ç'mjedise të shkollës ndodh dhuna, si dhe gjatë ardhjes apo kthimit nga shkolla për në shtëpi. Ju mund të bashkëpunoni dhe me udhëheqësit e komunitetit dhe prindërit për të ngritur aktivitete "në ruajtje të fëmijëve", ku mësues kujdestarë, prindër ose anëtarë të tjerë të komunitetit të ruajnë në zona me mundësira dhune të lartë dhe jashtë shkollës. Këtu mund të përfshihet shoqërimi sa herë që e lyp nevoja i fëmijëve deri në zona të sigurta. Ju mund t'u kërkonin nxënësve të plotësojnë pyetësorë anonimë, ku të deklarojnë nëse i ka ngacmuar kush apo nëse kanë pësuar dhunë fizike dhe si.⁴³ Shkolla juaj mund të ketë nevojë për politika të forta dhe të detyrueshme kundër dhunës ndaj fëmijëve, ku përfshihet dhe ndëshkimi fizik, si dhe kode të përshtatshme sjelljeje për mësuesit dhe personelin shkollor.

Paaftësitë fizike dhe mendore, dhe nevojat e veçanta. Mjaft fëmijë me paaftësi të veçanta apo nevoja të veçanta nuk vijnë në shkollë, sidomos kur shkollat dhe sistemi ynë arsimor nuk ka politika ose programe për të përfshirë fëmijët me paaftësi fizike, emocionale apo të të mësuarit. Megjithatë, disa nga këta fëmijë JANË në shkollë dhe mund t'i keni në klasën tuaj. Këta janë ndër ata që kanë paaftësi më të "fshehta", si me të parët dhe të dëgjuarit, dhe me çrregullime si ADHD-ja, siç ishte Ramoni. Në rast se këto paaftësi nuk zbulohen, sjellja e fëmijëve - që vjen nga moskushtimi i vëmendjes, rezultatet e ulta në mësim, hiperaktiviteti në klasë - mund të identifikohen gabimisht si sjellje të këqia. Shkollës i nevojiten programe kontrolli për t'i evidentuar sa më herët këto situata dhe për t'i drejtuar fëmijët të marrin ndihmën e duhur, që të mund të mësojnë dhe të marrin pjesë gjallërisht në klasë. Nxënësit tuaj mund të bëjnë vetë disa teste të thjeshta për të parit dhe të dëgjuarit.⁴⁴

⁴³ UNESCO. "Broshura 4: Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës, mësimdashës", « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mësimdashës ». Bangkok, 2004.

⁴⁴ UNESCO. « Broshura 6: Krijimi i një MGJPPM-je të shëndetshme dhe mbrojtëse », « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mësimdashës ». Bangkok, 2004.

Familja dhe komuniteti

Familjet dhe komunitetet duhet të jenë në vijën e parë për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët, për të kuptuar problemet që mund të ketë një fëmijë dhe për të ndërmarrë veprime për zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrë të qëndrueshme. Mjeti më efektiv për të parandaluar sjelljen e keqe janë familjet dhe komunitetet e forta, të kujdesshme dhe produktive. Më poshtë jepen disa konsiderata kryesore që kanë të bëjnë me familjen dhe komunitetin e që mund të përcaktojnë nëse nxënësit tuaj vendosin të ndjekin apo jo shkollën, ose se si sillen ata brenda saj. *A ka faktorë të tjerë në shkollën apo në komunitetin tuaj, në vendin apo në kulturën e vendit tuaj, që mund të ndikojnë mbi ecurinë dhe sjelljen e fëmijëve tuaj në shkollë?*

Varfëria dhe vlera praktike e shkollimit. E lidhur drejtpërsëdrejti me faktorin e mësipërm "nevoja për punë" është varfëria, e cila shpesh ndikon në ecurinë e shkollës së një fëmije dhe sjelljen e tij në shkollë. Për shkak të vështirësive të tyre financiare, prindër të varfër shpesh janë nën trysinë e sigurimit të mjeteve më të nevojshme të jetesës. Prandaj, fëmijët janë të detyruar të ndihmojnë të ardhurat e familjes në kurriz të shkollimit dhe jetës së tyre në të ardhmen. Kjo ndodh veçanërisht kur familjet nuk e kuptojnë se shkollimi është me rëndësi për jetën e tyre të përditshme, ndaj ata nuk e kuptojnë përse fëmijët e tyre duhet ta ndjekin shkollën dhe s'tregojnë interes për sjelljen e tyre në shkollë (apo ndonjëherë dhe në shtëpi). Prindërit mund të kenë përshtypjen se shkolla e tyre nuk siguron shkollim cilësor dhe se shprehitë që fëmijët marrin nga disa punëra janë më me vlerë se ato që mësojnë në klasë.

Meqë arsyeja kryesore e varfërisë është ekonomike, strategjitë efektive që synojnë t'i sjellin fëmijët në shkollë dhe t'i ndihmojnë ata të mësojnë aktivisht, shpesh duhet të jenë të bazuara në masa nxitëse ekonomike afatshkurtëra dhe afatgjata për fëmijën dhe familjen e tij.

Kujdesi i pamjaftueshëm. Për shkak të nevojës për para, disa prindërve mund t'u mbetet pak kohë për t'u kujdesur për fëmijët. Ndonjëherë, ata mund të shtrëngohen të migrojnë larg nga familja përkohësisht ose për një kohë të gjatë. Për rrjedhim, ata mund t'i lënë fëmijët nën kujdesin e gjyshit, e gjyshes apo personave të tjerë. Këta prindër ose kujdestarë mund të mos kenë njohuritë, përvojën apo burimet për t'i siguruar fëmijës kujdesin e duhur, gjë që mund të çojë në sëmundje dhe uri. Ata, mbase, nuk mund ta

vlerësojnë shkollimin kur janë në vështirësi të mëdha financiare dhe, ndoshta, nuk e kanë mundësinë të kujdesen se si sillet fëmija në klasë. Cilat janë disa nga veprimet që mund të ndërmerren për t'i ndihmuar këta fëmijë?

- Në ditë të veçanta, i ftoni prindërit dhe kujdestarët e tjerë që të bëjnë një vizitë në shkollë. Tregojuni atyre punimet e fëmijëve dhe zhvilloni me ta biseda informale apo sesione mësimore se si të përmirësohet shëndeti i fëmijëve dhe sjellja përmes një përkujdesjeje më të mirë.
- Njëlloj si më lart, i ftoni prindërit dhe kujdestarët që kanë njohuri të veçanta, të flasini për aftësitë e tyre në klasën tuaj, që edhe ata të mësojnë se njohuritë e tyre janë të vlefshme për fëmijët.
- Inkurajoni konferenca të rregullta "mësues - prindër / kujdestarë" për të diskutuar mbi ecurinë e fëmijëve në mësim, se si një përkujdesje më e mirë mund të përmirësojë rezultatet, vetëvlerësimin dhe vetëkontrollin e tyre.
- Të sigurojnë materiale në ndihmë të kujdesit për fëmijën nga agjenci qeveritare dhe organizata joqeveritare, veçanërisht prej atyre që merren me shëndetin dhe ushqimin. Përdorini ato për programet për fëmijë mbi shëndetin në shkollë apo për edukimin e jetës familjare dhe shpërndaini rregullisht nëpër shtëpira me anë të fëmijëve, për t'i lexuar ato me anëtarët e tjerë të familjes.
- Përgatisni programe trajnimi shprehish mbi rolin e prindit në familje, ku organizata shkollore dhe lokale të ndihmojnë prindërit dhe kujdestarët e tjerë që të përmirësojnë praktikën e kujdesit prindëror dhe të kujdestarëve.
- Zhvilloni partneritet me agjenci vendore të kujdesit social dhe kërkoni që ato të ndihmojnë fëmijët që janë në rrethana të vështira familjare.

Familja dhe komuniteti: Një strategji nga Tajlanda

Në Tajlandë, shkollat që tregojnë kujdes për fëmijët po përdorin informacionin mbi ecurinë e tyre në mësim dhe të dhëna mbi familjen, për të identifikuar ata fëmijë që kanë rezultate të dobëta, që mungojnë shpesh, që nuk tregojnë interes për mësimin dhe që kanë gjasa të braktisin shkollën, shpesh për shkak se familjet e tyre kanë të ardhura të pakta dhe çmojnë më shumë punën e fëmijëve se arsimimin e tyre. Këtyre fëmijëve u jepet përparësi për trajnimin e shprehive për të siguruar mbijetesën në fusha, si endja e mëndafshit dhe pambukut, qepja, punimi me dru, prodhimi bujqësor, shtypshkrimi, trajnime kompjuterike e të tjera si këto. Ky trajnim i shton të ardhurat e familjes, ndërkohë që fëmijët ndjekin shkollën dhe u jep atyre shprehite që mund t'i përdorin gjatë gjithë jetës. Ai, gjithashtu, rrit vlerësimin për veten, besimin dhe ndjenjën e suksesit. Për punën e tyre disa nga fëmijët kanë fituar edhe trofe kombëtare dhe rajonale. Në disa shkolla, anëtarët e familjes së këtyre fëmijëve shërbejnë si "mësues", u mësojnë atyre shprehi që shpërblehen në bazë të kohës, siç janë ngjyrosja e fillit të mëndafshit dhe endja e tij sipas modeleve tradicionale. Kjo pjesëmarrje e rrit vlerën e shkollës në sytë e prindërve dhe anëtarëve të komunitetit, përmes përmirësimit të mjeteve të jetesës, duke e vënë theksin te vlera e ruajtjes së traditave të rëndësishme kulturore. Ajo, gjithashtu, shton komunikimin mes prindërve dhe fëmijëve; prindërit mësojnë rreth punës së fëmijëve dhe sjelljes në shkollë, si dhe mbi atë se çfarë ofron për familjen, në të ardhmen, shkollimi i fëmijës. ***A mundet që një strategji e tillë të përfshihet në programin e shkollës tuaj?***

Konflikt. Disa prindër, të zhytur në probleme financiare e të tjera (si pija dhe droga), mund ta zbrazin dëshpërimin mbi fëmijët e tyre, gjë që çon në dhunë dhe abuzim, si dhe në lindjen e fëmija të ndjenjës së paaftësisë. Kjo mund të kontribuojë në frekuentimin jo të rregullt dhe sjelljen jo të mirë të fëmijëve në shkollë, apo në largimin nga shtëpia, si dhe në braktisjen e shkollës. Gjatë krizës ekonomike aziatike të 1987-ës, p.sh., një djalë tajlandez, gjatë një shërri mes prindërve, u rrah keqas. Jeta në familjen e tij ishte e mjeruar dhe shumë shpejt ai filloi të bëhej i tërhequr në klasë, dhe s'kishte dëshirë të merrte pjesë në mësim. Edhe detyrat s'i bënte në kohë. Në vend që ta ndëshkonte, mësuesja e pyeti se si jetonin dhe kështu doli në shesh e vërteta rreth gjendjes

së tij familjare. Ai tha se nuk e kuptonte përse e kishin rrahur, ai s'kishte asnjë lidhje me problemet në familje. Pas kësaj bisede mësuesja ndryshoi metodën e saj dhe filloi ta lëvdojë fëmijën, duke i dhënë shanse që të shkëlqente, duke treguar ndaj tij "kujdes, dashuri dhe ngrohtësi.". Sa herë që i jepej rasti, ajo i lutej ta ndihmonte para fillimit dhe pas mbarimit të orës së mësimi, duke e larguar, kështu, nga mjedisi shkatërrues në shtëpi. Shumë shpejt, sjellja e tij ndryshoi dhe ai filloi të shkëlqejë në mësim. Pasi prindërit e tij i zgjidhën problemet e tyre, edhe ata e vunë re se ai po ecte mirë në shkollë dhe e përgëzuan gjatë një takimi mësues - prindër në shkollë.

Diskriminimi. Fëmijët që vijnë nga familje që dallojnë shumë nga komuniteti në aspektin gjuhësor, fetar, të shtresës shoqërore apo të karakteristikave të tjera kulturore, shpesh rrezikohen të bëhen shënjestër e rrahjeve, talljeve, ngacmimeve etj. Të rrezikuar janë edhe fëmijët e infektuar me AIDS. Qëndrime negative, diskriminuese ndaj fëmijëve të tillë janë, ndoshta, barriera më e madhe që ata të pranohen në shkollë e që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë, aktive e të gëzuar në procesin mësimor. Qëndrimet negative mund të ndeshen në të gjitha nivelet: te prindërit, anëtarët e komunitetit, në shkollë e te mësuesit, te nëpunësit e shtetit, madje dhe ndër vetë fëmijët e marginalizuar. Frika, tabutë, turpi, injoranca dhe keqinformimi, mes të tjerash, të gjitha inkurajojnë qëndrime negative ndaj fëmijëve të tillë dhe gjendjes së tyre. Këta fëmijë mund të provojnë një ndjenjë inferioriteti; ata mënjanohen e i largohen bashkëveprimit shoqëror, sillen jo mirë në klasë dhe shndërrohen në anëtarë të padukshëm të komunitetit të tyre. Për fëmijë të tillë, ne duhet të punojmë që të zbutet diskriminimi dhe njerëzit të përqafojnë vlerat e diversitetit.

- Punoni me prindërit dhe anëtarët e komunitetit për të modifikuar mësimet në klasë, që materialet të reflektojnë kulturat dhe gjuhët e ndryshme të komunitetit. Kjo do të bëjë që materialet të jenë të dobishme dhe autentike për komunitetin, dhe fëmijët do të inkurajohen të vijnë në shkollë dhe të bashkëpunojnë me të tjerët.
- Për përgatitjen e mësimëve shfrytëzoni tregime të vendit, rrëfenja gojore, legjenda, këngë e poema.
- Për fëmijët, të cilët nuk e flasin gjuhën në të cilën jepet mësimi në klasë, punoni me mësuesit që flasin dy gjuhë apo gjuhën e fëmijës (qofshin dhe në familje apo anëtarë të komunitetit), për të zhvilluar një program mësimor të përshtatshëm në klasë.

Për të shmangur zënkat, ju del për detyrë të ndërmerrni disa veprime, siç janë:

- të zhvilloni ushtrime që i ndihmojnë fëmijët të çlodhen dhe të ulin tensionin;
- të nxitni bashkëpunimin brenda klasës (fëmijët mësojnë njëri - tjetrin);
- të nxitni dëshirën për të dalë i pari, duke u dhënë të gjithë nxënësve më shumë pushtet, duke i nxitur t'i vendosin vetë rregullat e klasës dhe të marrin përgjegjësi në komitetin e nxënësve;
- të shtoni ndjenjën e përgjegjësisë brenda klasës, duke ngritur komitete dhe duke punuar ngushtë me prindërit dhe komunitetin lokal;
- të zhvilloni strategji ndihme reciproke fëmijë - fëmijë, për të zgjidhur konfliktet, siç janë mësimi i aftësive për zgjidhjen e konflikteve dhe ndërmjetësimi (që do të diskutohet më poshtë);
- të ndihmohen fëmijët të njohin masat disiplinore që merren ndaj atyre që ngacmojnë të tjerët.

Brenda programit mësimor mësuesit mund të shfrytëzojnë pjesë dramash ose teatri me kukulla, për të zbuluar para nxënësve fenomenin e zënkave dhe shkaqet e tij, si dhe për të gjetur rrugëzgjdhjen sa herë që ato ndodhin brenda apo jashtë territorit të shkollës. Për shembull, mësuesit në Guajana përgatitën kukulla dhe organizuan shfaqje të shkurtra për të ilustruar aspekte të grindjeve raciale. Më pas, ata ndërtnuan një plan veprimi, që mund të ndërmerrej sa herë që fëmijët të ndodheshin në situata të tilla.

Diskutimet apo debatet mbi çështje të ndjeshme mund të përdoren edhe të shoqëruara me tregime dhe skena teatrale, ku fëmijët të mësojnë të thonë "Jo!" me guxim, si dhe për të gjetur gjuhën e duhur që ta përdorin kundër grindavecëve dhe abuzuesve.⁴⁵

⁴⁵ UNESCO. "Broshura 4: Krijimi i klasave gjithëpërfshirëse, mësimdashëse", « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës dhe mësimdashës ». Bangkok, 2004.

SI TË INFORMOHENI RRETH FAMILJEVE TË NXËNËSVE TUAJ

Në shumë shkolla në Azi dhe në Paqësor, mësuesit po zhvillojnë **profile nxënësish**, si një mjet për të mësuar rreth familjeve nga vijnë nxënësit e tyre. Një profil nxënësi:

- ndihmon mësuesit të kuptojnë arsyet se përse një nxënës mund të mos vijë në shkollë, përse ai mund të sillet jo mirë në klasë ose ka rrezik ta lërë shkollën;
- tregon larminë e fëmijëve në komunitet lidhur me karakteristikat individuale dhe ato familjare;
- Ndhmon të planifikohen programe për të kapërcyer faktorët që i largojnë fëmijët nga shkolla dhe inkurajojnë sjelljen e keqe.

Një profil nxënësi mund të krijohet duke hedhur këto hapa:

Hapi 1: Zbuloni së bashku me kolegët se cilat sjellje të këqia, që manifestojnë nxënësit tuaj janë më të rënda, si dhe faktorët në familje dhe komunitet, që mund t'i shkaktojnë ato (si ato që u diskutuan më sipër). Përpiquni t'i përfshini të gjitha faktorët që ju mendoni se mund të jenë shkaku i mungesave të fëmijëve apo ardhjes vonë në shkollë.

Hapi 2: Duke i shfrytëzuar këta faktorë, përpiloni një listë me pyetje, që kur t'u jepet përgjigje, ato të mund t'ju japin disa ide se pse një fëmijë mund të mos sillet mirë në klasë. Më poshtë keni shembullin e një vargu pyetjesh që janë përdorur në shkollat mikpritëse për fëmijë në Filipine dhe në Tajlandë, për të kuptuar gjendjen e fëmijëve me prejardhje dhe aftësi të ndryshme, të cilët nuk shkojnë mirë me mësim dhe që mund ta ndjejnë veten të paaftë.⁴⁶ ***Ju mund të përpiloni listën tuaj të pyetjeve, duke u bazuar te barrierat që gjykoni se janë të zakonshme në komunitetin tuaj.***

Diskriminimi

- Cili është seksi i fëmijës?
- Çfarë moshe ka fëmija?

⁴⁶ Shembuj të profilit të fëmijës nga vende të tilla, si Salvadori dhe Uganda mund t'i gjeni te: « Manuali për vlerësimin dhe nxitjen e barazisë në klasë », të shkruar nga Vendi Rimer dhe bot. nga Marta S. Maldonado dhe Angela Aldave. Creative Associates International Inc., USAID/EGAT/WID, Washington DC. 2003.

- Cila është kombësia apo përkatësia etnike e fëmijës?
- Cili është besimi i fëmijës?
- Cila është gjuha e mëmës së fëmijës?
- Ku ndodhet shtëpia e fëmijës në raport me shkollën (distanca, koha e udhëtimit)?
- Çfarë lloj transporti përdor fëmija dhe a është i sigurtë?

Faktorët e nivelit të fëmijës

- A punon fëmija në shtëpi apo jashtë saj për të siguruar të ardhura, apo për të ndihmuar në punët e shtëpisë?
- Cila është gjendja shëndetësore e fëmijës dhe të ushqyerit e tij?
- A ka fëmija ndonjë paaftësi që e pengon të përdorë mjetet e shkollës ose përparimin e tij në mësim?

Përkujdesja: konflikti

- Ç'moshë kanë prindërit?
- A rrojnë të dy prindërit e fëmijës? Nëse jo, cila ka vdekur?
- Cili është niveli arsimor i secilit prind?
- A e ka lënë ndonjë prej prindërve shkollën? Përse?
- A janë prindërit e fëmijës ende të martuar?
- Me cilin jeton fëmija?
- Sa veta janë në familje?
- Sa fëmijë janë në familje (sidomos të rinj)?
- Kush përkujdeset për këta fëmijë?
- A kanë migruar prindërit për punë?

Varfëria dhe vlera praktike e arsimimit

- Cila është puna (kryesore) e secilit prind të fëmijës?
- A zotëron familja tokë që jep të ardhura? Nëse po, sa tokë ka?
- A e jep familja tokën me qira për të nxjerrë të ardhura? Nëse po, sa tokë?
- Cila është e ardhura mujore mesatare e familjes?
- A merr familja para borxh për të nxjerrë të ardhura? Nëse po, sa shumë, sa shpesh dhe në cilën periudhë të vitit?
- A merr familja para borxh për të nxjerrë përfitime? Nëse po, sa shumë, sa shpesh dhe në cilën periudhë të vitit?
- A është familja anëtare e grupit të zhvillimit në komunitet?

Hapi 3: Përpiloni një pyetësor për të marrë përgjigje për këto pyetje. Ky pyetësor mund të jetë lista e pyetjeve të mësipërme ose mund të jetë një

formular më formal mbi Profilin e Nxënësit.⁴⁷ Sapo të përpilohet, ai mund të: (a) dërgohet në familjet e fëmijëve për t'u plotësuar dhe t'i kthehet shkollës ose liderit të komunitetit; (b) mbushet nga një mësues gjatë vizitave në familje; ose (c) plotësohet në bazë të intervistave me vetë nxënësit ose me prindërit, kur ata vijnë t'i marrin fëmijët në shkollë, në takimet mësues - prindër ose gjatë mbledhjeve të shoqatave prindër - mësues.

Hapi 4: Pasi pyetëtori të jetë plotësuar dhe kthyer, bëni një studim krijues për çdo fëmijë, duke u mbështetur në përgjigjet e pyetjeve të mësipërme. Ky studim do t'ju shërbejë të identifikoni, lidhni dhe analizoni faktorët që mund të ndikojnë në sjelljen dhe të mësuarit e fëmijëve.

Hapi 5: Pasi të jenë përfunduar këto studime, shqyrtojini me kujdes për të parë se çfarë faktorësh mund të kenë ndikuar në aftësinë e çdo fëmije për të mësuar me kapacitet të plotë në klasë, si dhe në sjelljen e tyre. Nënvizojini ato për t'i bërë të dallueshme dhe mundohuni të bëni lidhjen mes tyre. Për rastin e Ajit, më poshtë, këta faktorë mund të konsistojnë në dallimet kulturore, që bëhen shkak që ajo ta ndjejë veten të diskriminuar dhe inferiore, të varfëria, përkujdesja e pamjaftueshme, mungesa e burimeve jashtë familjes dhe gjendja e keqe shëndetësore, dhe ushqimi i keq. Përdorini këta faktorë si pikënisje për të planifikuar veprime pozitive, për të eliminuar shkaqet përse fëmijët nuk vijnë në shkollë apo sillen keq në klasë. Bashkëpunoni aktivisht me kolegët tuaj, me komitetin drejtues të shkollës, prindërit, liderët e komunitetit dhe organizatat vendore për të planifikuar, ndërmarrë, monitoruar dhe vlerësuar çdo veprim.

⁴⁷ UNESCO. "Broshura 3: T'i tërheqim të gjithë nxënësit në shkollë dhe në mësim", « Të pranojmë diversitetin: Manual për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mësimdashës ». Bangkok, 2004.

Familja e një nxënëseje: Rasti i Ajit

Aji i përket një grupi etnik, Hmong, që jeton në Tajlandën Veriore. Ajo duhet të jetë 9 vjeçe. I ati i ka vdekur. E ëma është 30 vjeçe dhe vejushë. Nëna e Ajit është analfabete. Puna e saj e parë ka qenë te një orizore në një copë tokë, në mal. Gjyshja e Ajit kujdeset për Ajin dhe vëllain e saj pesëvjeçar, i cili nuk shkon në kopsht. Familja e Ajit është shumë e varfër, ajo fiton më pak se 500 baht në muaj. Gjatë sezonit kur nuk ka punë në orizore, nëna e Ajit migron për punë në Bangkok si punëtore. Familja e Ajit nuk bën pjesë në grupin e zhvillimit të fshatit dhe nuk përfiton nga burimet e komunitetit. Gjysma e mungesave të Ajit në shkollë u justifikuan, sepse ajo kishte nevojë të ndihmonte nënën dhe gjyshen, ndërsa gjysma tjetër ishte shkaktuar nga sëmundjet. Ajo vuan zakonisht nga infeksione akute të frymëmarrjes (ARI) dhe ka një mungesë të lehtë jodi. Kur Aji është në klasë, ajo shpesh fle dhe nuk i bën detyrat e shtëpisë në kohë. Shumë herë ajo duket e shqetësuar dhe e painteresuar në mësim ose për shoqet e saj.

Shënim: Për ju që punoni në klasa të mëdha, fillojeni punën duke krijuar profilin e çdo nxënësi për atë grup të vogël fëmijësh, të cilët mund të kenë nevojë për kujdes të veçantë ose ngaqë kanë rezultate të dobëta, ose sepse sillen tani keq, ose sepse ju dyshoni se situata e tyre personale apo familjare ndikon për keq në sjelljen e tyre. Më pas, shtrijeni këtë punë dhe te fëmijët e tjerë.

KOMUNIKIMI PRINDËR - MËSUES

Ndërtimi i një raporti pozitiv mësues - nxënësi, i tillë që të nxitë sjellje të mira dhe të parandalojë sjelljen jo të mirë, kërkon edhe përfshirjen e prindërve në shkollimin e fëmijëve. Dy prej faktorëve që mund ta shtyjnë fëmijën drejt sjelljes së keqe dhe braktisjes së shkollës janë mosinteresimi i prindërve dhe kërkesat e tyre të ulta.⁴⁸ Interesimi i prindërve ka një efekt pozitiv në rezultatet e fëmijëve dhe është sinjali më i saktë për një sukses të nxënësit në shkollë. Disa nga përfitimet që ka interesimi i familjes janë:

⁴⁸ Uells, S.E. "Identifikimi i të rinjve në rrezik", programe dhe rekomandime. Engleud, Kolorado: Teacher Idea Press, 1990.

- Nxënësit arrijnë rezultate më të mira, pavarësisht nga gjendja e tyre socialekonomike, prejardhja e tyre etnike apo raciale, nga arsimit që kanë prindërit.
- Nxënësit ndjekin shkollën rregullisht.
- Nxënësit i bëjnë detyrat më rregullisht.
- Nxënësit shfaqin qëndrime të sjellje më pozitive.⁴⁹

Por, për t'i tërhequr prindërit të interesohen për shkollimin e fëmijëve të tyre, ju duhet të tregoni vetë kujdes për fëmijën. Studimet tregojnë se prindërit shfrytëzojnë si një mjet informimi njohuritë që ka mësuesi mbi personalitetin ose interesat e fëmijës. Ata i dëgjojnë me dëshirë komentet mbi fëmijën e tyre, në rast se e shohin se mësuesi e di se çfarë ka të veçantë fëmija e tyre.⁵⁰ Kjo është një nga arsyet kryesore se përse njohja e fëmijës dhe e familjes së tij është kaq e rëndësishme në zhvillimin e raporteve prindër - mësues. Përveç kësaj dhe sidomos të fëmijët që sillen përherë keq në klasë, takimet prind - mësues - nxënës shpesh i japin fund lojës që fëmijët luajnë, duke kundërvënë shkollën me familjen apo prindin kundër mësuesit.

Zakonisht, takimet prind - mësues ose prind - mësues - nxënës mbahen, të paktën, për katër arsye:

- (a) për të diskutuar, me kërkesën e shkollës, për çështje të veçanta mësimore, siç është ecuria në mësimet e fëmijës (e dobët apo e mirë) ose për t'u kërkuar ndihmë prindërve në klasë apo në shkollë;
- (b) për të diskutuar frekuentimin e fëmijës në shkollë apo çështje të disiplinës;
- (c) për të diskutuar çështje që ngrenë vetë prindërit;
- (d) për të zhvilluar një takim të zakonshëm, siç parashikohet në kalendarin shkollor.

Me kohë, mësuesit me eksperiencë krijojnë zakonisht stilin dhe procedurat e veta në organizimin e këtyre takimeve. Megjithatë, mësuesit fillestarë është e nevojshme që të përpilojnë një plan takimesh. Ky plan duhet të përmbajë burimet për të cilat ata kanë nevojë, pengesat që mund të

⁴⁹ "Komunikimi prind - mësues". Akademia e Zhvillimit Profesional. <http://www.mcps.org/iss/Portfolio/Communication/Conferences.ppt> [marrë në internet më 12/1/2005].

⁵⁰ Reformimi i shkollave të mesme dhe sistemeve shkollore. Ndryshimet në shkolla në Luisvil, Vol. 1, No. 2 - pranverë/verë, 1997.

ndikojnë në ecurinë e takimit, mënyrën se si të kapërcehen ato, çështjet kryesore tipike për të gjithë nxënësit dhe çështjet specifike për nxënës të caktuar.⁵¹

Burimet mund të përmbajnë:

- Kush duhet të vijë në takim dhe në ç'ditë e në ç'orë?
- Ku do të bëhet takimi?
- Nëse prindi do të vijë me fëmijën, për çfarë do t'jua tërhiqni vëmendjen?
- Çfarë të dhënash keni siguruar mbi frekuentimin e shkollës, të cilat mund të jenë të vlefshme për takimin me prindërit, që ju mund t'i kërkonti para se të fillojë takimi? Disa mësues mbajnë "ditar mbi incidentet në sjellje", për të mbajtur shënimet sa herë që verifikohet një sjellje jo e mirë dhe e shfrytëzojnë atë gjatë takimit me prindërit. Ato mund të shfrytëzohen edhe për të identifikuar nëse fëmija sillet keq rregullisht dhe në ç'mënyrë. Këto dosje përmbajnë: (a) emrin e fëmijës; (b) datën dhe orën e incidentit; (c) një përshkrim të shkurtër të sjelljes; (d) masën e marrë; (e) emrin e personit të cilit i është raportuar incidenti, si dhe metodën e raportimit (me shkrim, me gojë); (f) emrin e personave dëshmitarë gjatë sjelljes jo të mirë; (g) emrin e personit që plotëson këtë ditar / raport dhe datën; (h) ndonjë faktor tjetër që ka kontribuar dhe / ose ndryshime që duhen bërë, të cilat mund të ndikojnë në sjelljen e fëmijës; dhe (i) nënshkrimin e drejtorit, mësuesit dëshmitar dhe prindit, si dhe datën.

Kufizimet apo barrierat e rëndësishme, që mund të bëhen pengesë gjatë diskutimit në takimin me prindërit, ju duhet të përpiqeni t'i zgjidhni para se t'i ftoni ata. Më poshtë kemi përmendur disa pengesa të tilla. A dini të tjera?

- A keni ndonjë zëvendësues, i cili mund të shikojë klasën kur ju të jenë në takim?
- Si lidheni me familjet që nuk kanë telefon?
- Po nëse prindërit e ndarë refuzojnë të vijnë në të njëjtin takim?
- Disa prej prindërve mund të mos kenë me se të vijnë apo janë të angazhuar në punë. Si do ta rregulloni që edhe këta prindër të vijnë në takim? Apo mund të shkoni ju tek ata?

⁵¹ "Komunikimi prind - mësues". Akademia e Zhvillimit Profesional. <http://www.mcps.org/iss/Portfolio/Communication/Conferences.ppt> [marrë në internet më 12/1/2005] .

Ndër çështjet e rëndësishme mund të përfshihen:

- Deri në çfarë shkalle duhet përfshirë nxënësi gjatë diskutimit?
- Si mund t'i angazhoni prindërit për zgjidhjen e problemeve?
- Çfarë dokumentacioni nevojitet?
- Çfarë diskutoni ju me prindërit e një nxënësi të talentuar, të një nxënësi i cili jep shenja paaftësie në të mësuar apo të atij që ka probleme me sjelljen?

Një takim i organizuar mirë jo vetëm që do t'ju bëjë punën më të lehtë, por do t'ju tregojë prindërve se ju jeni një person i përgatitur, se keni shpenzuar kohë për t'u përgatitur që të diskutoni rreth problemit të fëmijës. Gjatë përgatitjes të këtij takimi, duhen përdorur këto procedura:

- Një letër drejtuar prindërve me kërkesën për t'u paraqitur në takim. Kërkesa duhet të jetë pozitive, edhe kur është fjala për të diskutuar sjelljen jo të mirë të fëmijës. (Për shembull: "Xhoni është një djalë i vështirë në mësim. A do të ishit i lirë më [datë, ora] të diskutojmë mbi ecurinë e tij?")
- Një listë me materialet që duhet të keni me vete gjatë takimit.
- Një listë me emrat e njerëzve që do të ftohen në takim (nëse është nevoja).
- Një axhendë për vetë takimin (për secilin nxënësi, axhenda u duhet dhënë dhe prindërve kur vijnë në takim).
- Diçka për të marrë shënim rezultatet e takimit dhe planin e detyrave që duhet të ndiqen.
- Plani i detyrave që duhet ndjekur për çdo nxënësi. Nëse është e mundur, ky plan - apo së paku disa pika kryesore - duhen diskutuar me prindërit e fëmijës, sidomos kur disa pjesë të planit kërkojnë monitorim dhe komente nga ana e prindërve.

Shënim: Takimet prind - mësues mund të jenë formale ose informale. Për mësuesit që punojnë me klasa të mëdha, ku nuk ka shumë kohë në dispozicion për t'i takuar të gjithë prindërit brenda një dite, zhvillonit takime formale me prindërit e fëmijëve që hasin

vështirësi. Për nxënësit e tjerë, organizoni diskutime informale periodike në një kohë të përshtatshme (për ju dhe prindërit). Këtu mund të përfshihen takimet në klasë ose në mjediset e shkollës, siç është çasti i marrjes së fëmijëve nga prindërit në shkollë; takime në shtëpi, kur ju bëni vizita në shtëpi; ose takime në ato ditë kur zhvillohen ngjarje të veçanta në shkollë apo në komunitet.

STRATEGJI INKURAJIMI

Në këtë seksion u fol për mënyrën se si ndërtohet raporti pozitiv me nxënësit tuaj bazuar në kuptimin dhe mirëkuptimin. Disa nga kërkesat, që kanë rëndësi të veçantë për të inkurajuar një sjellje pozitive të nxënësit, si pjesë e procesit të ndërtimit të një raporti të tillë, janë:⁵²

- **Mbajtja e një toni emocional pozitiv** në klasë. Mënyra se si ju i trajtoni dhe reagoni ndaj nxënësve.
- **Kushtimi i vëmendjes** ndaj nxënësit për të nxitur sjellje pozitive. Për nxënës më të rritur, te kushtimi i vëmendjes hyjnë ndërgjegjësimi dhe interesimi për jetën e tyre në familje, për aktivitetet e tyre shkollore dhe aktivitete të tjera me interes për ta.
- **Vendosja e rregullave rutinë** në formën e rutinave të rregullta për aktivitete të përditshme dhe veprime të tjera, në mënyrë që përvoja negative të papritura të përjetohen me sa më pak stres.
- **Reagim konstant** ndaj sjelljeve të ngjashme - si pozitive dhe atyre negative - në mënyrë që të nxisni raporte më të drejta mësues - nxënës dhe rezultate më pozitive të nxënësit.
- **Elasticitet**, sidomos me fëmijët e rritur dhe adoleshentët. Vëruni veshin arsyeve të tyre për përshtatjen ose jo me kërkesat tuaja, ose me rregullat e klasës dhe diskutoni për gjetjen e një zgjidhjeje. Kjo tregon se ju i vlerësoni pikëpamjet e nxënësve, të cilat mund të zvogëlojnë shanset e sjelljeve jo të mira. Gjithashtu, përfshirja e

⁵² Përshtatur nga: Akademia Amerikane e Pediatriisë. Udhëzime për disiplinën efektive. <http://aappolicy.aappublications.org/cgi/content/full/pediatrics;101/4/723> [marrë nga interneti më 12/2/2005].

nxënësit në vendimmarrje shoqërohet me një gjallërim afatgjatë të gjykimit moral.

- **S'ka gjë se bëhen gabime.** U thoni nxënësve tuaj se: "Ne vetëm mësojmë nga gabimet tona. Edhe unë bëj gabime çdo ditë. Edhe tani mund të bëjmë ndonjë!". Kjo krijon partneritet në orën e mësimit, të mbështetur në respektin reciprok.
- **Krijimi i besimit.** Nxitni bisedimin pozitiv me vetveten. Kërkojini secilit nxënës të flasë mbi ato që ai mendon se janë të mira, çfarëdo qofshin ato. Më pas, përdorini përgjigjet e tyre në mësimet tuaja, nxitini ata t'ju ndihmojnë gjatë mësimit.
- **Përqëndrohuni në sukseset e kaluara.** Për një nxënës, të cilit i duket vetja i paaftë apo ka frikë se do të ngelë në mësim, lëvdojini notën e provimit të fundit (çfarëdo që të ketë qenë ajo) dhe inkurajojeni të bëjë më shumë përpjekje. Tregohuni i gatshëm t'u jepni orë shtesë konsultimesh apo detyrash për të përmirësuar notën dhe vazhdoni kështu.
- **T'i jepet kuptim mësimit.** Modifikoni metodat tuaja të mësimdhënies. Në vend të një leksioni mbi figurat gjeometrike, ndajini nxënësit në grupe të vogla dhe kërkojuni atyre të gjejnë sa më shumë figura të ndryshme në shkollë apo në komunitet brenda 15 minutave. Grupi që fiton merr një çmim simbolik!



Krijimi i një mjedisi pozitiv që nxit të mësuarit

Çfarë do të mësoni:

- Rëndësinë që ka drejtimi i orës së mësimit.
- Krijimi i një mjedisi mësimor të këndshëm.
- Krijimi i rregullave rutinë në klasë.
- Vendosja e rregullave gjatë mësimit dhe përfshirja e prindërve.
- Ndërtimi i një stili pune që nxit sjellje të mira.
- Dhënia e kurajos pozitive.

DREJTIMI GJATË ORËS SË MËSIMIT ËSHTË NJË KGJM

Në mënyrë që nxënësit tuaj të zhvillojnë sjellje të mira, ata duhet të gjejnë një mjedis mësimor të drejtuar mirë e të organizuar mirë. Kur mendojmë për drejtimin e orës së mësimit, shumë prej nesh mund t'u shkojë mendja te kontrolli i sjelljes së nxënësit ose te mënyra se si mund ta kontrollojmë të gjithë klasën. Aktualisht, reagimi ynë ndaj sjelljes së nxënësit apo sjelljes së tij jo të mirë, duhet të jetë veprimi i fundit në radhë në planin e drejtimit të orës mësimore. Në një klasë të organizuar mirë, ky veprim, ma merr mendja, në formën e një teknike disiplineje pozitive, do të kërkojë pak kohë dhe do ta ndërpresë shumë pak rrjedhën e mësimit. Për të arritur deri këtu, juve ju nevojitet një plan për drejtimin e orës së mësimit, që ka disa elementë. Disa nga këta elementë janë trajtuar në Broshurat 4 dhe 5 të këtij Manuali për "Krijimin e klasave gjithëpërfshirëse dhe mësimdashëse", të botuara nga UNESCO, Bangkok. Këtu ne do të diskutojmë për të tjerat.

Hapi i parë në procesin e planifikimit është të përcaktohet se çfarë do të thotë realisht "drejtim i orës së mësimit". Kur përdorim termin "drejtim i orës së mësimit", ne kemi parasysh procedurat, strategjitë dhe metodat e mësimdhënies, që mësuesit shfrytëzojnë për të krijuar një mjedis mësimor që nxit të mësuarit, si dhe zhvillon, dhe edukon sjellje dhe aktivitete mësimore me nxënës të veçantë dhe grupe nxënësish në atë mjedis. Drejtimi efektiv i orës së mësimit krijon, kështu, një mjedis nxitës për ne në mësimdhënie, si dhe për

zhvillimin e të mësuarit dhe të sjelljes të të gjithë nxënësit. Drejtimi jo i efektshëm i orës së mësimi shpesh krijon kaos, nxënësit tanë nuk dinë se çfarë kërkojmë prej tyre; ata nuk e kuptojnë se si duhet të sillen apo të reagojnë; nuk i njohin kufijtë dhe as masat ndëshkuese që do të merren në rast të sjelljeve jo të mirë. Drejtimi efektiv i orës së mësimi është aftësia më e rëndësishme - dhe më e vështirë - që një mësues i ri duhet të zotërojë. Edhe mësuesit me eksperiencë shpesh gjenden përballë një nxënësi - apo një klase të tërë - që sfidon aftësitë e drejtimit të fituara me kohë dhe i shtrëngon të gjejnë rrugë të reja për të zgjidhur situata që lindin gjatë orës së mësimi.

KRIJIMI I NJË MJEDISI TË PËRSHTATSHËM MËSIMOR

A keni qenë ndonjëherë në një dhomë të mbushur plot me njerëz apo sende, si, p. sh., mobilje? Si jeni ndjerë në fillim? Kur hyn në dhomë, në fillim mund të mbetemi të habitur, por kur na është dashur të punojmë aktualisht aty, së bashku me njerëz të tjerë, mund të kemi patur ndjenja negative. Mund të jemi zhgënjyer ose zemëruar, ose jemi tërhequr në një qoshe dhe jemi përpjekur t'i evitojmë të tjerët, ose kemi bërë kujdes të mos përplasemi me objektet e shumta në dhomë.

Në klasa, ku hapësira fizike nuk është e organizuar mirë, nxënësit tanë mund të përjetojnë ndjenja të tilla. Ato mund të sillen keq si kundërveprim ndaj zhgënjimit apo nga frika. Prandaj, një klasë me hapësirë të planifikuar mirë mund të na ndihmojë t'i parandalojmë sjelljet e këqia që mund të shfaqen. Kjo, gjithashtu, ndikon mbi ecurinë e orës mësimore.

Si me të gjitha aspektet e drejtimit të orës së mësimi, mënyra se si është e organizuar dhoma e klasës, varet nga preferencat tuaja, si dhe ato të nxënësve tuaj. Ajo çfarë ju bën të ndjeheni rehat, mund të mos jetë e njëjtë me atë që i bën nxënësit tuaj të ndjehen rehat. Organizojeni klasën në fillim të vitit dhe, më pas, pyetini nxënësit nëse ndjehen mirë në të. Akoma më mirë, ndajini në grupe dhe pyesni secilin grup të hedhë një vështrim rrotull dhomës dhe atyre çka shohin aty, dhe më pas të bëjnë një skicë se si do t'u pëlqente dhoma. Shfrytëzoni idetë nga të gjitha këto skica apo vizatime për të dizenuar klasën "personale" të nxënësve. Përpiquni të mbyllni rregullimet në një a dy javë dhe, më pas, pyetini nxënësit nëse e ndjejnë veten mirë. Bëni ndryshime në dhomë, nëse ata mendojnë se ndryshe do të ishte më mirë. Ndryshojeni atë sa herë që ju duket se nxënësit tuaj ndjejnë bezdi, kur ulen në klasë dhe mësojnë.

Më poshtë do të gjeni gjëra që duhet t'i dini, kur ju dhe nxënësit tuaj organizoni hapësirën e klasës tuaj.⁵³ Kjo listë nuk është shterruese. Juve mund t'ju shkojë mendja në gjëra të tjera.

T'i shihni të gjithë. Ju duhet të jeni në gjendje t'i shihni të gjithë nxënësit tuaj, në çdo kohë, që të monitoroni punën dhe sjelljen e tyre. Ju, gjithashtu, duhet të jeni në gjendje të shihni derën që nga tavolina juaj. Nxënësit duhet t'ju shikojnë ju dhe vendin ku jepni mësim, pa qenë nevoja të ktheheni apo të lëvizni shumë.

Vende për t'u ulur të gjithë (të shmanget ndjenja e mbipopullimit). Në klasa me shumë nxënës, hapësira shpesh është një luks. Për ta shfrytëzuar sa më mirë atë, kini parasysh tre strategji. Së pari, largoni mobiljet e tepërta. Përdorni karrike me vend për shkrim në vend të bangave. Përdorni rafte të fiksuara në mur dhe mbi dyshtet për materialet që nxënësve nuk u nevojiten rregullisht. Në rast se klasa juaj ka një dollap për të mbajtur sendet e nxënësve, nxirreni nga klasa. Po qe e mundur, mbajini sendet tuaja personale, materialet mësimore dhe ndonjë send tjetër në kabinetin e mësuesit ose në një kasafortë tjetër jashtë klasës. Në qoftë se nuk ju duhet realisht një tavolinë mësuesi, kërkoni një më të vogël.

Strategjia e dytë është të jeni krijues në metodën tuaj të mësimdhënies, duke e shndërruar klasën në një mjedis ndërveprues, për të zbutur ndjenjën e mbipopullimit. Përpiquni të jepni mësim vetëm gjatë njërës pjesë të kohës së mësimit, p. sh., nga 1 orë, vetëm 20 minuta, dhe përqëndrohuni në një ose dy çështje a koncepte të rëndësishme (p. sh., duke folur mbi figurat gjeometrike), në vend që të jepni shumë informacion menjëherë. Kjo është koha maksimum që ju mund të mbani të përqëndruar vëmendjen e nxënësve. Më pas, ndajeni klasën në dy grupe, ku atyre do t'u duhet të shohin vetëm pak fytyra. Kur është e mundur, shfrytëzoni grupe me sekse të ndryshme, në vend të një grupi me djem dhe një me vajza. Jepini çdo grupi ushtrime plotësuese, si, p. sh., njëri grup të mendojë sa më shumë objekte, kurse tjetri të gjejë sa më shumë objekte në formë katrore. Aty nga fundi i orës së mësimit, bashkojini prapë bashkë dhe kërkoni çdo grupi të tregojë atë çfarë ka mësuar.

⁵³ Përshtatur nga "Drejtimi i orës së mësimit. Si të menaxhojmë hapësirën fizike". Bashkëpunëtor për rezultatet e larta në përgatitjen e mësuesit (CETP), Fondacioni Kombëtar i Shkencës. http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/cm-space.html [marrë në internet më 10/20/2005].

Njëlloj si kjo, strategjia e tretë është shfrytëzimi sa më shpesh i hapësirës jashtë klasës. Mjediset e shkollës mund të shndërrohen në një burim të pasur për mësimin e rregullt. Ato janë klasa në ajër të pastër, që mund të eksplorojnë nga nxënësit si pjesë e të mësuarit dhe mund të shërbejnë si një alternativë e bukur në krahasim me klasat e mbipopulluara. Ekzistojnë vende të rëndësishme, ku fëmijët mund të zhvillojnë shprehje sociale dhe njohëse. Mjediset e shkollës ju japin shanse për ta bërë sa më të larmishme mjedisin mësimor dhe për të zhvilluar mësimet të rëndësishme mbi bashkëpunimin, zotërimin, përkatësinë, respektin dhe përgjegjësinë.⁵⁴ Mjedise të ndryshme të shkollës mund të përdoren si qendra aktivitetesh, për të pasuruar atë që mësohet në klasë. Në shembullin e figurave gjeometrike, p. sh., nxënësve mund t'u kërkohet të eksplorojnë mjediset e shkollës dhe të identifikojnë sa më shumë forma gjeometrike që të jetë e mundur. Më pas, uluni poshtë një peme dhe ata të shkruajnë të gjitha ato që kanë parë. Ndiqni nga afër punën e tyre! Dhjetë minuta para se të mbarojë mësimi, mblidhni të gjithë, qoftë në klasë, qoftë jashtë, dhe paraqitni gjetjet e tyre.

Mobiljet. Në qoftë se dhoma e klasës ka hapësira të mjaftueshme, përpiguni t'i vendosni bangot e nxënësve në mënyra të ndryshme, si, p.sh., në formën e U-së për diskutime, në formë katrori për punë në grup dhe në radhë për kontroll ose punë individuale. Mendoni se si ta lehtësoni lëvizjen mes këtyre lloj renditjeve. Vendet që përdoren shpesh dhe "rrugët e kalimit" (në mes bangave), duhet të lihen të lira për këdo. Shfrytëzoni raftet, tavolinat ose qilimat për të krijuar mjedise për përdorime speciale. Në rast se dhoma mund të ndahet ose ka nevojë për "hapësira muresh", ku nxënësit të ekspozojnë punën e tyre, gjeni zgjidhje të pakushtueshme, siç janë kurrizet e rafteve apo panele vertikale të larta të thurrura me gjethe palmash ose bambuje të bëra nga nxënësit, apo familjet e tyre. Këto panele mund të shfrytëzohen për të ndarë klasat në shkollë, aty ku nuk ekzistojnë mure ndarëse.

Qendrat. Qendrat për aktivitete u ofrojnë një nxënësi apo grupeve të vogla të nxënësve, mundësinë për të punuar në qetësi në projekte ose aktivitete. Një qendër e tillë në klasë ka nevojë për hapësirë pune, një vend ku të vihen veglat dhe materialet, një vend ku të afishohen instruksionet. Në

⁵⁴ Malone, Karen dhe Tranter, Paul. "Ora e mësimit të fëmijëve në mjedise të hapura dhe përdorimi, dizenjimi dhe menaxhimi i mjediseve të shkollës", "Fëmijët, rinia dhe mjedisi". Vol. 13, No. 2, 2003.

klasa të mbipopulluara, qendrat e aktiviteteve mund të vendosen në zona të ndryshme të shesheve të shkollës. Fëmijët sjellin me vete gjithçka që u nevojitet për të kryer aktivitetin.

Materialet për instruktim dhe burimet e mësimdhënies. Librat dhe materialet e tjera për instruktim kanë nevojë të vendosen diku, ku të gjenden lehtë. Mjete, si shkumësa, vizore, metër, bojra dhe gërshërë duhen vënë diku, ku nxënësit t'i marrin pa i shqetësuar të tjerët. Ashtu si materialet e instruktimit, mjetet mësimore, si tabelat e vogla, kavalete, harta dhe tavolina pune duhen vendosur në atë mënyrë që të mos pengojnë rrugën dhe në klasat e mbipopulluara, të mos zënë shumë vend.

Puna e nxënësit. Mbledhja dhe ruajtja e punimeve të nxënësve shumë shpejt mund të zërë mjaft vend, në rast se nuk ndërtohet një plan. Disa mësues shfrytëzojnë dosje personale, për ta bërë këtë. Dosje mund të krijohen për secilin nxënës, për çdo temë apo grup nxënësish. Gjithashtu, nevojitet edhe një vend për të paraqitur punën e nxënësit. Kjo hapësirë mund të jetë faqja e murit ose një pllakë fibre, ku punimi i nxënësit mund të ngjitet me kapëse, striçe apo thjesht me thumba. Dekorimi i dhomës me punimet e nxënësit do të ndihmojë edhe për ta bërë më tërheqëse e më mikpritëse klasën, edhe kur ka shumë nxënës në të.

Përfshirja e nxënësit. Nxënësit mund të jenë shumë të dobishëm në menaxhimin e hapësirës fizike të dhomës së klasës dhe kjo i ndihmon ata të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë. Ata mund t'i varin punimet e nxënësve, të krijojnë kënde njoftimesh dhe të heqin materialet didaktike në fund të çdo mësimi. Nxënësit mund të jenë të dobishëm edhe për të zgjidhur problemin e vendit. Kur lind një problem, kërkojuni ndihmë nxënësve që përplasen mes rreshtave të bangave apo që s'kanë mjaft vend për t'u ulur.

Kujtesë: *Disiplina e mirë dhe krijimi i sjelljeve pozitive të nxënësit ka gjasa të kenë më shumë sukses, kur klasa juaj dhe aktivitetet në të strukturohen ose organizohen për të nxitur frymën e bashkëpunimit mes nxënësve dhe mes tyre, dhe ju vetë.*

ZHVILLIMI I RUTINAVE NË KLASË

Kur ne zhvillojmë rutina në klasë, mundësia për shfaqjen e sjelljeve të këqia pakësohet, sepse nxënësit e dinë se çfarë kërkohet prej tyre dhe se ç'duhet të bëjnë. Ato ndihmojnë, gjithashtu, në shmangien e "keqkuptimeve", d.m.th., të keqinterpretimit të sjelljes së fëmijës si një sjellje e keqe, p.sh., kur fëmija nuk e di se duhet ta mprehë lapsin pas orës së mësimit dhe jo gjatë tij, ose se duhet të ngrerë dorën kur kërkon leje. Në qoftë se nxënësi i njeh hapat që duhet të ndjekë për të mbaruar një punë, ai ka mundësi ta plotësojë atë me rregull. Zhvilloni plane që ndihmojnë realizimin e aktiviteteve të tilla në hapësirën tuaj, si dhe stilin e drejtimit (për të cilën do të diskutojmë më poshtë). Në rast se një rutinë nuk ka efekt, kërkoni ndihmën e nxënësve, për ta riplanifikuar atë. Më poshtë do të gjeni disa nga rutinat në klasë që mund të planifikoni ju dhe nxënësit tuaj.⁵⁵ A dini ju të tjera?

Lëvizja. Zhvilloni plane për hyrjen dhe daljen nga klasa, si dhe për ndryshimin e paraqitjes së klasës në varësi të temës që mësohet, si, p. sh., ndryshimi nga modeli i një klase ku bëhen detyra kontrolli, në një klasë me grupe të vogla për leksione arti apo shkence. Gjithashtu, hartoni plane se si mund të plotësohen nevojat individuale të nxënësve, kur mund të mprehin lapsat apo të marrin mjetet e veta mësimore, siç janë materialet e vizatimit.

Detyra jodidaktike. Te këto detyra përfshihen aktivitete, si marrja e mungesave, mbledhja e letrave të justifikimit apo raporteve për mungesat, si dhe mbajtja pastër e klasës. Kur lejohet, nxënësit mund të ndihmojnë në përmbushjen e këtyre detyrave dhe sidomos ata nxënës, që kanë më shumë nevojë për vëmendje. Disa prej këtyre detyrave mund të shfrytëzohen edhe si aktivitete didaktike, siç është llogaritja e përqindjes së nxënësve që erdhën atë ditë në orën e matematikës.

Sistemimi dhe lëvizja e materialeve. Në qoftë se zhvillohen rutina për shpërndarjen, mbledhjen dhe vendosjen e materialeve mësimore dhe të mësimdhënies, nxënësit që ndihmojnë do të jenë të aftë t'i kryejnë shpejt ato. Nëse materialet didaktike përgatiten dhe organizohen me kohë, ju mund t'i lëvizni ato kollaj dhe pa shpenzuar kohë, nga njëri aktivitet në

⁵⁵ Përshtatur nga: "Drejtimi në klasë - Rutinat në klasë". "Bashkëpunimi për rezultate të larta në edukimin e mësuesit" (CETP), Fondacioni Kombëtar i Shkencës. http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/cm-routi.html [marrë në internet më 10/20/2005].

tjetrin. Materialet e nevojshme mund të nxirren çdo ditë mbi bazën e një programi, kështu që nxënësit do të dinë se çfarë u nevojitet dhe parapërgatiten për një aktivitet, kurse materialet për aktivitetin e mëparshëm tashmë janë mbledhur e vendosur në vendin e duhur.

Puna në grup. Puna në grup nxit bashkëpunimin gjatë mësimin. Ajo u mëson nxënësve të punojnë së bashku, duke u mësuar vlerën që ka puna në ekip. Çdo pjesëtar i ekipit, brenda një grupi, duhet të ketë një detyrë të caktuar dhe me kohë, çdo nxënësi duhet t'i jepet mundësia t'i provojë të gjitha detyrat. Zhvilloni me nxënësit tuaj planifikimin e punëve dhe rutina për caktimin e punëve. Detyrat që caktohen mund të jenë ato të ndihmësit, matësit të kohës, raportuesit, regjistruarit, inkurajuesit, intervistuesit, magazinierit ose drejtuesit.

PËRPILIMI I RREGULLAVE TË KLASËS ME NXËNËSIT DHE PRINDËRIT

Çdo klasë ka nevojë për rregulla, që ajo të funksionojë mirë. Këto "rregulla" quhen "kërkesa" apo "standarde sjelljeje".

Natyra e rregullave në klasë dhe e rutinave, si dhe mënyra se si përpilohen ato, ndryshon në vartësi të kulturës së mësuesit. Mënyra se si punojmë me nxënësit në klasë, se çfarë rregullash dhe rutinash caktojmë, varen nga kultura jonë dhe se si mësohen të sillen nxënësit. Disa nga ne besojnë se ata janë përfitues pasivë të diturisë, se kanë nevojë t'i përshtaten sistemit dhe të shohin qartë përfitimet që ka shkollimi i tyre. Prandaj, ne mund ta vëmë theksin te rregulla dhe rutina rigoroze, dhe standarde. Kurse disa të tjerë mund të besojnë se nxënësit janë aktivë, pozitivë, të motivuar dhe se i zgjidhin vetë problemet. Prandaj, ne mund ta vëmë theksin e punës te krijimi i shanseve për ta.⁵⁶ Kur hartojmë rregulla dhe rutina për klasën ,duke angazhuar edhe nxënësit, ne mund të zgjedhim një rrugë të mesme më elastike për të plotësuar situatat e ndryshme, gjithnjë në ndryshim, në klasën tonë.

Ne shpesh hartojmë rregulla, si një mënyrë për të parandaluar problemet me sjelljen ose vështirësitë që mund të lindin në drejtimin e orës së mësimin.

⁵⁶ Mayeski, Fran. "Metamorfoza e drejtimit në klasë. Studime kontinentale për edukimin dhe mësimin". <http://www.mcrel.org/pdfconversion/noteworthy/learners%5Flearning%5Fschooling/franm.asp>.

Udhëzimet kryesore për përcaktimin e rregullave të tilla duhet të përmbajnë:

- Hartoni pak rregulla, që e vënë theksin te mënyra e duhur e sjelljes, pasi as ju dhe as nxënësit nuk mund të mbajnë mend një listë të gjatë. Afishojini këto rregulla në klasë, që t'i lexojnë të gjithë.
- Shikoni të hartoni rregulla apo të vini kërkesa për këto çështje, që mësimi në klasë të shkojë sa më mirë: (a) fillimin dhe mbarimin e ditës së shkollës, mënyrën se si mbahen mungesat dhe çfarë u lejohet e nuk u lejohet nxënësve të bëjnë; (b) përdorimin e materialeve dhe pajisjeve; (c) si kërkohet leje për nevoja të papritura (si shkuarja në tualet apo mprehja e një lapsi); (d) procedurat e punës në bankë dhe puna e pavarur në grup; dhe (e) si do të pyeten dhe do të përgjigjen nxënësit.
- Zgjidhni rregulla që vënë rregull në mjedisin e klasës dhe që nxitin mësimin dhe rezultatet e mira. Disa sjellje si ngrënia e çimçakizit apo lëvizjet në bankë, mbase, nuk e pengojnë shumë mësimin, ndonëse bëjnë zhurmë dhe tërheqin vëmendjen.
- Mos hartoni rregulla që nuk i doni apo që nuk mund të kërkohen të respektohen vazhdimisht.
- Hartoni rregulla sa më të qarta që të jetë e mundur. Ata duhet të deklarohen mënyrën e sjelljes: "Duart dhe këmbët i keni për vete", jep një mesazh më të qartë se: "Mos u zini!".
- Zgjidhni ato rregulla për të cilat shumica janë dakort apo të cilave u binden të gjithë në shkollë. Në rast se nxënësit mësojnë se nuk mund të sillen në klasën tuaj ashtu siç lejohen në një klasë tjetër, ata do t'i testojnë këto kufizime për të parë se "deri ku mund të tolerohet" sjellja e tyre jo e mirë.
- Mbi të gjitha, angazhoni nxënësit në hartimin e rregullave të klasës. Ju mund ta nisni me parimin se: "Ju mund të bëni ç'të doni në klasë, por pa ndërhyrë në të drejtat e të tjerëve, si shokët e shoqet e klasës dhe mësuesit!". Duke shfrytëzuar këtë metodë "të bazuar në respektimin e të drejtave", kërkoni nxënësve të identifikojnë se cilat sjellje janë të pranueshme dhe cilat jo, ngaqë ato shkelin të drejtat e të tjerëve. Hartoni rregulla, që i respektojnë këto të

drejta, si dhe masat për shkeljen e tyre. Mos harroni se këto masa duhet t'i ndihmojnë nxënësit të mësojnë dhe se duhet të jenë në përputhje me natyrën e sjelljen jo të mirë, që do të thotë se ato duhet të ndihmojnë si nxënësin, ashtu edhe klasën. Falënderojini nxënësit për hartimin e "kushtetutës së klasës" ose të "paketës së politikave të klasës", e cila mund t'u bëhet e ditur të gjithëve në klasë. Jepjuani ta nënshkruajnë atë, kështu që ata do të bien dakort t'i respektojnë rregullat dhe në rast se i shkelin, do t'u duhet të pranojnë pasojat. Sjellja jo e mirë ka më pak gjasa të ndodhë, kur një nxënës bën një premtim se nuk do t'i shkelë rregullat dhe se do të angazhohet të mbajë qëndrime më të mira.

- I rishqyrtoni herë pas here rregullat për të parë nëse disa prej tyre nuk janë më të nevojshme. Nëse ka të tilla, lëvdojini nxënësit dhe, më pas, pyetini nëse edhe rregullat e tjera kanë nevojë të mbahen.

Angazhimi i prindërve

Rregullat bëjnë më shumë efekt kur mësuesit, prindërit dhe nxënësit angazhohen njëllor në respektimin e tyre. Në disa shkolla, mes këtyre palëve bëhet një "marrëveshje" e tillë. Kjo "marrëveshje" është një kontratë thjesht formale, ku cilësohen qartë përgjegjësitë e secilës palë dhe nënshkruhet prej tyre. Teksti i një marrëveshjeje të tillë mund të ketë formën e mëposhtme.⁵⁷ Ai mund të diskutohet me prindërit në takimin e parë mësues - prindër apo prindër - mësues - fëmijë. A mund ta shfrytëzoni edhe ju atë si një mënyrë për të angazhuar nxënësit dhe prindërit e tyre në nxitjen e një sjelljeje të denjë në klasë?

Si prind / kujdestar unë do të:

- tregoj respekt dhe do t'i mbështes fëmijën tim, mësuesin dhe shkollën;
- përkrah politikën e disiplinës së shkollës dhe rregullat e klasës së fëmijës tim;

⁵⁷ Bota e arsimit. "Krijimi i një klime për mësimin: Teknika të drejtimit efektiv të orës së mësimin". http://www.education-world.com/a_curr/curr155.shtml [marrë në internet më 10/6/2005].

72 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

- siguroj një vend të qetë e të ndriçuar mirë për studim dhe do të ndjek kryerjen e detyrave të shtëpisë;
- marr pjesë në takimet formale dhe joformale prind - mësues ose prind - mësues - nxënës;
- bisedoj me fëmijën tim çdo ditë për aktivitetet e tij në shkollë. Do të monitoroj ndjekjen e televizorit nga fëmija ose aktivitetet e tjera që mund ta largojnë atë nga mësimet;
- ndihmoj të paktën në njërin prej aktiviteteve për çdo semester. Do të lexoj me fëmijën tim të paktën çdo ditë 10 minuta ose do t'i kërkoj të më lexojë diçka mua.

Si nxënës unë do të:

- përpiqem të jap maksimumin në mësimet;
- jem i sjellshëm dhe do t'i ndihmoj shokët e klasës;
- tregoj respekt për veten, mësuesin, shkollën time dhe të tjerët;
- bindem rregullave të klasës dhe shkollës;
- tregoj respekt për pronën, duke mos vjedhur apo kryer akte vandale;
- vij i përgatitur në shkollë me detyrat e shtëpisë dhe materialet e nevojshme;
- besoj se mundem dhe do të mësoj;
- shpenzoj të paktën 15 minuta çdo ditë duke studjuar ose lexuar në shtëpi;
- bisedoj me prindërit e mi çdo ditë për aktivitetet e shkollës.

Si mësues unë do të:

- tregoj respekt për çdo fëmijë dhe familjen e tij;
- do të shfrytëzoj me efektivitet orën e mësimit;

- siguroj një mjedis të sigurtë e të rehatshëm që nxit të mësuarit;
- ndihmoj çdo fëmijë të arrijë potencialin e tij të plotë;
- t'u jap detyra të përshtatshme për në shtëpi;
- t'u jap ndihmë prindërve që ata të mund t'i ndihmojnë fëmijët me detyrat;
- zbatoj vazhdimisht rregullat e klasës dhe shkollës me korrektësi;
- siguroj nxënësve dhe prindërve vlerësime të qarta mbi ecurinë në mësimet dhe rezultatet;
- shfrytëzoj aktivitete speciale në klasë për ta bërë të këndshme orën e mësimit;
- demonstroj sjellje profesionale dhe qëndrim pozitiv.

Tani ne do të punojmë së bashku për të zbatuar këtë kontratë.

Nënshkroi:

Prindi nënshkrimi/data

Nxënësi nënshkrimi/data

Mësuesi nënshkrimi/data

STANDARDE PËR SJELLJEN DHE DREJTIMIN E MIRË

Rregullat e klasës caktojnë standardet për nxënësit tanë, por edhe ne, mësuesit, duhet të kemi standarde. Mbi të gjitha, ne përfaqësojmë modele rolesh të rëndësishme për nxënësit tanë.

- Ne duhet t'u tregojmë nxënësve tanë se çfarë sjellje kërkojmë nga secili në klasë (nga nxënësit dhe vetvetja) dhe t'i diskutojmë këto kërkesa rregullisht.
- Ne duhet të informojmë administratorët e shkollës tonë, mësuesit e tjerë dhe prindërit rreth rregullave të klasës tonë, që ata të mund të na ndihmojnë t'i monitorojmë dhe të shmangim shkeljen tyre.
- Rregullat që zhvillojmë ne me nxënësit tanë duhet të zbatohen pa mëdyshje dhe paanësi.
- Ne gjithmonë duhet të jemi në dijeni se çfarë ndodh brenda dhe jashtë klasës tonë, dhe monitorimi ynë duhet të jetë i zgjuar dhe parandalues.
- Ne nuk mund të zemërohemi apo të humbim vetëkontrollin, por të jemi modele rolesh për sjellje të mirë dhe për zbatimin e rregullave nga nxënësit tanë.
- Kur disiplina është e nevojshme, ajo përqëndrohet te sjellja e nxënësit, jo te nxënësi. Dinjiteti i nxënësit ruhet.
- Ne kemi nevojë të inkurajojmë nxënësit për të monitoruar sjelljen e tyre, si, p.sh., duke mbajtur ditaret e aktiviteteve me të tjerët. Edhe ata kanë nevojë të monitorojnë sjelljen e njëri - tjetrit me respekt.
- Gjatë mësimdhënies, nuk duhet të përdorim terma të paqarta apo me dy kuptime. Aktivitetet duhet të vijojnë qartë njëri - tjetrin dhe me ndërprerje sa më të vogla.

Disa prej karakteristikave që nxënësit çmojnë te mësuesi e që duhet të formojnë pjesën thelbësore të monitorimit të sjelljeve tona, janë:⁵⁸

⁵⁸ Përshtatur nga: "Tipare të rëndësishme të mësuesve. Bashkëpunimi për rezultate të larta në edukimin e mësuesit" (CETP), Fondacioni Kombëtar i Shkencës. http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/cm-trait.html [marrë nga interneti më 11/28/2005].

Korrektësia: Nxënësit e shohin këtë si tiparin më të rëndësishëm të mësuesve. Kjo do të thotë të tregohesh korrekt në aktivitete, si dhënia e detyrave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, në dhënien e ndihmës, në zgjedhjen e nxënësve si ndihmës ose në pjesëmarrjen e aktiviteteve të veçanta.

Humori: Aftësia për t'iu përgjigjur nxënësve me shpengim.

Respekti: Që do të thotë të tregohet vlerësim për të drejtat dhe ndjenjat e nxënësit.

Mirësjellja: Kjo është një shenjë tjetër e respektit.

Çiltërsia: Nxënësi ka nevojë të shohë te mësuesi një person real. Mësuesi duhet të shpjegojë qartë ndjenjat e tij dhe rrethanat që i shkaktojnë ato.

Dëgjimi aktiv: Që do të thotë të reagosh kur nxënësi flet. Ju duhet të tregoni se e keni dëgjuar nxënësin dhe t'i jepni atij shansin për të korrigjuar keqkuptimin ose keqinterpretimin. Ju duhet të provoni të rideklaroni atë që sapo u tha ose të përdorni gjuhën e trupit për të treguar qëndrimin tuaj.

Se sa të zotë jemi ne t'u përmbahemi standardeve tona të sjelljes, kjo varet nga stili ynë i drejtimit të orës së mësimt në klasë.



Strategji veprimi: Profili i drejtimit të orës së mësimt⁵⁹

Stili juaj i drejtimit të orës së mësimt do të përcaktojë se si mund të ndërveproni me nxënësit tuaj, se sa mirë mund të ndërtoni raporte pozitive me ta dhe se sa shumë do të mësojnë ata nga ju. Ai mund të ndikojë edhe në mënyrën se si sillen fëmijët dhe se sa i disiplinoni ju nxënësit tuaj, d.m.th., nëse ju jeni më i prirur të përdorni më shumë disiplinën negative apo atë pozitive për të ndihmuar nxënësin tuaj të mësojë sjellje të mira. Për të përcaktuar stilin tuaj të drejtimit, lexoni me kujdes secilën nga deklaratimet e

⁵⁹ Zhvilluar mbi bazën e: "Mësuesi flet. Cili është profili juaj i drejtimit të orës së mësimt?" <http://education.indiana.edu/cas/tt/v1i2/what.html> [marrë nga interneti më 10/6/2005].

76 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

bëra në tabelën më poshtë. Më pas, përgjigjuni nëse bini dakort ose jo me deklarinimin apo, më mirë akoma, në rast se ajo është çfarë ju bëni aktualisht.

Karakteristika	E pranoj	S'e pranoj
1. Unë besoj se klasa duhet të jetë një vend i qetë, ku nxënësit të mund të mësojnë.		
2. Unë besoj se vendet e caktuara në një vendosje të strukturuar (si, p.sh., radhë) pakësojnë sjelljen e keqe dhe nxisin mësimin.		
3. Mua s'më pëlqen të më ndërpresin fjalën kur jam duke shpjeguar.		
4. Nxënësit duhet të mësojnë të ndjekin rregullat dhe të mos i diskutojnë ato.		
5. Nxënësit e mi rrallë bëhen iniciatorë aktiviteteve.		
6. Kur një nxënës sillet keq, unë e ndëshkoj ose e dispiinoj atë menjëherë, pa pranuar asnjë diskutim.		
7. Unë nuk pranoj justifikime për sjellje jo të mira, si ardhja me vonesë ose mosbërja e detyrave.		
8. Në varësi të asaj që unë shpjegoj, klasa ime mund të ketë radhitje të ndryshme bangash.		
9. Unë jam i shqetësuar si për atë që nxënësit mësojnë, por edhe si mësojnë.		
10. Nxënësit e mi e din se ata mund të ma ndërpresin shpjegimin, kur kanë pyetje të rëndësishme për të bërë.		
11. Unë lëvdoj dikë kur është e justifikuar dhe i inkurajoj nxënësit të mësojnë më mirë.		
12. Unë u jap nxënësve projekte, si ushtrime mësimore apo u kërkoj të zhvillojnë projektin e tyre. Më pas, ne diskutojmë se çfarë kemi mësuar dhe se çfarë kanë nevojë ata të mësojnë më shumë.		
13. Unë gjithnjë shpjegoj arsyet e rregullave që vë dhe vendimeve që marr.		
14. Kur një nxënës sillet jo mirë, unë i jap atij një qortim të butë, por të vendosur. Në rast se kërkohet disiplinë, unë vërej me kujdes rrethanat.		

Karakteristika	E pranoj	S'e pranoj
15. Unë besoj se nxënësit mësojnë më mirë kur "ata mund të bëjnë atë që dinë më mirë", d.m.th., të bëjnë atë që mendojnë se mund ta bëjnë mirë.		
16. Mirëqenia emocionale e nxënësve të mi është më e rëndësishme sesa kontrolli i orës së mësimit. Është i rëndësishëm që nxënësit e mi të më konsiderojnë si mik.		
17. Disa prej nxënësve të mi janë të motivuar në mësim, kurse të tjerë duket se nuk interesohen.		
18. Unë nuk planifikoj që më parë se çfarë më duhet të bëj për të disiplinuar një fëmijë. Unë merrem me problemin, kur ai ndodh.		
19. Unë nuk dua të monitoroj ose të qortoj një nxënës, sepse kjo mund t'i lëndonte ndjenjat.		
20. Nëse një nxënës më ndërpret mësimin, unë tregoj më shumë kujdes ndaj tij, sepse ai duhet të ketë patjetër diçka të rëndësishme për të shtuar.		
21. Nëse një nxënës kërkon të largohet nga klasa, unë gjithnjë e respektoj dëshirën e tij.		
22. Unë nuk dua t'i imponoj asnjë rregull nxënësve të mi.		
23. Unë shfrytëzoj të njëjtin plan mësimor dhe aktivitete nga viti në vit, kështu që nuk më duhet të përgatitem paraprakisht për orët e mia të mësimit.		
24. Udhëtimet në terren dhe projekte speciale nuk realizohen dot. Unë nuk kam kohë për t'u përgatitur për to.		
25. Në vend që të jap një leksion, unë mund të tregoj një film ose një diapozitiv.		
26. Nxënësit e mi janë të prirur të hapin sytë rreth e rrotull klasës apo jashtë dritares		
27. Në qoftë se mësimi mbaron herët, nxënësit e mi mund të studiojnë me qetësi apo të flasin me zë të ulët.		
28. Unë rrallë i dispiinoj nxënësit e mi. Në rast se një student m'i sjell detyrat me vonesë, ky nuk është problemi im.		

Më pas, mblihdni numrin e deklarimeve "e pranoj" nga 1-shi te 7-ta, vazhdoni nga 8-ta te 14-ta, më pas nga 15-ta te 21-shi dhe, në fund, nga 22-shi te 28-ta. Në cilin grup deklarimesh keni numrin më të madh të përgjigjeve "e pranoj"? Ky është stili juaj i drejtimit të orës së mësimi dhe mos u habitni në qoftë se karakteristikat tuaja përkojnë me ato të një stili tjetër.

Në tabelën e mësipërme, deklaratimet nga 1-shi deri te 7-ta reflektojnë një stil **autoritar**: "Unë jam mësuesi dhe gjërat do të bëhen si them unë!". Ky stil është i mirë për të organizuar një klasë të strukturuar mirë, por nuk nxit sa duhet motivimin për rezultate të mira apo inkurajimin e objektivave personale. Nxënësit në këtë klasë ngurojnë të bëhen iniciatorë të një aktivitetit, ngaqë e ndjejnë veten të pafuqishëm.⁶⁰ Ata duhet t'i binden mësuesit në dëm të lirisë së tyre personale.

Deklarimet nga 8-ta deri 14-ta janë në një stil që **nxit autoritetin**: "Le të punojmë së bashku.". Ndonëse mbi sjelljen e nxënësit janë vendosur kufij, rregullat shpjegohen dhe nxënësit lejohen të jenë të pavarur brenda këtyre limiteve. Një mësues autoritativ inkurajon vetëbesimin dhe sjelljen shoqërisht kompetente. Përveç kësaj, ai i inkurajon nxënësit të jenë të motivuar dhe të kenë rezultate sa më të mira. Shpesh, ai i udhëheq ata përmes një projekti dhe jo vetë.⁶¹

Deklarimet nga 15-ta deri 21-shi zbulojnë një stil **mosndërhyrjeje**: "Si të thoni ju.". Mësuesi mosndërhyrës u bën pak pyetje nxënësve ose i kontrollojnë pak ata. Ky mësues pranon impulset dhe veprimet e nxënësit, dhe nuk e monitoron nga afër sjelljen e tij. Ai përpiqet të mos lëndojë ndjenjat e nxënësit dhe e ka të vështirë t'i thotë atij jo ose ta detyrojë të respektojë rregullat. Megjithatë ky tip mësuesi mund të jetë popullor me nxënësit, qëndrimi i tij tejet tolerant shoqërohet me mungesën e nxënësit të kompetencave shoqërore dhe të vetëkontrollit. Është e vështirë që nxënësit të mësojnë sjellje shoqërisht të pranueshme, kur mësuesi është kaq dorëlëshuar. Me pak pyetje që u bëhen, këtyre nxënësve shpesh u mungon motivimi për të bërë më shumë.⁶²

Në fund, deklaratimet nga 22-shi deri te 28-ta zbulojnë një stil **indiferent**: "Bëj ç'të duash!". Mësuesi indiferent nuk është shumë i impenjuar në klasë.

⁶⁰ <http://education.indiana.edu/cas/tt/v1i2/authoritarian.html>.

⁶¹ <http://education.indiana.edu/cas/tt/v1i2/authoritative.html>.

⁶² <http://education.indiana.edu/cas/tt/v1i2/laissez.html>.

Ky mësues u bën pak ose aspak pyetje nxënësve dhe shpesh duket i painteresuar. Mësuesi indiferent thjesht nuk do t'u imponohet nxënësve. Kështu, ai shpesh mendon se për përgatitjen e orës së mësimit nuk ia vlen të lodhesh. Edhe disiplina në klasë çalon. Në një mjedis të tillë të ftohtë, nxënësit kanë shumë pak shanse për të vëzhguar apo praktikuar shprehje komunikimi. Me pak pyetje që bëhen dhe disiplinë të dobët, nxënësit kanë një motivim të ulët për mësim dhe mungesë vetëkontrolli.⁶³

Në rast se nuk jeni të sigurtë se cili nga të katër stilet e drejtimit të orës së mësimit është më afër atij tuajit, pyesni një koleg, një ndihmësin tuaj apo një nxënës të rritur që t'ju vëzhgojë për një a dy ditë. Më pas, kërkojini të lexojë listën me karakteristika dhe stilet e drejtimit, që t'ju ndihmojë të përcaktoni se cila prej tyre u përgjigjet juve. A ndikon ky stil në motivimin e nxënësve për të mësuar? A ndikon në sjelljen e tyre? A ndikon në mënyrën se si i disiplinoni nxënësit dhe se si reagojnë ata ndaj jush? Mendoni se ka vend për përmirësim? Provoni të ndryshoni stilin tuaj ose njëriën nga karakteristikat e mësipërme dhe shikoni nëse nxënësit tuaj motivohen më shumë dhe ju i mësoni më lehtë. Mbani një ditar për ndryshimet që bëni dhe ndryshimet e klasës, nëse nxënësit bëhen më të dëgjueshëm, shfaqin sjellje të mira dhe aftësi ndërpersonale.

DHËNIA E KURAJËS POZITIVE

Disiplina pozitive është mënyra më e mirë për të shmangur sjelljet jo të mira nëpërmjet sjelljeve pozitive shpërblyese. Ajo bazohet në premisën se sjellja që shpërblehet është sjellje që përsëritet. Ana më kritike e disiplinës pozitive lidhet me ndihmën që u jepet nxënësve për të mësuar sjellje që përmbushin shpresat tona (të të rriturve) dhe i ndihmon ata të zhvillojnë ndjenjën e vetëdisiplinimit, që çon drejt vlerësimit pozitiv të vetvetes. Sjelljet që ju i çmoni dhe që doni t'i kultivoni, mund të njihen nga nxënësit tuaj dhe juve ju duhet të bëni përpjekje të përbashkëta për t'i mësuar dhe për t'i ngulitur ato. Disa prej strategjive që mund të shfrytëzoni për t'i ndihmuar nxënësit tuaj të mësojnë sjellje pozitive janë:

Foluni pozitivisht - "Pa shikoni sa shumë përgjigje të mira keni dhënë! Përpiqueni të gjeni më shumë herën tjetër."

⁶³ <http://education.indiana.edu/cas/tt/v1i2/indifferent.html>.

Dëgjojini me vëmendje dhe ndihmójini të mësojnë të përdorin fjalët për të shprehur ndjenjat e tyre dhe jo veprime destruktive.

Jepuni nxënësve tuaj mundësinë e alternativave dhe ndihmójini të mësojnë të vlerësojnë pasojat potenciale të zgjedhjeve që bëjnë.

Inkurajoni sjellje të pëlqyeshme duke i lëvduar shpesh e duke mos u përmendur gabimet e vogla.

Modeloni siç duhet normat e njohura të sjelljes, të komunikuarit me respekt dhe strategji bashkëpunimi për zgjidhjen e konflikteve (një temë që do të diskutohet më poshtë).

Përdorni një gjuhë trupore të kuptueshme - miratoni me kokë, buzëqeshni dhe shikojeni në sy nxënësin.

Uleni pozicionin e trupit - veçanërisht për fëmijët më të vegjël, përkuluni, përthyeri gjunjët ose uluni në nivelin e tyre.

Ristrukturoni mjedisin - hiqni objekte që nxisin sjellje të keqe, p.sh., nëse lojrat apo lodrat që i përdorni në ndihmë të mësimin, largojini sapo të keni mbaruar.

Riformulojeni sjelljen tuaj pozitivisht - një nxënës hedh një top futbollin në klasë. "Ti mund ta hedhësh topin kur të jesh jashtë, në fushën e lojës, ku ka më shumë vend."

Duke i përmbledhur sa thamë, shpresojmë se ju keni mësuar mjaft nga ky seksion dhe keni vendosur të provoni në klasën tuaj disa nga gjërat e reja. Ne kemi mësuar se një klasë e drejtuar mirë, që krijon dhe nxit sjellje pozitive, është ajo:

1. Ku ju dini se ç'kërkoni dhe çfarë jo.
2. Ju u tregoni nxënësve atë që dëshëroni.
3. Kur ju e arrini atë që doni, i përgëzoni.
4. Kur ju arrini diçka tjetër, veproni shpejt, siç duhet dhe pozitivisht.

Gjatë punës, ju keni nevojë të siguroheni se:

1. Kërkesat tuaja janë të qarta.
2. Udhëzimet janë interesante për nxënësit.
3. Nxënësit tuaj shohin një synim dhe vlerë tek ajo që u mësohet.
4. Udhëzimet lidhen me koncepte dhe shprehje të përvojave të nxënësit dhe kanë kuptim në jetën e tij të përditshme.
5. Strategjitë tuaja janë të larmishme. Nxënësit mund të mërziten, edhe kur tema është interesante, në rast se përdorni të njëjtat metoda mësimdhënieje.

Disa nga rrugët e rëndësishme se si të filloni të krijoni një mjedis që nxit zhvillimin e sjelljeve pozitive te nxënësit, përfshijnë sa më poshtë:⁶⁴

1. Kërkoni dhe komunikoni kërkesa të larta nga nxënësit dhe vetja juaj për sjelljen.
2. Vendosni rregulla dhe procedura të qarta, i udhëzoni nxënësit se si t'i zbatojnë ato, jepuni fëmijëve, sidomos atyre të klasës së parë, mjaft udhëzime, bëjuni praktikë dhe përsëritje.
3. Ua bëni të qarta nxënësve pasojat që rrjedhin nga sjellja jo e mirë.
4. Që ditën e parë të shkollës kërkoni pa hezitim, vazhdimisht dhe njëloj për të gjithë respektimin e rregullave në klasë.
5. Punoni për të kultivuar te nxënësit vetëdisiplinimin, kushtojuni kohë për t'u mësuar atyre shprehitë e vetëkontrollit.
6. Mbani një ritëm të gjallë mësimi dhe bëni kalime të buta nga një aktivitet në tjetrin.

⁶⁴ Kotton, Katherine. "Disiplina në shkollë dhe në klasë". Seria e studimeve mbi përmirësimet në shkollë. Vështrim nga afër #9. <http://www.nwrel.org/scpd/sirs/5/cu9.html> [accessed online on 10/6/2005].

82 Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse

7. Monitoroni aktivitetet e klasës, bëjuni nxënësve komente dhe inkurajoni për sjelljen e tyre.
8. Jepuni nxënësve shanse që gjatë mëimit të shijojnë suksesin dhe sjelljen shoqërore.
9. Identifikoni nxënësit që kanë një vlerësim të ulët për veten dhe punoni për t'i ndihmuar të kenë arritje më të larta dhe të fitojnë besimin në vetvete.
10. Shfrytëzoni me masë grupet bashkëpunuese në mësim.
11. Shfrytëzoni humorin sa herë që është e mundur, për t'u stimuluar nxënësve interesin apo për t'u ulur tensionin.
12. Largoni materialet që pengojnë shikimin, kur mësimi është në proces.
13. Krijoni një mjedis të këndshëm, tërheqës dhe mikpritës për nxënësit, prindërit e tyre dhe ju vetë në klasë.



Impenjimi me nxënësit problematikë

Çfarë do të mësoni:

- Si të përmirësojmë efektivitetin e teknikave të disiplinës pozitive.
- Sugjerime për një disiplinë pozitive.
- Sugjerime për një mësimdhënie pozitive në klasë.
- Dhënia e masave të duhura, pozitive dhe negative.
- Përdorni kujdes në përdorimin e "veçimit" të fëmijës.
- Zgjidhja e konflikteve.
- Teknika të disiplinës pozitive në përputhje me moshën.
- Ndhima ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta.

PËRMIRËSIMI I EFEKTIVITETIT TË TEKNIKAVE TË DISIPLINËS POZITIVE

Në rast se një nxënës sillet keq, nevojiten teknika pozitive për të pakësuar apo eliminuar shfaqjet e sjelljeve jo të mira. Siç kemi mësuar, sjelljet e këqia janë ato sjellje të padëshirueshme, që e vënë fëmijën apo të tjerët në rrezik, që nuk përputhen me kërkesat e rregullave në klasë, që ndikojnë keq në ndërveprimin pozitiv shoqëror dhe në vetëdisiplinimin e nxënësit. Në këtë seksion përfundimtar, do të flasim më shumë se si mund të përdoren teknikat e veçanta për të pakësuar shfaqjet e sjelljeve jo të mira apo dhe për t'i eliminuar ato. Çfarëdo teknike që të përdoret, efektiviteti i tij mund të rritet.⁶⁵

- kur si ju dhe nxënësi e kuptoni qartë se ku qëndron problemi i sjelljes dhe se cilat janë pasojat që nxënësi duhet të presë kur shfaqet kjo sjellje;

⁶⁵ Akademia Amerikane e Pediatrisë. "Udhëzime për një disiplinë efektive". <http://aappolicy.aappublications.org/cgi/content/full/pediatrics;101/4/723> [marrë në internet më 12/2/2005].

- kur ju reagoni duke dhënë si fillim një masë ndëshkuese të menjëhershme, sapo shfaqet për herë të parë një sjellje jo e mirë (në rast se thuhet një rregull, merrni masë, mos prisni);
- kur ju jepni sistematikisht masën e duhur, çdoherë që ndodh një sjellje problematike;
- kur ju jepni udhëzime dhe korrigjoni me qetësi dhe ngrohtësi; dhe
- kur ju shpjegoni arsyet për masën e dhënë për një sjellje të caktuar, që e ndihmon nxënësin të mësojë se si të sillet dhe të përmirësojë zbatimin kudo të kërkesave të të rriturve.

SUGJERIME PËR NJË DISIPLINË POZITIVE

Aktualisht jo gjithmonë lind nevoja për rritjen e kërkesave të disiplinës. Shpesh disiplina e mirë nënkupton shmangien e situatave problematike apo zgjidhjen e tyre, para se ato të dalin jashtë kontrollit. Por si? Këtu po japim dhjetë sugjerime të vlefshme. Disa prej tyre janë të reja, kurse të tjerat janë përmendur më parë, por le t'i shohim më në detaje.^{66, 67}

1. ***Sigurohuni të mos bini në keqkuptim.*** Në të vërtetë, siç u diskutua më sipër, sjelljet jo të mira ndodhin kur një nxënës **vendos** vetë të **mos sillet mirë**. Përpara se të ndërmerri ndonjë veprim, bëjini vetes këto pyetje:

- A. A po bën vërtet nxënësi diçka gabim? A ekziston një problem real apo thjesht jeni lodhur dhe ju ka humbur durimi?
 - Në rast se nuk ekziston ndonjë problem real, shkarkojeni stresin tuaj mbi nxënësin dhe klasën.
 - Në rast se ka ndonjë problem, kaloni te pyetja e dytë.

⁶⁶ "Disiplina pozitive dhe edukimi i fëmijës". <http://www.kidsgrowth.com/resources/articledetail.cfm?id=1211> [marrë në internet më 10/12/2005].

⁶⁷ Përshtatur nga: Kelley, Laureen. "Dilema mbi disiplinën". Posta e letrave të prindërve. Tetor 1995. <http://www.kelleycom.com/articles/discipline.htm> [marrë nga interneti më 9/29/2005].

B. Mendoni për një çast. A është vërtet i aftë nxënësi të veprojë sipas kërkesave tuaja?

- Në rast se jo, rivlerësoni kërkesat tuaja.
- Në rast se kërkesat tuaja janë të drejta, atëherë kaloni në pyetjen tjetër.

C. A ishte i ndërgjegjshëm nxënësi në atë çast se po vepronte gabim?

- Në rast se nxënësi nuk po e kuptonte se po bënte një gabim, ndihmoheni ta kuptojë kërkesën tuaj, përse dhe se si mund ta përmbushë atë. I ofroni ndihmë.
- Në rast se nxënësi juaj e dinte se po bënte gabim dhe e injoroi me qëllim kërkesën tuaj të arsyeshme, atëherë ai është sjellë jo mirë.

Në rast se sjellja e tij jo e mirë ishte një aksident, ajo nuk përbën një sjellje jo të keqe. Në rast se sjellja jo e mirë nuk ishte një aksident, pyeteni nxënësin se cilat ishin arsyet e një veprimi të tillë. Dëgjoheni me kujdes dhe bëni vlerësimin tuaj para se të përgjigjeni.

2. **Vereni theksin mbi anët pozitive.** Sa herë që një nxënës bën diçka të dobishme, me kujdes dhe në bashkëpunim me të tjerët, apo tregon shenja përmirësimi, ia vini në dukje dhe përgëzojeni me fjalë. Për shembull: "Arben, më ka bërë përshtypje rruga e zgjidhjes së problemit nga ju."

Edhe në ndonjë incident, mos gjeni vetëm fajin; identifikoni se çfarë ishte bërë mirë e çfarë jo. Për shembull: "Artan, u treguat shumë i sjellshëm që i lëshuat vendin shokut tuaj. Ti qëndrosh besnik një shoku ka rëndësi. Megjithatë, unë s'mund të lejoj të rrahësh të tjerët. S'kishe mënyrë tjetër për ta zgjidhur problemin?".

3. **Silluni me respekt me nxënësit.** Trajtojini ata ashtu siç do të donit t'ju trajtojnë. Ndihmoheni të ecin përpara. Jini udhëheqës dhe jo bos. Jini ai model mësuesi, që ju e mbani mend me dashuri nga ditët e shkollës.

4. ***U komunikoni kërkesat*** që keni nxënësve tuaj në mënyrë të qartë dhe me respekt. U kujtoni shpesh kërkesat tuaja, përpara se të ndodhë diçka dhe pasi të ndodhë ajo. Për shembull, në fillim të vitit u thoni nxënësve: "Kur të mbarojë ora e mësimit sot dhe çdo ditë tjetër, unë dua që ju të qëndroni pa lëvizur nga vendi, derisa t'i thërras emrin secilit. Në këtë mënyrë, gjithkush mund të dalë i sigurtë nga klasa, pa u përplasur me tjetrin dhe unë i mësoj emrat dhe fytyrat tuaja më shpejt." Ua kujtoni këtë çdo ditë nxënësve tuaj, derisa largimi me rregull të bëhet pjesë e rutinës së klasës tuaj.

5. ***Bëni humor ose largoni vëmendjen.*** Jo çdo sjellje jo e mirë e bërë nga një nxënës ka nevojë të disiplinohet. Fëmijët, njëlloj si të rriturit, lodhen, zhgënjehen ose mërzhiten. Disiplinimi mund të mos funksionojë në situata të tilla. Provoni të bëni pak humor gjatë mësimit, për t'i tërhequr të gjithë në mësim, që të mos mërzhiten. Për shembull, gjatë lëndës së shkencave, pyetini nxënësit tuaj të zgjidhin një gjëagjzë për të bërë hyrjen në mësim. Gjëagjzë mund të jetë: "Çfarë e fillon jetën me katër, e jeton jetën me dy dhe e mbaron jetën me tre?". Përgjigja: "Një njeri, një fëmijë ecën këmbadorazi, pastaj mëson të ecë me dy këmbë dhe kur plaket, disa njerëz përdorin shkopin, ata kanë tre këmbë!" Kjo gjëagjzë mund të ishte një mënyrë interesante për të filluar temën se si zhvillohet trupi i njeriut apo për të folur për plakjen. Fëmijëve parashkollorë duke u thënë: "Pa shihni fluturën!", mund t'u tërhiqet vëmendja nga zhurmat, raketaket, nga zemërimet dhe me ta mund të zhvillohen aktivitete të dobishme, që ndihmojnë zhvillimin e tyre, si vizatimi i një fluturë. Vini në punë imagjinatën!

6. ***Shfrytëzoni bashkëpunimin proaktiv.*** Jepuni një detyrë që e dini se u pëlqen, para se t'u jepni detyra që ata mund të ngurojnë t'i bëjnë. Futini më parë në një atmosferë bashkëpunimi. Për shembull, u thoni: "Secili të vizatojë një "I" të madhe të shtypit në ajër.", "Oh, sa bukur, Maria!", "Secili të ngrerë gishtin tregues. Tani futeni mes librit, aty ku ju mendoni se është faqja 108." Më pas, u thoni ta hapin librin te faqja 108 dhe të shkruajnë përgjigjet e gjashtë pyetjeve që jepen në atë faqe.⁶⁸

⁶⁸ "Të tregoni respekt dhe t'ju respektojnë". http://maxweber.hunter.cuny.edu/pub/eres/EDSPC715_MCINTYRE/respect_web_page_insert.html [marrë nga interneti më 10/10/2005].

7. ***U ofroni opsione ose alternativa të kufizuara dhe inkurajoni vendimmarrjen në grup.*** Shumica e nxënësve e kanë inat t'i komandojë dikush, prandaj, duke u ofruar alternativa i ndihmoni të ndjejnë se kanë njëfarë kontrolli, por jo shumë. Kur afrohet dita e provimit, ju mund t'u thoni: "Të martën kemi kontroll në lexim. Kush do të bëjë provim me shkrim dhe kush me gojë? Ju mund të zgjidhni cilën të doni.". Kjo do t'u japë fëmijëve një ndjenjë kontrolli mbi situatën. Në rast se ju doni t'i merrni vetëm në një lloj testi, u kërkoni të diskutojnë se cilat janë përparësitë dhe mangësitë e dy llojeve të provimit dhe, më pas, kaloni në votimin e asaj që ata pëlqejnë më shumë. Shumica fiton. Në rast se ka nxënës që mërzhiten sepse nuk fituan, p.sh., ata deshën një provim me shkrim, jepuni edhe atyre disa pyetje shtesë me shkrim.
8. ***Merrni masa ndëshkimore, por të sigurta.*** Në rast se një fëmijë i përsërit ardhjet me vonesë në klasë, mos u mërzhitni. Është përgjegjësia e fëmijës të vijë në klasë në orar. Thuajini se në rast se vazhdon të vijë me vonesë, ju do t'i dërgoni një letër prindërve në shtëpi. Po qe se vazhdon përsëri të vijë vonë, dërgojuni prindërve një letër dhe lëreni atë të përballet me pasojat. Ai kështu mëson se është përgjegjës për sjelljen dhe se do të ketë pasoja.
9. ***Mos e merrni mosbindjen e një nxënësi personalisht.*** Fëmijët kanë nevojë ta shprehin mosbindjen e tyre, ata kanë nevojë të testojnë kufijtë që u vihen si pjesë e zhvillimit të tyre. Mos e shihni këtë si një kërcënim të autoritetit tuaj. Reagoni me qetësi, zbatoni disiplinën që nxit vetëkontrollin. A ju kujtohet rasti i Ramonit në hyrje të këtij seksioni? Në fillim, mësuesja e mori sjelljen e tij jo të mirë sikur drejtohej kundër saj dhe kjo e mërzhiti. Por kur filloi të mos e shihte sjelljen e tij si diçka personale dhe e kuptoi se kur dhe përse ai sillej keq, ajo mundi të zhvillojë strategji efektive për t'u marrë me të, duke arritur rezultate pozitive.
10. ***Përgëzojini për përpjekjet, jo për korrektesën.*** Në rast se një nxënës jep maksimumin e tij, ju duhet të jeni i lumtur. Përpjekja është hapi i parë i të mësuarit. Në rast se një nxënës nuk do të bëjë përpjekje për një detyrë të vështirë, flitini për rastet kur ai me përpjekjet e tij ka arritur sukses. Inkurajojeni që ta tregojë veten dhe njëherë. I kujtoni se për sa kohë që ai përpiqet, ju jeni i kënaqur. Lërinini të kuptojnë se ju keni besim në aftësitë e tyre.

SUGJERIME PËR MËSIMDHËNIEN POZITIVE NË KLASË

Disiplina pozitive ka nevojë të mbështetet nga mësimdhënia pozitive. Ekzistojnë shumë mënyra të tjera pozitive me të cilat mund të parandaloni sjelljen e keqe gjatë dhënies së mësimi apo, së paku, që ta trajtoni atë me efektivitet dhe pa e ndërprerë orën e mësimi. Më poshtë do të gjeni disa sugjerime.⁶⁹ A mund të mendoni ju ndonjë tjetër?

1. **Përqëndrimi dhe toni i butë.** Sigurohuni që po ju ndjekin të gjithë, para se të fillojë mësimi. Prisni derisa e gjithë klasa të qetësohet. Mësuesit me përvojë e dinë se qetësia është shumë efektive. Ata i japin rëndësi asaj, duke qëndruar edhe 3 deri në 5 sekonda, pasi klasa të ketë pushuar zhurmën. Nxënësit e kuptojnë menjëherë se sa më shumë të presë mësuesi për qetësi, aq më shumë pak kohë të lirë do të kenë ata në fund të orës. Pas kohës së pritjes, filloni mësimin tuaj duke përdorur një ton më të qetë se normalisht. Një mësues me zë me ton të butë shpesh ka një klasë më të qetë sesa një tjetër me zë të fortë. Nxënësit e tij rrinë urtë, që ta dëgjojnë se ç'thotë.
2. **Udhëzime direkte.** Pasiguria rrit nivelin e gjallërimit të klasës. E filloni çdo orë mësimi duke u treguar nxënësve tamam atë që do të ndodhë. Nënvizoni se çfarë do të bëni ju dhe nxënësit tuaj. Ju mund të vini limite kohore për secilën detyrë. Mund të kombinoni udhëzimet e drejtpërdrejta me mësimin, duke u lënë kohë nxënësve, në fund, që të zhvillojnë aktivitetet sipas dëshirës. Ju mund ta përfundoni përshkrimin e aktiviteteve në klasë me: "Unë mendoj se do të kemi pak kohë në fund që ju të bisedoni me njëri - tjetrin, të shkoni në bibliotekë apo të përgatiteni për orët e tjera."
3. **Monitorimi.** Qarkulloni, ngrihuni dhe shëtisni në dhomë, veçanërisht kur nxënësit bëjnë ushtrime me shkrim ose punojnë në grup. Kontrolloni punën që bëjnë. Mos i ndërpritni apo t'u thoni gjëra të përgjithshme, veçse kur shihni se një numër nxënësish kanë vështirësi me të njëjtën gjë. Flisni me zë të ulët dhe nxënësit do ta çmojnë vëmendjen tuaj personale dhe pozitive.

⁶⁹ Marrë nga: "Disiplina e planifikuar. 11 Teknika për një disiplinë më të mirë në mësim." <http://www.honorlevel.com/techniques.xml> [accessed online on 10/4/2005].

4. **Tërheqja e vëmendjes pa fjalë.** Në disa klasa, mësuesit kanë një zile të vogël në tavolinë. Kur i bien asaj, edhe lehtë, tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Të tjerë mësues kanë gjetur mënyra nga më origjinalet për të tërhequr pa zë vëmendjen në klasë. Disa ndezin dhe fikin dritat. Disa mbajnë mjete që kërcasin në xhep. Të tjerë trokasin mbi dërrasën e zezë me shkurtesë apo kalem. Tërheqja e vëmendjes pa fjalë mund të shprehet dhe nëpërmjet fytyrës, lëvizjeve të trupit apo shenjave me dorë. Duhet bërë kujdes, kur përzgjidhet një teknikë e tillë në klasë. Gjeneroni kohë dhe shpjegojuni nxënësve se çfarë kërkoni të bëjnë ata, kur përdorni teknikat tuaja pa fjalë.
5. **Njohja reciproke.** Ashtu siç do të dëshironit të mësonit për nxënësit tuaj, edhe të rinjtë duan t'ju njohin ju, interesat tuaja. Përgatitni një bisedë personale me klasën tuaj. Një përshkrim i familjes tuaj apo disa tema mbi hobet tuaja, ose ndonjë album në tavolinën tuaj do të ngacmonte biseda me karakter personal me nxënësit. Sa më mirë t'ju njohin, aq më pak probleme do të keni me sjelljen e tyre.
6. **Ndërhyrje me profil të ulët.** Një mësues rezultativ bën kujdes që nxënësi të mos shpërblehet për sjellje të këqia, duke u kthyer në qendër të vëmendjes. Mësuesi e monitoron aktivitetin e klasës, duke lëvizur nëpër dhomë e duke u dalë përpara problemeve që mund të ndodhin. Afrimi me një nxënës që sillet keq, duhet të jetë i padukshëm. Të tjerët në klasë nuk shpëputen nga mësimi. Për shembull, gjatë dhënies së mësimin, një mësues përdor me efekt përmendjen e emrit të nxënësit gjatë shpjegimit të tij në mënyrë të natyrshme. "Dhe ju, Çai, e shihni se si ne e marrim këtë nga kolona e parë dhe e kalojmë në të dhjetën." Çaji dëgjon emrin e tij dhe e kthen mendjen në mësim. Pjesa tjetër e klasës zor se e vë re këtë gjë.

MARRJA E MASAVE TË DUHURA, POZITIVE DHE NEGATIVE

Një aspekt i rëndësishëm i mësimi është përvoja e pasojave që rrjedhin nga veprimet tona. Në qoftë se këto pasoja janë të mira, ne do ta përsërisim sjelljen tonë. Në qoftë se pasojat janë të këqia, nuk ka shumë gjasa që ta përsërisim sjelljen tonë.

Shumë herë ne vendosim rregulla, vendosim automatikisht se çfarë masash disiplinore duhet të ndërmarrim kur shkelen rregullat. Nxënësit që shkelin rregullat, duhet të mbartin gjithmonë pasoja negative. Por aktualisht, duhet të ketë dhe pasoja pozitive apo shpërblime, në rastet kur nxënësit u binden rregullave, qoftë edhe për nxënësit e rritur. Më poshtë do të gjeni disa nga shembujt e pasojave pozitive dhe negative. Këto sugjerime zbatohen për mosha të ndryshme. Disa mund të jenë më të mira se disa të tjera për një grup moshe të caktuar. Pasojat që jepen më poshtë nuk janë renditur sipas ndonjë radhe prioriteti. **Për të gjitha masat që merren, ato më parë duhen diskutuar dhe për to duhet rënë dakort me nxënësit tuaj**, ato duhen miratuar dhe nga drejtori i shkollës. Bashkëpunoni me kolegët tuaj, nxënësit dhe prindërit për të vendosur si mbi masat negative, ashtu dhe stimulimet pozitive.⁷⁰

Pasojat pozitive. Në klasë, stimulimet pozitive përqëndrohen te dhënia e kënaqësisë nxënësit dhe te krijimi tek ai i ndjenjës së besimit dhe vetëvlerësimit. Nxënësit kanë nevojë t'i njohin rregullat dhe të vlerësohen për zbatimin e tyre, si dhe për sukseset dhe arritjet në mësim. Ekzistojnë shumë mënyra të thjeshta për të lëvdur një nxënës, siç është rënia lehtë me dorë në sup, një "Unë krenohem me ju", caktimi si "ndihmësmësues" një ditë, si përzgjedhësi i një aktiviteti apo projekti për grupin, lëvdimi i nxënësit para mësuesve të tjerë apo drejtorit të shkollës, apo ngarkimi me detyrën për të ndihmuar të tjerët. A mund të mendoni ju disa mënyra të tjera që mund të funksionojnë në klasën tuaj?

Pasojat negative. Monitoroni veten dhe nxënësit tuaj. Përdorimi i shpeshtë i masave negative reflekton drejtimin e dobët të klasës dhe duhet shmangur. Monitoroni nxënësit tuaj me kujdes dhe shpesh, që të kapni në kohë sjelljet jo të mira, para se ato të trashen dhe të përfshijnë dhe nxënës

⁷⁰ Përshtatur nga: "Pasojat. Bashkëpunim për rezultate të larta në përgatitjen e mësuesit" (CETP), Fondacioni Kombëtar i Shkencës. http://www.temple.edu/CETP/temple_teach/CM-conse.html#anchor40660 [marrë nga interneti më 11/28/2005].

të tjerë. Për të ndaluar shfaqjen e sjelljeve jo të mira, pa e ndërprerë orën e mësimit apo pa u tërhequr shumë vëmendjen të tjerëve mbi nxënësin, provoni: (a) të afroheni pranë nxënësit apo nxënësve që shkelin rregullin, krijoni kontakt me sy dhe jepuni pa fjalë një shenjë që të ndalojnë veprimin e keq; (b) thirrreni nxënësin në emër dhe jepini një udhëzim të shkurtër me fjalë për të ndaluar veprimin jo të mirë, dhe (c) orientojeni nxënësin të veprojë mirë, duke i thënë se ç'duhet të bëjë (mos jepni komandë "mos"), duke i kujtuar rregullin që ai duhet të zbatojë.

Por me gjithë përpjekjet tona të mëdha, ndonjëherë është e nevojshme ta disiplinojmë nxënësin. Bëni kujdes që çfarëdo veprimi që të ndërmerrni, ai të përqëndrohet te sjellja e nxënësit dhe jo te nxënësi; masa disiplinore është pasojë e sjelljes së keqe dhe s'duhet dhënë kurrë në zemërim apo nxitim e sipër. Në varësi të natyrës së sjelljes, në listën e mëposhtme mund të gjeni disa metoda të buta disiplinore. A mund të mendoni masa të tjera që mund t'i përshtateshin më mirë klasës dhe nxënësve tuaj? Bëni kujdes që të mos zgjidhni një masë ndëshkuese, e cila e poshtëron publikisht nxënësin!

- Humbjen e pushimit të vogël ose kohën e lojës me të tjerët.
- Mbjajtjen në klasë pas përfundimit të shkollës për të diskutuar për sjelljen jo të mirë, përse u bë dhe ç'duhej bërë për ta korrigjuar atë.
- Rregullimin e rrëmujës së krijuar.
- Kërkesë faljeje nxënësit të fyer.
- Ndryshimin e bangës.
- I kërkohet nxënësit të përsërisë me gojë rregullat dhe t'i zbatojë ato.
- U dërgohet letër prindërve në shtëpi.
- Nxënësi nxirret jashtë klase dhe çohet në drejtori, sidomos në raste serioze, prishje të orës së mësimit, si grindje, ndërprerje e vazhdueshme e mësimit, vjedhje, ngacmime, pasje droge ose substancash të tjera të ndaluara dhe mbajtje armësh.

PËRDORNI ME KUJDES "VEÇIMIN"

Një nga metodat më popullore dhe më të kundërshtuara njihet me emrin "veçimi". Gjatë veçimit, nxënësi duhet të rrijë në një vend, të mos luajë e të mos flasë me njeri. I vetmi argëtim është të shohë orën, derisa të kalojnë sekondat e çdo minute.

Veçimi nuk duhet të jetë masa e parë, por masa e fundit ndaj një nxënësi që i bën keq një tjetri apo vetes. Kur përdoret me masë dhe për një kohë të shkurtër, veçimi mund t'i japë nxënësit mundësinë të qetësohet dhe të rifitojë vetëkontrollin, pas një situatë të vështirë. Kur përdoret shpesh ose pa vend, veçimi mund të mos jetë efektiv, ai mund t'i bëjë dëm nxënësit, duke i shtuar inatin dhe agresivitetin, në vend që t'i kontrollojë ato. Përdorimi i veçimit si formë e ndëshkimit fizik, mund t'i shkaktojë dhembje fizike apo emocionale.

Se sa duhet të zgjasë veçimi, ky është një debat i gjatë. Disa ekspertë thonë se ai s'duhet të zgjasë më shumë se dy - tre minuta, ndërsa të tjerë rekomandojnë një minutë për çdo vit të moshës së fëmijës, deri në dymbëdhjetë. Koha prej një minutë për çdo vit moshe është vendosur në bazë provash. Ajo duket kohë e mjaftueshme për të nxitur sjellje të mira, pa e zemëruar nxënësin.⁷¹

Përpara se t'i jepni nxënësit një dënim duke e izoluar, sigurohuni që:⁷²

- Veçimi s'duhet të zbatohet ndaj nxënësve shumë të vegjël; dhe nxënësit e dënuar s'duhet të injorohen apo të mos stimulohen.
- Masat duhen marrë menjëherë pas sjelljes jo të mirë të nxënësit. Kur nxënësit konstatojnë reagime të menjëhershme për lëndimin që u bëjnë të tjerëve, ata e kuptojnë më mirë se përse po merren ndaj tyre masa disiplinore. Kur është e mundur, ju duhet t'u ofroni nxënësve alternativa pozitive ndaj veprimeve të tyre (duke i kërkuar nxënësit

⁷¹ « Fëmijë të mirë: Një udhëzues bazë mbi rolin e prindërve ». <http://home.flash.net/~goodkids/> [marrë në internet më 10/10/2005].

⁷² DCFS. Zyra mbi Rregullat dhe Licencat. HFS 46 Manuali mbi kujdesin një grupi ditor. Shtesa O. "Vitet e para janë vite mësimi. Koha për t'i thënë ndal "izolimit". http://www.dhfs.state.wi.us/rl_dcfs/GDC%20Manual/HFS46-Apdnx-O.pdf#search='DCFS%20Bureau%20of%20Regulation%20and%20Licensing%20Early%20Years%20are%20Learning%20Years%20Time%20out%20for%20timeout' [accessed online on 10/10/2005].

të vërë gjërat në vend, kjo është më produktive sesa duke e larguar atë fare nga klasa).

- Veçimi s'duhet të jetë poshtërues dhe as kërcënues apo frikësues. NUK duhet të ketë një karrike të caktuar apo një vend të caktuar për veçimin e fëmijës, sepse kjo krijon idenë se veçimi është një ndëshkim dhe mund të shkaktojë një ankth të panevojshëm. Ju s'duhet ta vini KURRË një nxënës në pozitë qesharake ose izolimi gjatë periudhës së veçimit.
- Nxënësi nuk duhet të lihet vetëm, përveçse kur e kërkon vetë. Nxënësit, sidomos ata më të vegjëlit, kanë nevojë për mbështetjen e të rriturve për të zhvilluar ndjenjat e tyre. Në qoftë se ju dëshmoni se ndjenjat e tyre kanë peshë, edhe ata do të kërkojnë t'i respektojnë ndjenjat e të tjerëve.
- Veçimi nuk duhet të zgjasë më shumë sesa i duhet nxënësit për t'u qetësuar. Pasi nxënësi qetësohet, ia shpjegoni qartë se ç'është sjellja korrekte dhe cila nuk është e tillë. Nxënësit i duhet bërë absolutisht e qartë se përse u morën masat disiplinore ndaj tij, përndryshe ai ka të ngjarë t'a përsërisë sjelljen e padëshiruar.
- Shmangni kërcënimet. Mos thoni kurrë: "Në rast se e përsërisni këtë, ju do të veçoheni përsëri nga të tjerët.". Kjo e çorienton nxënësin dhe është formë ndëshkimi negativ, i cili rrallë jep efekte të dëshëruara.
- Zbatojeni metodën e veçimit në përshtatje me çdo nxënës. Fëmijët zhvillojnë aftësi të kontrollojnë vetveten në mënyra të ndryshme. Merrni në konsideratë nevojat e çdo nxënësi në veçanti. Asnjë teknikë s'mund të funksionojë me të gjithë dhe në çdo kohë. Veçimi nuk zbatohet si ndëshkim.
- Veçimi është një mundësi që i jepet nxënësit të kthjellohet dhe të ribashkohet me grupin në një gjendje më produktive. Mësojeni nxënësin se si t'i zgjidhë problemet e tij, duke përfituar nga kujdesi dhe mbështetja e të tjerëve, kështu që dhe veçimi mund të mos jetë më i nevojshëm.

ZGJIDHJA E KONFLIKTIT

Pavarësisht nga përpjekjet tuaja, si dhe ato që bëjnë nxënësit tuaj dhe prindërit e tyre, shpesh në klasë ndërpritet mësimi nga konfliktet mes nxënësve dhe kjo çështje është një arsye e zakonshme për zhvillimin e takimeve prindër - mësues (ndonëse ky nuk është kurrsesi shkak i vetëm). Këto konflikte mund të marrin trajtën e fyerjeve, ngacmimeve, përleshjeve, zënkave me fjalë dhe konflikteve që lidhen me zënien për fusha loje, për marrjen e materialeve, qoftë dhe për detyrat mësimore. Këto konflikte lindin kryesisht nga kryeneçësia dhe ato mund të përshkallëzohen shpejt, në rast se nuk trajtohen dhe ndërmjetësohen.

Një mënyrë e mirë për të minimizuar ndërprerjet në mësim dhe sjelljet jo të mira është t'i mësojmë nxënësit se si t'i zgjidhin konfliktet e tyre. Përveç zgjidhjes së problemeve që kanë lidhje me drejtimin e klasës, kjo metodë u mëson nxënësve shprehi të dobishme, që do t'u shërbejnë atyre edhe jashtë klasës.⁷³

Studimet mbi zgjidhjen e konflikteve mes nxënësve kanë zbuluar këto çështje të rëndësishme, si më poshtë:⁷⁴

- (a) Konfliktet mes nxënësve ndodhin shpesh në shkolla (ndonëse rrallë konfliktet rezultojnë me lëndime).
- (b) Nxënës të pamësuar zakonisht përdorin strategji konflikti, të cilat çojnë në pasoja shkatërruese dhe këta nxënës e injorojnë rëndësinë që ka ruajtja e marrëdhënieve të mira me të tjerët.
- (c) Programet për zgjidhjen e konfliktit dhe ndërmjetësimin mes shokëve duket se kanë dhënë rezultat, duke u mësuar nxënësve negociimin e integruar dhe shprehitë e ndërmjetësimin.
- (d) Pas trajnimit, nxënësit kanë prirje t'i përdorin këto shprehi negociimi të konflikteve, të cilat përgjithësisht japin rezultate konstruktive.

⁷³ "Drejtimi i orës së mësimit dhe disiplina". <http://education.calumet.purdue.edu/vockell/edps530/Chapter%2013.htm> [marrë nga interneti më 10/6/2005].

⁷⁴ Xhanson, D.V., Xhanson, R.T., Dudley, B., dhe Burnett, R. "T'i mësojmë nxënësit të bëhen ndërmjetësues të shokëve", Lidërshipi në arsim, 50(1), 10-13, 1992.

- (e) suksesi i nxënësve në zgjidhjen e konflikteve të tyre çon në pakësimin e numrit të konflikteve mes nxënësve, që u raportohen mësuesve dhe administratorëve e që, nga ana e vet, pakëson nevojën e zbatimit të veprimeve të ashpra disiplinore.

Procedura kryesore për t'u mësuar nxënësve tuaj si të jenë pajtues konfliktesh konsiston në tre hapa:

1. U mësoni fëmijëve shprehi negociimi që u japin mundësinë të:
 - (a) përcaktojnë konfliktin ("për çfarë po grindem unë dhe si lindi problemi");
 - (b) ndërroni vendet dhe këmbeni propozimet ("unë mendoj se do të ishte më mirë kështu, sepse ...");
 - (c) shikojeni situatën nga të dyja perspektivat (p.sh., përmes luajtjes së rolit të tjetrit);
 - (d) zgjidhni opsione ku të dy fëmijët fitojnë (zgjidhje ku "fiton njëri - fiton dhe tjetri", të tilla, si "Do ta provojmë sot sipas mënyrës tuaj dhe nesër sipas mënyrës time, le të shohim cila rrugë është më e mirë!");
 - (e) arrini në një marrëveshje të arsyeshme. Mësojuni nxënësve se si të ndërmjetësojnë për zgjidhjen konstruktive të konflikteve mes shokëve të tyre të klasës. Ndërmjetësimi është një proces i shfrytëzimit të shërbimeve apo aftësive të një personi tjetër për të zgjidhur mosmarrëveshjet.
2. Për të mësuar ndërmjetësimin, zgjidhni një problem që mund të lindë apo që ka lindur më parë, midis dy nxënësve. Kërkojuni dy nxënësve që të aktrojnë një problem të tillë dhe një nxënëseje të tretë që t'i ndihmojë në arritjen e një marrëveshjeje, duke shfrytëzuar njohuritë që ajo ka mbi shokët e vet, për problemin dhe për atë që mendon se mund të ishte një kompromis i mirë.
3. Pasi të gjithë nxënësit i kanë përvetësuar aftësitë e negociimit dhe të ndërmjetësimit, çdo ditë dy prej nxënësve (më mirë do të ishte një vajzë dhe një djalë) të caktohen që të shërbejnë si ndërmjetës (pajtues). Këto rregulla u ngarkohen me radhë të gjithëve në klasë dhe këta ndërmjetës ndërhynë në zgjidhjen e çdo konflikti që nuk mund të zgjidhet nga vetë palët e përfshira.

Si mësues, roli juaj është t'i mbështesni këto procese duke i mësuar, duke u shërbyer si model dhe duke u dhënë këshilla. Një program për zgjidhje konfliktesh jo vetëm që do të ulte kohën që shpenzoni në klasën tuaj për zgjidhjen e konflikteve nxënës - nxënës, por ai do t'i ndihmonte nxënësit tuaj të zhvillojnë shprehi që mund t'u shërbejnë në jetë. Zhvillimi dhe praktikimi i vazhdueshëm i këtyre shkathtësive, si pjesë e planit të drejtimit të orës së mësimi, do të bëjnë që këto shkathtësi të "nguliten" në mendjen e tyre dhe kjo është një gjë e mirë. Në këtë mënyrë, shprehitë e negociimit dhe ndërmjetësimi automatizohen, kështu që nxënësit mbështeten tek ato në mënyrë të natyrshme, sa herë që u duhet të zgjidhin apo shmangin probleme.

MËSIMDHËNIA NË PËRSHTATJE ME MOSHËN DHE DISIPLINA POZITIVE

Të kuptuarit se si zhvillohen fëmijët ju ndihmon të dini se çfarë mund të kërkonit prej tyre. Fëmijët ndryshojnë vazhdimisht dhe zhvillohen duke u rritur. Studiuesit kanë zbuluar se fëmijët e vegjël kalojnë nëpër disa faza specifike zhvillimi. Ideja që qëndron pas këtyre "moshave dhe fazave" tregon se sjellje të caktuara janë normale ose në përshtatje me mosha të caktuara dhe jo me të tjera. Tabela e mëposhtme përshkruan zhvillimin e fëmijëve në mosha të caktuara dhe cilat janë metodat e mësimdhënies dhe ato disiplinore për këto mosha.

Lidhja e moshave dhe e fazave me disiplinën^{75,76}

Mosha	Zhvillimi	Udhëzime mësimdhënieje/disiplinore
5 vjeç	Ka tendencë të jetë i qetë, i balancuar mirë. Zakonisht përpiqet të bëjë vetëm atë që di të bëjë, prandaj dhe përshtatet mirë. I shoqërueshëm, i dashur, vlerësues, do të kënaqet të tjerët dhe të bëjë gjënë e duhur, kërkon të jetë e të tregohet i mirë, nuk është i aftë të pranojë gabimet dhe, megjithëse përpiqet, nuk tregon gjithnjë të vërtetën.	Mësojuni se çfarë është e arsyeshme të kërkojnë dhe çfarë jo. Shumë prej gjërave që mësuesit i kujtojnë të këqia, shpesh vijnë nga papjekuria. Parandalimi është shumë më i mirë se dhënia e një mase negative. Nëse veproni kështu, bëjeni me qetësi. Dëshira e nxënësit që të jetë i mirë dhe të bëjë atë që duhet është e madhe. Me pak fat, duhet të keni relativisht pak nevojë të përdorni masa negative.

⁷⁵ Përshtatur nga: "Disiplina që punon: Moshat dhe metoda me faza. Fakte nga çështje familjare". Universiteti i Degës së Bashkëpunimit në Maine. <http://www.umext.maine.edu/onlinepubs/pdfpubs/4140.pdf> [marrë në internet më 10/11/2005].

⁷⁶ Përshtatur nga "Udhëzime mbi rolin pozitiv të prindërve". <http://xpedio02.childrenshc.org/stellent/groups/public/@xcp/@web/@parentingresources/documents/policyreferenceprocedure/web009299.asp?src=overture> [marrë në internet më 10/12/2005].

Mosha	Zhvillimi	Udhëzime mësimdhënieje/disiplinore
6 vjeç	Shumë emocional. Një minutë të do, minutën tjetër të urren. Ka shumë konfuzion në vetvete dhe ngatërrohet me të tjerët. Mund të kërkojë, rebelohet, kundërshtojë ose zihet. Kur është me humor, është i qeshur, energjik dhe entuziast. Ka nevojë për shumë lavdërime, por sjellja e tij meriton shpesh kritika. Kjo e bën sjelljen edhe më të keqe. Akoma s'bën dot dallimin mes times dhe tëndes.	Durim. Injoroni refuzimet dhe mos i merrni si personale thëniet e nxënësit: "Unë s' dua" ose "unë s' mund". Lavdërojeni. Mund të mos jetë aq e lehtë të gjeni diçka për t'ia lavdëruar, por përpiquuni fort; shmangni rezistencën dhe konfrontimin; shmangni sa më shumë çështje delikate; jepini mundësira, sidomos në rast se ndikojnë për një sjellje pozitive ose përvojë mësimi.
7 vjeç	I qetë, më shumë ka emocione negative. Mund të jetë serioz, i zhytur në mendime, në humor i shqetësuar ose dyshues. Është shumë i ndjeshëm ndaj emocioneve të të tjerëve. Mund të kujtojë sikur s'e duan, se e kritikojnë shumë ose sikur duan të tallen me të. I lë gjërat për më vonë, ka kujtesë të shkurtër dhe hutohet shpejt.	Mund të jetë problem bindjeje, ngaqë nxënësi është i papërqëndruar. Për t' i kërkuar të bëjë veprime të thjeshta, flitini që më përpara dhe sigurohuni se e ka kuptuar. Kujtojani nxënësit përpara se ta harrojë përsëri dhe të bëjë diçka tjetër. Jepuni shpërblime të vogla për çdo sukses.
8 vjeç	Energjik, dramatik, kurioz, i paduruar dhe kërkues. Jo aq me humor sa ai 7 vjeç, por ende i ndjeshëm. Kërkon kohë, vëmendje dhe miratim, fillon të mendojë në mënyrë abstrakte, i interesuar për gjërat e veta.	Jepini nxënësit udhëzime në mënyrë të pranueshme. Koha, vëmendja dhe miratimi janë motivues të mirë. Shfrytëzoni aktivitete me zgjidhje problemesh si mjet për të zhvilluar të menduarit abstrakt. Jepini shpërblime të vogla për çdo sukses.

Mosha	Zhvillimi	Udhëzime mësimdhënieje/disiplinore
9 vjeç	Është më i qetë se ai 8 vjeç. Duket i pavarur, i përgjegjshëm, i besueshëm dhe bashkëpunues. Ndonjëherë mund të jetë i paparashikueshëm, por zakonisht është i arsyeshëm. E pranon mirë kritikën, kur ajo shprehet mirë, i pëlqen shumë korrektesa, standardet e grupit mund të kenë më shumë rëndësi se standardet e më të mëdhenjve. Merret shumë me veten e tij dhe mund të mos e ketë mendjen kur i flet. Mund të duket i hutuar ose indiferent. Mund të tregojë kujdes për të tjerët.	Nxitni ndjenjën e përgjegjësisë përmes caktimit të detyrave. Përdorni të mësuarit bashkëpunues, por monitoroni aktivitete ndërpersonale. Përdorni metodën e të mësuarit të drejtuar përmes projekteve, në vend që t'u jepni vetëm leksione.
10 vjeç	Emocionalisht i drejtpërdrejtë, i thjeshtë, i prerë, zakonisht i balancuar, ende fëminor. Më pak në ankth dhe kërkues se ai i moshës 9 vjeç. Më shpesh me humor të mirë dhe i kënaqur nga jeta. Por mund të shfaqë temperament të prerë dhe të dhunshëm. Mund të jetë shumë i dhënë. Një moshë pa shqetësime, por disa ndrojtje mbeten. E do humorin, që s'mund të jetë shumë për të qeshur për të tjerët. Një moshë e lumtur.	Impenjoheni nxënësin të dallojë ç'është e mira dhe e keqja, e drejta dhe e gabuara, e vërteta dhe e pavërteta; teknika më e mirë është të kuptojë se çfarë është e logjikshme të kërkohet. Përfshijini nxënësit në komitete të klasës, dhe në komitete disiplinore. Shfrytëzoni humorin gjatë dhënies së mësimit.
11 - 13 vjeç	Adoleshenca e hershme, kohë e ndryshimeve të shpejta. Zhvillon identitetin e vet. Ka nevojë për jetë private dhe mund të jetë shumë i ndjeshëm ndaj ngacmimeve. Me humor. Rritet rëndësia e shokëve.	Jepuni mundësinë nxënësve të kuptojnë se ju kujdeseni për ta. Organizoni sesione apo aktivitete "këmbimi përvoje dhe ndjenjash" (siç janë esetë). Modeloni respektin reciprok. Kufizoni kritikën dhe këmbënguljet. Mos lejoni talljen apo ofendimet.

Moshë	Zhvillimi	Udhëzime mësimdhënieje/disiplinore
14 - 16 vjeç	<p>Adoleshenca e mesme. Rritet pavarësia, zhvillimi seksual dhe përqëndrimi te vetvetja. I vetëdijshëm për trupin dhe paraqitjen. Të menduarit është më pak femënor; vlerësojnë faktet dhe mund të marrin vendime të mira.</p>	<p>Inkurajoni raporte pozitive përmes shkëmbimit të eksperiencave. Jepuni ide krijuese që t'i zhvillojnë me shokët si pjesë e mësimit. Caktojuni kufij të arsyeshëm, jini konsekuent dhe korrekt në zbatimin e rregullave. Sigurohuni që i kanë kuptuar rregullat dhe diskutoni me ta për kuptimin e masave ndëshkuese. Lavdërojini dhe përgëzojini për sjelljet dhe rezultatet e mira. Ndani me ta besimet, shqetësimet dhe vlerat tuaja mbi botën. Inkurajojini nxënësit tuaj të kërkojnë këshillën e një më të rrituri, sa herë që kanë nevojë. Vazhdoni t'i lavdëroni.</p>
17 - 21 vjeç	<p>Adoleshenca e vonë. Bëhet më i pavarur, mbështetet te vetvetja, ndikohet më pak nga grupi i shokëve, zhvillon kapacitet të menduarit prej të rrituri. Përgjithësisht është më i lehtë për t'u trajtuar se ato të moshave të adoleshencës së hershme dhe të mesme. Eksploron më shumë marrëdhënie afatgjata. Mund të ketë një opinion mbi gjithçka. Vetëdija mbi paraqitjen pakësohet.</p>	<p>Vazhdoni të veproni si me moshat 14 - 16 vjeç. Kërkoni rregullisht nga nxënësit se për çfarë mendojnë dhe në çfarë besojnë. Respektoni veçantinë e tyre dhe inkurajojini të respektojnë të tjerët. Inkurajoni vendimmarrjet e pavarura. Vazhdoni t'i lavdëroni.</p>

NDIHMJA NDAJ FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Qëndrimi ndaj nxënësve me probleme emocionale dhe sjelljeje⁷⁷

Teknikat e poshtëshënuara mund të jenë efektive veçanërisht me nxënësit që paraqesin probleme emocionale dhe sjelljeje.

1. **Injorim i paramenduar.** Sjelljet që kërkojnë të tërheqin vëmendjen e të tjerëve dhe që nuk përhapen apo nuk ndërhyjnë në sigurinë apo funksionimin e orës së mësimi, ndalohen me efektivitet nëpërmjet injorimit të paramenduar (siç ishte rasti i Ramonit). Kjo teknikë nuk duhet të përdoret asnjëherë ndaj sjelljeve agresive. Klasa ka nevojë të udhëzohet se si ta bëjë mirë këtë, pasi për disa nxënës vëmendja që u kushtohet nga shokët mund të jetë më e fuqishme se sa vëmendja e të rriturve.
2. **Ndërhyrja e sinjaleve.** Në rast se një nxënës është mjaft i qetë për të reaguuar, ka raporte pozitive me mësuesin dhe nuk ka impulse të pakontrolluara patologjike, një sinjal pa fjalë mund të mjaftojë për ta ndihmuar të ripërqëndrohet. Shihni seksionin mbi teknikat e tërheqjes joverbale të vëmendjes këtu më sipër.
3. **Të qëndruarit afër dhe kontrolli i të prekurit.** Afrimi te nxënësi i dëshpëruar apo vendosja e dorës në shpatulla mund të jetë efektiv, pasi tregon mbështetje në një mënyrë jo kërcënuese. Kur përdorim këtë teknikë, bëni kujdes të mos japim një sinjal të gabuar. Komentoni pozitivisht mbi gjithçka të mirë që bën nxënësi.
4. **Nxitja e interesave.** Ndryshoni ritmin e aktivitetit, bëni komente për punën e nxënësit apo hetoni mbi një interes që lidhet me një detyrë, në rast se nxënësi tregon shenja mungese qetësie.
5. **Shfaqje e fortë e dashurisë.** Shprehni një dashuri të pastër ose vlerësim për një nxënës, që ai të rifitojë vetëkontrollin.

⁷⁷ "Organizimi i klasës. Organizimi. Teknika pune me nxënësit e vështirë emocionalisht dhe në sjellje." <http://www.teachervision.fen.com/page/7242.html> [marrë në internet më 10/4/2005].

6. **Ndihmë për kapërcimin e pengesave.** Përpara se nxënësi të fillojë të sillet jo mirë, ndihmoheni në një pjesë të vështirë të detyrës. Sigurojeni se keni dëshirë ta ndihmoni dhe se së bashku ju mund ta zgjidhni problemin.
7. **Rigrupimi.** Ndryshoni vendin e bangave ose detyrat e një grupi të vogël, për të shmangur ndonjë problem. Bëjeni këtë në një mënyrë jo ndëshkuese dhe nëse është e mundur, pa u vënë re. Për idetë, shihni më parë seksionin "Mbi shndërrimin e orës së mësimi në një mjedis të rehatshëm", në këtë dokument.
8. **Ristrukturimi.** Në qoftë se një aktivitet nuk përfundon me sukses, ndërrojeni sa më shpejt. Rëndësi ka të keni gjithnjë një plan rezervë. Ndonjëherë është më mirë të kaloni nga një lojë interaktive në një tjetër, që nuk kërkon ndërveprim. Kjo mund të bëhet butësisht, pa masa ndëshkimore, kur një grup stimulohet më tepër se ç'duhet. Herën tjetër, ofroni një alternativë më efektive. Nxënësit mund të zgjedhin ta trajtojnë problemin me gojë, përmes diskutimesh, apo me shënime të mbajtura, p.sh., nga një material vizual.
9. **Ftesë direkte.** Nëse një nxënës ose grup ka marrëdhënie pozitive me mësuesin, ndonjëherë mjafton vetëm të thuhet të ndalohej një veprim i caktuar, sepse krijon probleme. Në një rast të tillë, nuk jepet dhe as nuk nënkuptohet ndonjë masë apo shpërblim. Kjo është një kërkesë e drejtpërdrejtë që i bëhet një personi nga një tjetër.
10. **Parandalimi.** Largojeni një nxënës nga një situatë stresi, para se të ndodhë një sjellje e padëshirueshme, si, p.sh., duke i kërkuar t'ju ndihmojë në shpërndarjen e fletëve apo në marrjen e mungesave. Bëni kujdes të mos shpërbleni padashje një nxënës që po provokon një problem.
11. **Mbështetja që siguron një rutinë.** Siç kemi mësuar më sipër, oraret dhe rutinat janë ndërhyrje të rëndësishme, që ndikojnë mbi sjelljen. Duke e ditur se ç'duhet bërë dhe kur duhet bërë, kjo gjë ofron strukturë, jep siguri dhe bën parashikime në jetën e nxënësve, të cilët mund të mos kenë një mbështetje të tillë në fusha të tjera të jetës.

Mënyra të thjeshta se si të ndihmohen fëmijët me "nevoja të veçanta"⁷⁸

Udhëzime për mësues

Të përmirësojmë të kushtuarit e vëmendjes

- Uleni nxënësin në bangën e parë.
- Uleni nxënësin pranë një nxënësi model, që mund të jetë "një tutor - shok".
- Ndajeni detyrën në detyra më të vogla, duke i dhënë nxënësit çdo herë një detyrë të tillë (për shembull, në vend që t'i jepet një faqe e tërë me probleme matematikore, e cila mund ta demoralizojë një nxënësi, priteni faqen përgjysmë dhe kërkojini nxënësit të plotësojnë gjysmën; më pas, kur ai ta dorëzojë, jepini dhe gjysmën tjetër.
- Përdorni sinjale pa fjalë për të tërhequr vëmendjen e nxënësve (për shembull, duke mbajtur në dorë letra me ngjyra plot shkëlqim, duke i rënë tabelës, duke i prekur në sup).
- Vendosni kontakt me sy përpara se të jepni udhëzime.
- Jepni udhëzime të shkurtra direkte, duke përdorur si sinjale vizuale ashtu dhe me gojë, kur është e mundur.

Për të ulur impulsivitetin

- Injoroni shkeljet e vogla në sjellje.
- Inkurajoni ose jepni shpejt masa ndëshkimore.
- Mbikëqyrni kalimin nga njëra orë mësimore apo aktivitet në tjetrin.
- Përgëzoni sjelljet e mira, sa herë që është e mundur.
- Lidhni kontratë për sjellje që kanë nevojë të monitorohen.
- Ndihmoni fëmijën të mësojë teknika vetëmonitorimi.

Si të merremi me hiperaktivitetin

- Lejojeni nxënësin të çohet nga vendi disa here.
- Lejojeni të vijë rrotull.

⁷⁸ "Drejtimi i klasës". Indeks. <http://www.adda-sr.org/ClassroommanagementIndex.htm> [marrë nga interneti më 10/4/2005].

Si të përmirësohen rezultatet akademike

- Jepuni kohë shtesë të përfundojnë punën.
- Shkurtoni detyrat.
- Përdorni metoda multishqisore mësimdhënieje (vizuale, gojore, me të prekur).
- Kujtojeni nxënësin të kontrollojë punën e të shohë nëse e ka mbaruar.
- Mësojini nxënësit teknika vetëmonitoruese.
- Përdorni fletë detyrash ditore.

Për të përmirësuar shprehi organizative

- Mbani në konsideratë ndihmën e prindërve.
- Përdorni fletë detyrash ditore.
- Përdorni një bllok shënimesh për të gjitha.
- Kontrollojeni shpesh bllokun e shënimeve dhe inkurajoni pozitivisht blloqet e shënimeve që mbahen mirë.

Drejtimi i klasës dhe modifikimet në mësimdhënie

Teknika të tjera të dobishme përfshijnë sa më poshtë vijon:

- Pakësoni apo alternoni detyrat.
- Zgjatni kohën e punës, që të përfundohen detyrat.
- Përdorni materiale speciale që inkurajojnë dhe nxisin aftësitë, si letër milimetrike, lampustila, letra speciale me vija etj.
- Përdorni sa më shumë mjete pamore.
- Lexojeni kërkesën e testit me gojë.
- Përdorni alternativa të larmishme ose versione testesh me vërtetime, në vend të hartimit të një eseje.
- Kërkoni raportime me gojë (dhe jo me shkrim).
- Pranoni projekte të veçanta, në vend të raportimeve.
- Jepni matrica shumëzimi dhe matrica të tjera.
- Jepni një listë me fjalë që zakonisht shkruhen me gabime.
- Hartoni një kontratë performance mes mësuesit, nxënësit dhe prindit.
- Përgëzojini për pjesëmarrjen në orën e mësimit.

- Jepni udhëzime njëfazëshe, të shkurtra, të thjeshta.
- Thirreni nxënësin në emër, për ta kujtuar se do të përgjigjet pyetjen tjetër.
- Përdorni kode me ngjyra, për të vënë në dukje diçka që e ndihmon nxënësin të kapë çështjen kryesore të informacionit.
- Mbi të gjitha, inkurajoni shpesh në mënyrë pozitive! Përfitimet që vijnë nga kjo zgjatën gjithë jetën!!



Lexime të rekomanduara

Përveç shumë botimeve të shkëlqyera dhe burimeve në internet të përmendura në tekst, për më shumë informacion ju inkurajojmë të eksploroni dhe burimet e mëposhtme.

Botime

Albert, Linda. "Disiplina bashkëpunuese". Udhëzues implementimi. Shërbimi Amerikan i Drejtimit, 1996.

Albert, Linda. Udhëzues për mësuesin për disiplinën bashkëpunuese: "Si të drejtohet klasa juaj dhe si të nxitet vetëvlerësimi". Shërbimi Amerikan i Drejtimit, 1989.

Boostrom, Robert. "Natyra dhe funksionet e rregullave në klasë". Studim mbi kurikulumin, verë 1991, 193-216.

Coloroso, Barbara. "Fëmijët e meritojnë! Jepini fëmijës tuaj dhuratën e disiplinës së brendshme". Avon Books, 1995.

Curwin, Richard. "A jam unë në telash: Përdorimi i disiplinës për t'u mësuar fëmijëve të vegjël përgjegjësinë". Santa Cruz, CA: Network Publications, 1990.

Curwin, Richard dhe Mendler, Allen N. "Libri mbi disiplinën: Një udhëzues e plotë për drejtimin në shkollë dhe në klasë". Reston, VA: Reston Pub., 1980.

Dinkmeyer, Don dhe Dreikurs, Rudolf. "Si t'i inkurajojmë fëmijët të mësojnë". Taylor & Francis Group, 2000.

Dreikurs, Rudolf. "Ruajtja e shëndetit në klasë; Teknika drejtimi në klasë." Bot. dytë. Uashington, D.C.: Zhvillim i përshpejtuar, 1998.

Dreikus, Rudolph dhe Çernoff, Marvin. "Prindërit dhe mësuesit: Miq apo armiq?," Edukimi, Vol. 91, No. 2, 147-54, nëntor - dhjetor, 1970.

Emmer, E.T., Evertson, C.M., Sanford, J.P., Clements, B., dhe Worsham, M.E. "Drejtimi i klasës për mësuesit e shkollave të mesme". (2nd Ed.). Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, 1989.

Evertson, C.M., Emmer, E.T., Clements, B., Sanford, J.P., and Worsham, M.E., "Drejtimi i klasës për mësuesit e shkollës fillore". (2nd Ed.). Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, 1989.

Fontana, David. "Kontrolli në klasë: Kuptimi dhe edukimi i sjelljes në klasë". London: Methuen, 1985.

Freiberg, H. Jerome. "Nga turistë në qytetarë në klasë". Te "Lidershipi në arsim", Vol. 54, No. 1, p.32-36, shtator., 1996.

Fuhr, Don. "Disiplina efektive në klasë: Këshilla për edukatorë". NASSP Bulletin, janar 1993, 82-86.

Galivan, Janice. "Disiplinë pa ndëshkim". Forum, shtator/ tetor 1987, 37-40.

Ginott, Haim G. "Mësuesi dhe fëmija: Një libër për prindërit dhe mësuesit". 1st Collier Books ed. Nju Jork, Colliers, 1993.

Golden, Diane Cordry. "Disiplina e studentit me paaftësi: Një model vendimmarrjeje për drejtues". NASSP Bulletin, shkurt 1993, 12-20.

Gordon, Thomas. "Disiplina që funksionon: Nxitja e vetëdisiplinës te nxënësit". Plume, 1991.

Grossnickle, Donald R & Sesko, Frank P. "Disiplina preventive për mësimdhënie efektive dhe mësim". Reston, VA: Shoqata kombëtare e drejtorëve të shkollave të mesme, 1990.

Hart, Stuart N. (ed.) "Eliminimi i ndëshkimit trupor: Rruga drejt një disipline konstruktive për fëmijën". Paris: UNESCO Publishing, 2005.

Hill, D.J. "Humori në klasë". Springfield, IL: Charles Thomas, 1988.
Johnson, D.W., Johnson, R.T, Dudley, B., & Burnett, R. "T'u mësojmë nxënësve të bëhen ndërmjetës të shokëve". Lidërshipi në arsim, Vol. 50, No. 1, 10-13, 1992.

Jones, Fredric H. "Disiplina pozitive në klasë". New York: McGraw Hill, 1987.

Kounin, Jacob S. "Disiplina dhe drejtimi në grup i klasave".
Huntington, N. Y.: R. E. Krieger, 1977.

Mackenzie, Robert J. "Përcaktimi i kufijve në klasë". Edukatori amerikan,
Vol. 21, No. 3, 32-43, Fall 1997.

Mendler, Allen N. "Disiplinimi me dinjitet për të rinjtë problematikë".
Shërbimi Kombëtar për Arsimin, 1999.

Burime në internet

Aleancë për transformimin e jetës së fëmijëve (www.atlc.org).

Akademia Amerikane e Pediatrisë (www.aap.org).

Pyesni DrSears.com (www.askdrsears.com).

Lidhja Prindërore Ndërkombëtare (www.attachmentparenting.org).

Instituti për një rol të ndërgjegjësuar të prindit
(www.awareparenting.com).

Sjellja UK (www.behaviouruk.com).

Qendër për Disiplinën Efektive (www.stophitting.com).

Fëmija dhe Familja në Kanada (www.cfc-efc.ca).

Aleanca: Fëmijët s'i mund dot kush! (www.childrenareunbeatable.org.uk).

Rrjeti i informacionit për të drejtat e fëmijëve (www.crin.org).

Drejtimi në klasë - direkt në internet (www.classroommanagementonline.com).

Bota e Edukimit (www.educationworld.com).

Roli i ndjeshëm i prindit, nga Shoqata kanadeze për parandalimin e mizorive ndaj fëmijëve (www.empathicparenting.org).

Familja funksionon Inc. (www.familyworksinc.com).

Të luftojmë krimin: Investoni te fëmijët (www.fightcrime.org).

Çështje të ndaluara (www.alice-miller.com).

Iniciativë globale për t'i dhënë fund të gjitha ndëshkimeve trupore mbi fëmijët ([www.](http://www.endcorporalpunishment.org)

[endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)).

Faqja e internetit për ndalimin e rrahjes në prapanicë (www.neverhitachild.org).

Positive Discipline.com (www.positivediscipline.com).

Qendra e burimeve të disiplinës pozitive (http://joanneaz_2.tripod.com/positivedisciplineresourcecenter).

Projekti për ndalimin e rrahjes në prapanicë (www.nospank.net).

Save the Children Alliance (www.savethechildren.net/alliance/index.html).

UNESCO (www.unesco.org).

UNICEF (www.unicef.org) (www.unicef.org/teachers).

